



AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE


Raporti i Veprimtarisë së
Autoritetit të Komunikimeve
Elektronike dhe Postare
për vitin
2024

Tiranë 2025

PËRMBAJTJA

I.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2024.....	4
1.	Rekomandimet e realizuara.....	4
2.	Rekomandime në proces realizimi.....	8
II.	KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE.....	16
1.	Miratimi i ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.....	16
2.	Ecuria e tregut të komunikimeve elektronike.....	17
2.1	Të ardhurat dhe investimet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.....	17
2.2.	Shërbimet dhe rrjetet celulare.....	20
2.3	Shërbimet dhe rrjetet fikse.....	25
3.	Rregullimi ex-ante i tregjeve të komunikimeve elektronike.....	31
4.	Dhënia e Autorizimeve individuale për përdorimin e brezave pionierë 3.4 – 3.8 Ghz dhe implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë.....	34
4.1	Zhvillimi i tenderit publik ndërkombëtar.....	34
4.2	Nevoja për investimet e sektorit për kalimin në teknologjinë 5G.....	35
5.	Nevoja e përdorimit të brezit 700 Mhz në implementimin e teknologjisë 5G.....	38
6.	Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike.....	38
III.	TREGU POSTAR.....	46
1.	Ecuria e tregut postar.....	46
2.	Transparenca për tarifat e pakove postare ndërkufitare.....	48
3.	Statusi i Shërbimit Universal Postar.....	48
IV.	MBROJTJA E KONSUMATORIT.....	51
1.	Kontrata e pajtimit të konsumatorit/Klauzola e indeksimit të tarifave me indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK).....	51
2.	Ankesat e konsumatorëve për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare.....	53
3.	Portabiliteti i numrit.....	58
V.	MONITORIMI I PËRDORIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE DHE VEPRIMTARIA E INSPEKTIMIT TË TREGJEVE TË MBIKËQYRURA.....	61
1.	Veprimtaria monitoruese e spektrit të frekuencave gjatë vitit 2024.....	61
2.	Kushtet e reja të mbulimit të cilësisë së shërbimeve në kuadrin e rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e brezave 900 dhe 1800 MHz.....	66
3.	Adresimi i problematikave të interferencave nga vendet fqinje.....	67
4.	Veprimtaria e Inspektimit.....	68
VI.	SFIDAT E QËNDRUESHMËRISË SË SIGURISË DHE INTEGRITETIT TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE NË SEKTORËT E TELEFONISË SË LËVIZSHME DHE FIKS/BROADBAND.....	72
VII.	BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL DHE RAPORTIME NDËRKOMBËTARE.....	75
1.	Bashkëpunim në nivel kombëtar.....	75

2. Procesi i integritit dhe raportimit në BE	75
3. Bashkëpunimi ndërkombëtar	76
3.1 Sistemi i Përqendruar i Informacionit (SPI) – ATLAS.....	76
3.2 Sistemi i Monitorimit të Frekuencave.....	77
VIII. MIRADMINISTRIMI FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	78
1. Të ardhurat sipas burimeve të financimit në vitin 2024.....	78
2. Zbatimi i buxhetit të institucionit.....	79
3. Taksa e radiokomunikacionit.....	83
4. Menaxhimi i burimeve njerëzore	83
IX. DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT TË PUNËS PËR VITIN 2025.....	85
ANEKS 1: ÇËSHTJET GJYQËSORE KU ËSHTË PALË AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE.....	86



I. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2024

1. Rekomandimet e realizuara

1: *"Analiza e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme duhet të realizohet periodikisht siç kërkohet në ligj dhe të ketë si synim, nga njëra anë, përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile, duke trajtuar edhe futjen në treg të MVNO-ve, prania e të cilëve do të ishte një faktor i rëndësishëm në nxitjen dhe rritjen e konkurrencës në këtë treg, dhe nga ana tjetër, propozimin e masave rregulluese të nevojshme për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në këtë treg."*

Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 16, datë 16.11.2023, miratoi nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”.

Këshillimi Publik u krye për një periudhë prej 60 ditësh, ku palët e interesuara kanë dërguar komentet dhe sugjerimet e tyre.

Me vendimin nr. 4, datë 16.2.2024¹, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar”.

Dokumenti i analizës së tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare u përgatit në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe duke marrë në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian, me synim përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile në Republikën e Shqipërisë, karakteristikat e tregut vendas, si dhe trajton zhvillimet në treg dhe pritshmëritë e AKEP-it për të ardhmen e afërt dhe të mesme, si dhe masat rregulluese përkatëse për sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregjet përkatës të analizuar.

Dokumenti gjithashtu përmban dhe një rishikim të ecurisë dhe zhvillimeve të tregut me pakicë të telefonisë celulare nga analiza e vitit 2019, efektet e rregullimit në tregun celular si dhe paraqet përfundimet e analizës për operatorët me statusin me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) dhe masat përkatëse rregulluese për tregjet e analizuara, sigurisht, pas marrjes në konsideratë të komenteve të paraqitura nga palët në Këshillimin Publik.

Në konkluzionet e analizës për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve mobile, AKEP-i ka marrë në konsideratë rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare sipas vendimit nr. 10, datë 22.7.2021.

¹ https://akep.al/wp-content/uploads/2024/10/2024_014_16022024.pdf

Nëpërmjet miratimit të kësaj Analize Tregu, AKEP-i vendosi përcaktimin e sipërmarrësve One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., si sipërmarrës me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare.

AKEP-i përcaktoi për të dy sipërmarrësit masa rregullatore të tilla si: detyrimi për mosdiskriminim, për transparencë, detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit, si dhe detyrimi për kontroll i tarifave. Përcaktimi i AKEP-it për masat rregulluese për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare u hartua duke marrë në konsideratë opsionet e mundshme të propozuara për rregullimin e MTR kombëtar, vlerësimin e opsioneve të dhëna për thirrjet ndërkombëtare hyrëse, si dhe komentet e paraqitura në Këshillim Publik.

MTR për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT do të bëhet bazuar në përshkallëzimin e tarifave² nëpërmjet *glide path*, kjo në zbatim të rezultateve të modelit të kostove miratuar me VKD nr. 10, datë 22.7.2021. Tarifa e vendosur prej 1.02 lekë u aplikua nga operatorët në 1 tetor 2024, ndërkohë që në vitin 2025 do të aplikohen tarifat 0.89 lekë në datën 1 prill, dhe 0.75 lekë në datën 1 tetor 2025, duke u përafëruar dhe barazuar me BE-në.

Në këtë Analizë Tregu në një seksion të veçantë³ është trajtuar dhe mundësia e futjes së operatorëve të rrjetit virtual mobile (MVNO) në tregun e shërbimeve celulare si një faktor i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të konkurrencës në tregun e telefonisë mobile.

AKEP-i në këtë proces vendimmarrje, duke konsideruar faktorët *pro* dhe *kundër* të referuar në dokumentin e analizës për shërbimin e terminimit të thirrjeve mobile, karakteristikat dhe rrethanat kombëtare, qasjen e Komisionit Evropian për mosrregullimin e thirrjeve ndërkombëtare nga dhe drejt vendeve të treta (jashtë BE-së), ka vendosur lëniën në derregullim të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, deri në fazën e ardhshme të Analizës së Tregut ku do të analizohet edhe mundësia për të orientuar tarifat drejt një 'euro tarife' të njëjtë për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në Shqipëri, njësoj si tarifa e unifikuar e BE-së në tregjet e terminimit.

Gjithashtu, AKEP-i ka vlerësuar se masa rregullatore për mosdiskriminim e thirrjeve mobile on-net/off-net e vendosur në vitin 2014, ka dhënë efektin e saj në përputhje me qëllimin e vendosur, dhe si të tillë ka vendosur që kjo masë të tërhiqet në referencë me parashikimet e nenit 36, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, duke dhënë argumentet përkatës.

2: "Krahas analizës së tregjeve me shumicë të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, AKEP-i, duke iu referuar edhe praktikave më të mira evropiane, të kryejë një studim për vlerësimin e mundësive dhe impaktit të hyrjes së MVNO-ve në tregun e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme, si dhe sigurimin e një kuadri rregullator të favorshëm për hyrjen e MVNO-ve në treg, në përputhje edhe me rekomandimin e AK-së për AKEP-in."

² Tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet mobile në datën 1.10.2024 shkoi 1.02 lekë; më 1.4.2025 do të shkojë 0.89 lekë dhe më 1.10.2025 do të shkojë 0.75 lekë.

³ <https://akep.al/wp-content/uploads/2024/03/Analize-tregu-e-telefonise-celulare.pdf>

Grupi i Punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të AKEP nr. 136, datë 12.1.2024, “Për kryerjen e një studimi lidhur me vlerësimin e kuadrit ligjor, rregullator, teknik dhe administrativ në fuqi për krijimin dhe hyrjen në treg të operatorëve virtualë të shërbimeve të lëvizshme (MVNO)” ka kryer një studim për vlerësimin e mundësive për hyrjen në treg të operatorëve virtualë të shërbimeve të lëvizshme (MVNO), studim i cili vjen në përmbushje të pikës 4 të Rezolutës së Kuvendit të RSH.

Në këtë studim është bërë një përshkrim mbi mënyrën e funksionimit të MVNO-ve dhe llojet e tyre, bazës ligjore dhe rregullatore në Shqipëri dhe në disa nga vendet e Bashkimit Evropian. Operatorët e rrjeteve celulare (MNO) ofrojnë akses në nivel shumice për operatorët e rrjetit virtual celularë (MVNO) mbi baza komerciale, duke ju mundësuar këtyre të fundit të ofrojnë shërbime celulare me pakicë duke u mbështetur në inputet e blerjes së aksesit me shumicë nga operatorët celularë.

Për herë të parë në historinë e akordimit të frekuencave (3400 mhz- 3800 mhz) në vendin tonë, AKEP-i ka vendosur detyrimin e fituesve të tenderit t’i japin akses MVNO-ve. Përcaktimi, pjesë e autorizimit individual me të cilin pajisen operatorët fitues, është i formuluar si vijon: “Mbi bazën e një kërkesë të arsyeshme, mbajtësi i autorizimit është i detyruar të negociojë përdorimin e përbashkët të kapaciteteve radio me ofrues shërbimesh të përshtatshëm (të tillë si MVNO), në mënyrë jodiskriminuese.”

Nga ana tjetër, Autoriteti i Konkurrencës në vendimin e vet nr. 869, datë 8.3.2022, ka vendosur detyrimin e shoqërisë mëmë të ONE Albania “të mos krijojë pengesa të paligjshme për hyrjen e operatorëve të rinj në treg (MNVO).”

Në bazë të kuadrit rregullator ekzistues për komunikimet elektronike në Shqipëri është aktualisht e mundur që një operator i tretë, MNO apo MVNO, të shprehë interes dhe të përfitojë interkoneksion në rrjetin e dy operatorëve ekzistues.

Deri më sot nuk është paraqitur asnjë kërkesë apo ankim pranë AKEP-it dhe, për aq sa jemi në dijeni, as pranë Autoritetit të Konkurrencës me objekt të kësaj natyre.

3: "AKEP-i të miratojë për Këshillim Publik dokumentin "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të brezit të frekuencave 3400-3800 MHz", me qëllim dhënien brenda vitit 2024 të të drejtave të përdorimit për ndërtimin e rrjeteve të gjeneratës së pestë celulare (5G), të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti."

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit 9918/2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe detyrës në Rezolutën e Kuvendit, Këshilli Drejtues i AKEP-it, me vendimin nr. 3⁴, datë 7.2.2024, ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz".

Procedura e Këshillimit Publik u zhvillua nga data 7.2.2024 deri në datën 7.4.2024.

Në vijim, Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimet nr. 10 dhe 11, datë 7.5.2024, ka miratuar qëndrimin e AKEP-it për komentet/sugjerimet e paraqitura gjatë Këshillimit Publik të dokumentit "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz" dhe propozimin për Ministrin, pas Këshillimit Publik të dokumentit "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz".

Pas konfirmimit nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për kufizimet dhe procedurën si dhe çmimin për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 3400-3800 MHz, Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 20, datë 27.8.2024, ka miratuar dokumentin e tenderit publik me procedurë të hapur me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz".

Tenderi u zhvillua në datën 17.10.2024 ku u paraqitën oferta nga të dy operatorët celularë. Në datën 24.10.2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në AKEP përfundoi vlerësimin e dokumentacionit ligjor dhe ofertave të paraqitura, ku rezultoi se të dy operatorët celularë plotësojnë kushtet e dokumentit të tenderit dhe secili prej tyre ka paraqitur oferta të vlefshme për sasi spektri 120 MHz.

Me vendimin nr. 28, datë 12.11.2024, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar:

Raportin Përmbledhës të KVO, me nr. 2264/59 prot., datë 4.11.2024.

Njoftimin dhe Botimin e Fituesit, shoqëria One Albania sh.a., për bllokun A: 3420-3500 MHz (sasi spektri 80 MHz) me çmim 3,624,000 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e katër mijë) Euro dhe bllokun D - brenda brezit 3500-3720 MHz (sasi spektri 40 MHz), të frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, me çmim 1,812,000 (një milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë) Euro.

Njoftimin dhe Botimin e Fituesit, shoqëria Vodafone Albania sh.a., për bllokun B: 3720-3800 MHz (sasi spektri 80 MHz) me çmim 3,624,000 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e katër mijë) Euro dhe bllokun C - brenda brezit 3500-3720 MHz (sasi spektri 40 MHz), të frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, me çmim 1,812,500 (një milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro.

⁴ https://akep.al/wp-content/uploads/2024/02/2264_005_07022024.pdf

Bazuar në dokumentin e tenderit, të dy sipërmarrësit, përpara pajisjes me Autorizim Individual, kanë shlyer të gjitha pagesat e përcaktuara në dokumentin e tenderit brenda 7 ditëve për Buxhetin e Shtetit dhe brenda 10 ditëve nga njoftimi i fituesit. Në dokumentin e tenderit, përcaktohet se çmimi i ofertës, i ofruar nga ofertuesi që fiton të drejtën e përdorimit të brezit të frekuencave të tenderuara, derdhet prej tij në Buxhetin e Shtetit si pagesë me këste:

- Kësti i parë: 50%: brenda 7 ditëve nga marrja e Njoftimit të Fituesit;
- Kësti i dytë: 50%: 6 muaj pas dhënies së Autorizimit Individual.

Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., në datën 13.11.2024, ka shlyer në llogarinë e Qeverisë Shqiptare këstin e parë prej 50%, në vlerën 2,718,250 Euro.

Sipërmarrësi One Albania sh.a., në datën 14.11.2024, ka shlyer në llogarinë e Qeverisë Shqiptare këstin e parë prej 50%, në vlerën 2,718,000 Euro.

Brenda afatit të sipërcituar do të ndiqet me rigozitet nga AKEP shlyerja e kësteve të dyta nga operatorët celularë për buxhetin e shtetit.

Në përfundim, me vendimin nr. 29, datë 25.11.2024, Këshilli Drejtues i AKEP-it ka miratuar Autorizimin Individual të sipërmarrësit One Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz (3420-3540 MHz, spektër i paçiftuar)", me afat 15 vjeçar.

Me vendimin nr. 30, datë 25.11.2024, Këshilli Drejtues i AKEP-it ka miratuar Autorizimin Individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz (3680-3800 MHz, spektër i paçiftuar)", me afat 15 vjeçar.

Shërbimet 5G, me frekuencat e sipërcituara, kanë nisur në datën 26.11.2024 në qytetin e Tiranës nga të dy operatorët celularë.

2. Rekomandime në proces realizimi

1: "AKEP-i gjatë vitit 2024, krahas proceseve të monitorimit/inspektimit të zbatimit nga operatorët të detyrimeve dhe rekomandimeve të lëna në inspektimet e mëparshme, të rishikojë Rregulloren e Portabilitetit duke synuar përmirësimin e procesit të portimit, veçanërisht përmes vendosjes së detyrimeve dhe përgjegjësisve edhe për operatorin dhënës për informimin e pajtimtarit për arsyet e refuzimit të kërkesës për portim."

AKEP-i gjatë vitit 2024 ka punuar për draftimin e ndryshimeve në Rregulloren nr. 43/2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit", të cilat përfshijnë ndër të tjera:

- vendosjen e detyrimeve për operatorin dhënës (ODH) të numrit celular për komunikimin dhe informimin e pajtimtarit në lidhje me arsyen e refuzimit të kërkesës për portim, duke i dërguar njëkohësisht pajtimtarit nëpërmjet SMS-së dhe Numrin Unik Personal të regjistruar të ODH (për rastet e refuzimit për shkak të ID), ose vlerën monetare të detyrimit kontraktor që duhet të paguajë pajtimtari që të vijojë me portimin e numrit (në rast të refuzimit të kërkesës për detyrime kontraktore të pashlyera);
- saktësimet e disa termave kryesorë si detyrime kontraktore të pashlyera, numër aktiv etj.;

- implementimin e statusit pezull apo miratimit me kusht për kërkesat për portim të numrave celularë që kanë detyrime kontraktore të pashlyera.

Strukturat e AKEP-it, gjatë muajit korrik 2024, kanë zhvilluar takime me operatorin e platformës CRDB në lidhje me aspektet teknike për draft-ndryshimet e mësipërme në Rregulloren e Portabilitetit.

Në kuadër të ligjit të ri 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP-i ka në plan të realizojë disa ndryshime në Rregulloren e Portabilitetit të Numrit, duke përfshirë përcaktimet e reja ligjore të lidhura me këtë proces, siç është neni 145 i ligjit. Aty do të trajtohen aspekte të ndryshme të portabilitetit të numrit, që është një temë e rëndësishme për përdoruesit e shërbimeve të telefonisë.

Një hap i rëndësishëm është Këshillimi Publik që do të organizohet nga AKEP-i në vitin 2025. Ky këshillim ka për qëllim të përfshijë aktorë të ndryshëm, përfshirë operatorët e shërbimeve dhe qytetarët, në mënyrë që të sigurohet një proces transparent dhe i drejtë për implementimin e ndryshimeve ligjore.

Ndërkohë që, gjatë vitit 2024 në AKEP u depozituan 943 ankesa të pajtimtarëve në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim të numrit celular, që përbën një rënie nga 1371 ankesa që ishin në vitin 2023. Trendi mujor i numrit të ankesave për portim tregon një rënie të ndjeshme të tyre pas tremujorit të parë 2024 dhe në muajt në vijim. Megjithatë, ndryshimet në Rregulloren e Portabilitetit të cituara më sipër, synojnë përmirësimin e procesit dhe adresimin e problematikave të evidentuara.

2: "AKEP-i, duke marrë shkas edhe nga sulmi kibernetik ndaj sistemeve të një prej kompanive celulare në vend, të kërkojë marrjen e masave shtesë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të bërë të mundur garantimin e integritetit dhe pacenueshmërisë së rrjeteve dhe infrastrukturave kritike të tyre, si dhe ruajtjen e të dhënave personale të përdoruesve të tyre."

Në zbatim të kësaj pike të rezolutës, AKEP ka marrë një sërë masash për të bërë të mundur garantimin e integritetit dhe pacenueshmërisë së rrjeteve dhe infrastrukturave të komunikimeve elektronike. Me urdhrin nr. 57, datë 22.4.2024, nr. prot., 1078/1, datë 22.4.2024, “Për kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse të situatës së sigurisë kibernetike në infrastrukturat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike”, është ngritur grupi i punës për të bërë një vlerësim të të gjithë aspekteve që lidhen me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare.

Referuar këtij urdhri, grupi i punës mori në shqyrtim situatën në të gjithë sektorin. U ftuan në takime të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të kuptuar situatën aktuale të sektorit në aspektin e Sigurisë Kibernetike, sfidat që na presin si dhe hapat që duhet të ndiqen në të ardhmen.

Gjatë takimeve, AKEP ka kërkuar nga sipërmarrësit masat teknike specifike, masat organizative dhe politikat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.

Gjithashtu, bazuar edhe në ndryshimet ligjore përsa i përket komunikimeve elektronike, veçanërisht miratimin e ligjit 54/2024, AKEP ka intensifikuar punën për ndryshimet rregullatore që kanë të bëjnë me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke u bazuar në praktikën më të mira të BE-së. Pjesë e akteve rregullatore që do të dalin në zbatim të ligjit 54/2024, do të jenë edhe masat teknike, organizative dhe politikat e diskutuara gjatë takimeve me sipërmarrësit.

Të gjitha detyrimet e sipërmarrësve në lidhje me implementimin e akteve ligjore dhe rregullatore që lidhen me sigurinë, integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, por edhe me mbrojtjen e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit, janë objekt i inspektimeve dhe auditeve periodike dhe të rastësishme nga AKEP-i. Gjithashtu, AKEP është në komunikim të përditshëm me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të monitoruar situatën, por edhe për të ndarë vulnerabilitete të ndryshme apo informacione që ndihmojnë në parandalimin e incidenteve kibernetike.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, AKEP-i ka një rol specifik në garantimin e sigurisë kibernetike në shkallë vendi, për arsye të mbikëqyrjes sistematike që ushtron mbi implementimin dhe respektimin e standardeve të sigurisë nga sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Në këtë kuadër, bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) ka qenë i ngushtë si në aspektin parandalues ashtu edhe në aspektin e mitigimit të incidenteve kibernetike. Në shumë raste ky bashkëpunim është shtrirë edhe te sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare. Komunikimi ndërmjet dy autoriteteve ka qenë dhe vazhdon të jetë i përditshëm, bazuar në shkëmbime informacioni, por edhe në asistencë të ndërsjellë teknike. Në shumë raste, në frymën e bashkëpunimit institucional, dhënia e asistencës nga AKEP është shtrirë edhe jashtë fushës së përgjegjësisë së institucionit, duke iu përgjigjur pozitivisht kërkesave për asistencë nga institucione ose shërbime jetike për qytetarët.

AKEP-i ka vijuar të ketë komunikim 24/7 me të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, për të evidentuar problematikat e mundshme dhe për t'i paraprirë incidenteve të mundshme kibernetike në sektorin e komunikimeve elektronike.

Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur asnjë incident kibernetik të raportuar nga ana e sipërmarrësve.

3: "AKEP-i gjatë inspektimeve që do të zhvillojë pranë ofruesit të shërbimit universal "Posta Shqiptare" të vijojë të kërkojë përmbushjen e detyrimit për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit, krahas implementimit të projektit për vendosjen e kutive postare pranë degëve të postës me kod unik, ku qytetarët mund të tërheqin pakot në çdo orë përmes një kodi specifik, duke evituar qëndrimet në radhë të qytetarëve për tërheqjen e pakove, problem i cili është bërë shqetësues veçanërisht në Tiranë."

Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se AKEP-i, si autoriteti rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, monitoron në mënyrë permanente veprimtarinë e ofruesit të shërbimit universal postar "Posta Shqiptare" sh.a..

Në vijim të inspektimeve të kryera tek Posta Shqiptare sh.a., është kërkuar respektimi i detyrimit për dorëzimin e pakove në adresë të marrësit, në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacion. Nga inspektimi i fundit, i kryer në muajin dhjetor 2024, është konstatuar se ka pasur rënie të numrit të objekteve të dala për dorëzim në adresë. Faktorë që kanë ndikuar në këtë rënie janë: mungesa e mjeteve të transportit për shkak të procedurave të prokurimit për blerjen e makinave dhe motorëve, në kushtet e përfundimit të kontratës së leasing, si dhe arsytet që kanë të bëjnë me adresat e paplota të marrësve, apo preferencave të vetë klientëve për t'i tërhequr pakot në zyrat postare. Gjithsesi, mbetet ende i lartë numri i dërgesave që nuk dorëzohen në adresë, veçanërisht në qytetin e Tiranës, pasi arsye kryesore mbetet fakti se adresa e marrësit është e paplotë (me vetëm një element). Aktualisht, referuar raportimeve të Postës Shqiptare, përqindja e dorëzimit në adresë kundrejt paketave dhe kolive të dala për dorëzim në adresë është në masën 43.1%.

Në këtë kuadër, Posta Shqiptare sh.a., ka vijuar me masa të menjëhershme për të rritur kapacitetet logjistike dhe për të përmirësuar procesin e verifikimit dhe regjistrimit të adresave të sakta të klientëve, në mënyrë që të garantohet ofrimi i një shërbimi në përputhje me standardet dhe pritshmëritë. Aktualisht, ka përfunduar procedura e prokurimit për 55 motorë me tre rrota 100% elektrinë, të cilët do të vihen në përdorim në fund të 3-mujorit të parë të vitit 2025. Gjithashtu, është në procedurë prokurimi blerja e 44 motorëve me dy rrota, të cilët pritet të vendosen në përdorim më 1 maj 2025.

Për të përmirësuar shërbimin ndaj qytetarëve dhe për të ofruar kualitet dhe besueshmëri në tregun postar, së fundmi Posta Shqiptare ka investuar në vënien në punë të një produkti novator, siç janë dhe kutitë postare elektronike, ku aktualisht po vihen në funksionim 13 kuti postare elektronike, me 313 sirtarë në 10 filiale të saj. Kutitë postare elektronike të sigurta (bankomat postar) do t'i shërbejnë kryesisht një target grupi të caktuar konsumatorësh të tregtisë *online*.

4: "AKEP-i të vijojë të monitorojë me rigozitet ecurinë e mbulimit me shërbim celular të akseve rrugore të vendit duke kërkuar nga të dy operatorët implementimin e stacioneve të reja të dedikuara të parashikuara për vitin 2023, si dhe afate të sakta për ndërtimin e stacioneve të reja të dedikuara të parashikuara për vitin aktual dhe në vijim. Mbulimi me shërbim celular të akseve rrugore të vendit, si dhe i zonave turistike, duhet të jetë prioritet i punës së AKEP-it, për më tepër kur pritet që numri i turistëve të jetë në rritje."

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) si organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike realizon në mënyrë të vazhdueshme monitorimet e treguesve të

cilësisë së shërbimit QoS (*Quality of service*) të telefonisë së lëvizshme në të gjitha zonat e Republikës së Shqipërisë.

AKEP-i vijon të monitorojë ecurinë e mbulimit me shërbim celular të akseve rrugore të vendit duke kërkuar nga të dy operatorët implementimin e stacioneve të reja të dedikuara. Monitorimi specifik i akseve kryesore të vendit, së bashku me raportet, të cilët do të japin një panoramë më të qartë të mbulimit me shërbim të telefonisë së lëvizshme në këto akse, pritet të përmbyllet gjatë muajit dhjetor 2024.

Aktualisht, bazuar në rezultatet e monitorimit, si dhe në informacionet e operatorëve të telefonisë së lëvizshme, situata paraqitet si më poshtë:

Mbulimi me shërbime të telefonisë së lëvizshme i akseve rrugore dhe zonave turistike

- ✓ Për vitin 2023 operatori “One Albania” sh.a., ka ndërtuar 53 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.
- ✓ Për vitin 2024 operatori “One Albania” sh.a., ka ndërtuar 13 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike, si dhe parashikon të ndërtojë edhe 5 stacione brenda vitit 2024.
- ✓ Për vitin 2025 operatori “One Albania” sh.a., ka planifikuar ndërtimin e 9 stacioneve (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.
- ✓ Për vitin 2023 operatori “Vodafone Albania” sh.a., ka ndërtuar 13 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.
- ✓ Për vitin 2024 operatori “Vodafone Albania” sh.a., ka ndërtuar 12 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.
- ✓ Për vitin 2025 operatori “Vodafone Albania” sh.a., ka përgatitur buxhetet përkatëse për ndërtimin e stacioneve për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.

Për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nevojitet ndërtimi i siteve (ministacioneve) të reja nga operatorët. Ndërtimi i këtyre siteve nga operatorët po hasin vështirësi në marrjen e lejeve mjedisore, refuzimin e banorëve të godinave ku janë përcaktuar ndërtimi i këtyre siteve, si dhe mosrinovimi i qerave të siteve (ministacioneve) aktuale nga institucionet shtetërore. Kërkesat për lejet për stacionet e reja si dhe problematikat e mësipërme janë paraqitur nga operatorët pranë MIE.

Mbulimi me shërbime të telefonisë së lëvizshme në plazhe

- ✓ Për vitin 2023 operatori “One Albania” sh.a., ka ndërtuar 5 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në plazhe.

- ✓ Për vitin 2024 operatori “One Albania” sh.a., ka ndërtuar 10 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në plazhe, si dhe parashikon të ndërtojë edhe 1 stacion brenda vitit 2024.
- ✓ Për vitin 2025 operatori “One Albania” sh.a., ka planifikuar ndërtimin e 6 stacioneve (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në plazhe.
- ✓ Për përmirësimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme në plazhe përveç optimizimeve, për vitin 2023 operatori “Vodafone Albania” sh.a., ka ndërtuar 9 stacione (macro dhe micro).
- ✓ Për vitin 2024 operatori “Vodafone Albania” sh.a., ka ndërtuar 11 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në plazhe.
- ✓ Për vitin 2025 operatori “Vodafone Albania” sh.a., ka përgatitur buxhetet përkatëse për ndërtimin e stacioneve të reja .

Gjithsesi, në zonat ku mbulimi me sinjal nuk i përmbush parametrat KPI (Key Performance Indicators), operatorët, pas ndërhyrjes së strukturave të AKEP-it, kanë parë mundësinë e optimizimit të antenave ekzistuese që mbulojnë zonën si edhe vendosjen e stacioneve provizorë, deri në ndërtimin e stacioneve të reja të dedikuara për mbulimin e zonave gjeografikisht të izoluara, për të cilat pritet zbardhja e lejeve nga institucionet përkatëse.

Në kuadër të masave për përmirësimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në bashkitë e vendit, akseve rrugore, zonave bregdetare si dhe zonave turistike, AKEP vijon komunikimin dhe monitorimin e operatorëve, me qëllim përmirësimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme për përmbushjen e parametrave KPI, sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 16, datë 16.4.2010, për “Treguesit e cilësisë së shërbimit” dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

AKEP ka komunikuar në mënyrë sistematike me organet shtetërore përkatëse për t’i dhënë përparësi lejeve të ndërtimit, për përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave të tyre, ku marrja e një leje ndërtimi dhe zbardhja e tyre mos të jetë një proces i gjatë dhe i mundimshëm, kjo për të pasur një mbulim cilësor, i cili rrjedhimisht çon edhe në cilësi shërbimi më të lartë për pajtimtarin.

Për një pjesë të spektrit të frekuencave në brezat 900 dhe 1800 MHz, të dy operatorëve celularë u përfundonte afati i vlefshmërisë në mesin e vitit 2024.

Bazuar në VKM nr. 496, datë 22.7.2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”, i ndryshuar, AKEP dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zhvilluan të gjitha procedurat e përcaktuara në këtë VKM për rinovimin e autorizimeve individuale që u përfundonte afati i vlefshmërisë.

Në përfundim të procesit të negocimit mes Komisionit *ad-hoc* të Negocimit të ngritur nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe dy operatorëve celularë, është nënshkruar Akti i dakordësisë, i cili ka përcaktuar çmimin e rinovimit të secilit autorizim individual dhe disa

kushte për sigurimin e mbulimit dhe cilësinë e shërbimit. Këto kushte janë përfshirë nga AKEP në autorizimet e reja individuale të rinovuara me afat 15 vjet.

Kushtet për sigurimin e mbulimit dhe cilësinë e shërbimit:

1. Operatorët celularë do të sigurojnë përforsimin e mbulimit me shërbim të popullsisë deri në 99% të zonave të banuara për çdo qark, përkundrejt minimumit prej 95% që përcaktohej në autorizimin e mëparshëm.
2. Operatorët celularë të sigurojnë që mbulimi me shërbim në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë minimalisht 95%, e ku posaçërisht:
 - Për tërësinë e gjatësisë së akseve rrugore kombëtare të kategorive A (autostradat) dhe B (rrugët interurbane kryesore) sipas legjislacionit në fuqi, tunelet, zonat e përfshira në projekte zhvillimore dhe me rëndësi të veçantë, mbulimi duhet të jetë mbi 99%, ndërsa për akset rrugore të kategorive C e në vijim, mbulimi duhet të jetë mbi 96 %.
 - Për zonat turistike (brenda përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura), mbulimi duhet të jetë deri në 99%.
3. Operatorët celularë, brenda muajit shkurt të çdo viti, përgjatë 5 vjeçarit të parë nga lëshimi i Autorizimit Individual, depozitojnë pranë AKEP-it një raport të detajuar të ecurisë së realizimit të kushteve të mësipërme të mbulimit dhe të cilësisë së shërbimit, në veçanti për zonat aktualisht të pambuluara.

AKEP-i, përveç monitorimeve periodike vjetore të frekuencave, sipas përcaktimeve të mësipërme, do të shqyrtojë dhe verifikojë të dhënat që do të paraqiten çdo muaj shkurt në raportin e operatorëve celularë për mbulimin dhe cilësinë e shërbimit.

5: "Pas miratimit të ligjit të ri për komunikimet elektronike, AKEP-i të marrë masat e nevojshme për miratimin në një kohë sa më të shkurtër të akteve të reja rregullatore, në mënyrë të veçantë miratimin brenda vitit 2024 të metodologjisë për përllogaritjen e masës së gjobave, si dhe procedurën e veprimtarisë inspektuese në zbatim të ligjit të ri."

Pas njohjes me detyrën e lënë nga Rezoluta e Kuvendit, AKEP-i ka ngritur një grup pune në zbatim të urdhrin nr. 122, datë 21.8.2024, të Kryetarit të KD-së, "Për ngritjen e grupit të punës për planifikimin e hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 54, datë 30.5.2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Grupi i punës ka finalizuar planin e punës për përcaktimin e afateve, fazave dhe procesin për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në ngarkim të AKEP-it.

Me qëllim zbatimin e kësaj pike të rezolutës, AKEP-i ka ngritur me Urdhrin nr. 123, datë 21.8.2024, të Kryetarit të KD, grupin e punës përgjegjës për hartimin e ndryshimeve në Rregulloren nr. 46, datë 27.10.2016, “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim tashmë ka hartuar metodologjinë për përlogaritjen e masës së gjobave, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 54/2024, datë 30.5.2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Dokumenti i hartuar dhe miratimi i një metodologjie standarde për llogaritjen e masës së gjobave do të shmangë arbitraritetin dhe subjektivitetin në vendosjen e gjobave. Kjo siguron që inspektorët dhe subjektet e kontrolluara të kenë pritshmëri të qarta mbi sanksionet e mundshme. Metodologjia siguron që gjobat të jenë të bazuara në shkallën e shkeljes dhe ndikimin e saj, duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Përdorimi i një metodologjie të unifikuar është në përputhje me standardet ndërkombëtare për rregullimin dhe zbatimin e ligjeve në fusha të ndryshme inspektuese. Një sistem i qartë dhe i drejtë i gjobave kontribuon në uljen e rasteve të shkeljeve përmes forcimit të ndërgjegjësimit dhe ndëshkimit efektiv.

Pas hyrjes në fuqi në datën 20 dhjetor 2024, të ligjit nr. 54/2024, AKEP-i po përgatit procedurën për procesin e Këshillimit Publik të dokumentit, duke vlerësuar se miratimi i Metodologjisë për llogaritjen e masës së gjobave në procedurën inspektuese është një hap i domosdoshëm për të garantuar efektivitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese.

II. KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

1. Miratimi i ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, që ka hyrë në fuqi në datën 20 dhjetor 2024, transponon pjesërisht Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 11.12.2018, “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”.

Në koherencë me objektivat dhe strategjitë e politikave sektoriale, legjislacioni i ndryshuar ofron një model të ri për zhvillimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike mbi bazën e një rregullimi simetrik, bashkëpërdorimin e infrastrukturës dhe burimeve, krijimin e lehtësirave për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve në një mjedis rregullator më të përshtatshëm, bazuar në zhvillimet teknologjike. Implementimi i dispozitave të reja normon zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve universale të përbalueshme dhe gjithëpërfshirëse, përmbush objektivat politike për zhvillimin e infrastrukturës digjitale dhe ofrimin e shërbimeve elektronike si dhe mundëson adresimin e problematikave të tregut.

Vlen të theksohet se, risi në kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike përbën edhe parashikimi për kryerjen e vrojtimit gjeografik për rrjetet *broadband* nga AKEP, në bashkëpunim me ministrin dhe institucionet e tjera kompetente, duke ndikuar në rritjen e transparencës për sa i përket mbulimit *broadband* dhe VHCN.

Një qasje e ndryshme rregullatore evidentohet edhe në parashikimet lidhur me detyrimet e shërbimit universal, veçanërisht me ofrimin e aksesit *broadband*.

Ligji nr. 54/2024 përcakton që gjatë rishikimeve periodike të vendimeve rregullatore, AKEP-i merr në konsideratë opinionet, rekomandimet, udhëzimet, këshillimet apo praktikatat më të mira rregullatore të zhvilluara nga BEREC, në harmoni me praktikatat e BE-së.

Dispozitat materiale të ligjit parashikojnë detyrime shtesë për organet, veprimtaria e të cilëve ndërthuret me zbatimin e këtij ligji, dhe përcaktojnë kompetencat duke sanksionuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga traktatat ndërkombëtare ku aderon Republika e Shqipërisë.

Si synimet kryesore të ligjit përmendim:

- Promovimin e zhvillimit të tregut të komunikimeve elektronike;
- Nxitjen e konkurrencës efektive dhe të qëndrueshme në këtë treg;
- Garantimin e aksesit universal në shërbimet e komunikimeve elektronike për të gjithë qytetarët;
- Mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të përdoruesve fundorë;
- Përdorimin e efektshëm të burimeve të kufizuara, si frekuencat dhe numrat;
- Sigurimin e integritetit dhe sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Gjatë procesit të diskutimit të projektligjit “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në periudhën prill - maj 2024, përfaqësues të AKEP-it dhe MIE-s kanë marrë pjesë në seancat e diskutimit të zhvilluara nga Komisionet përkatëse të Kuvendit.

2. Ecuria e tregut të komunikimeve elektronike


Gjatë vitit 2024, shërbimet e komunikimeve elektronike kanë vijuar të jenë mbështetës të rëndësishëm të lehtësimit të komunikimit ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorit fundor me aktorë të tjerë ndërlidhës të sferës ekonomiko-shoqërore, përfshirë Qeverinë, Bizneset, etj. Ndryshimet strukturore në tregun e komunikimeve elektronike, kryesisht në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare, venë në dukje nevojën në rritje të rolit rregullator për të qenë mbështetës të rëndësishëm në rrethanat e reja që u krijuan si rezultat i ristrukturimit të tregut, për të bërë të mundur vijimin e praktikës së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike cilësore në raport të drejtë ndërmjet kërkesë/ofertës për produkte dhe shërbime në tregun përkatës.

Zhvillimet periodike të tregut të komunikimeve elektronike kushtëzohen jo vetëm nga tendenca e tij për të kaluar drejt një konkurrence efektive, por edhe si nevojë e brendshme për të qenë në koherencë me kërkesat gjithnjë në rritje që sjell zhvillimi i inovacionit dhe teknologjisë në fushën përkatëse, gjë e cila impakton nevojën e operatorëve celularë dhe të rrjeteve fikse për të investuar në përmirësimin e kapaciteteve teknologjike dhe sigurisë së rrjeteve për ofrimin e shërbimeve të tyre.

2.1 Të ardhurat dhe investimet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike

Të ardhurat e sipërmarrësve nga komunikimet elektronike në vitin 2024 ishin 39.3 miliardë lekë, duke shënuar rritje me rreth 4% nga viti i kaluar. Të ardhurat e sipërmarrësve nga shërbimet e ofruara nëpërmjet rrjeteve celulare ishin rreth 28 miliardë lekë duke vijuar të zënë peshën më të madhe me 71% të totalit të të ardhurave, ndërsa të ardhurat nga shërbimet nëpërmjet rrjeteve fikse ishin 11 miliardë lekë, apo 29% e totalit të të ardhurave të tregut të komunikimeve elektronike.

Figura 1. Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike 2020-2024 (milion lekë)




Të ardhurat totale të sipërmarrësve nga shërbimet/rrjetet celulare në vitin 2024 u rritën me rreth 10% krahasur me vitin 2023, ndërkohë që të ardhurat nga shërbimet/rrjetet fikse u reduktuan me rreth 4%, ndikuar kryesisht nga rënia e të ardhurave të One Albania.

Të ardhurat nga shërbimet celulare

Përgjatë vitit 2024 ofruesit e shërbimeve të rrjeteve celulare kanë realizuar të ardhura totale rreth 2.5 miliard lekë më të larta se ato të raportuara në vitin 2023, duke arritur në nivelin e rreth 28 miliardë lekë.

Figura 2. Të ardhurat totale të operatorëve celularë (në milion lekë)




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP

Edhe pse që nga viti 2023 sipërmarrësi One Albania filloi ofrimin e shërbimeve si i vetëm, pas bashkimit të One Telecommunications me Albtelcom, sërish për vitin 2024 sipërmarrësi me të ardhurat më të larta të gjeneruar në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile mbetet Vodafone Albania, me rreth 58% të totalit të këtij tregu. Të ardhurat e gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve mobile me shumicë përbëjnë rreth 18% të totalit të të ardhurave dhe pjesa tjetër rreth 82% gjenerohen nga tregu i pakicës.

Të ardhurat nga shërbimet fikse


Të ardhurat e sipërmarrësve nga shërbimet/rrjetet fikse në vitin 2024 ishin afërsisht 11.4 miliardë lekë, duke pësuar rënie me rreth 4% nga periudha pararendëse, rënie e cila është diktuar nga rënia e të ardhurave të sipërmarrësit One Albania nga rrjetet fikse me rreth 1 miliardë lekë.

Figura 3. Të ardhurat totale të operatorëve të rrjeteve fikse (në milion lekë)



Të ardhurat e gjeneruara nga sipërmarrësit e mëdhenj dhe të mesëm përbëjnë rreth 78% të totalit të të ardhurave të gjeneruara për vitin 2024.

Figura 4: Pjesë e tregut për të ardhurat sipas operatorëve kryesorë fiks në 2024



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën sa më sipër, vërehet se sipërmarrësi me pjesën më të madhe në treg për sa i përket të ardhurave është One Albania me rreth 27% të tregut, i ndjekur nga Vodafone Albania me rreth 24% dhe operatorët e tjerë kryesorë që luhaten në kufijtë 3-8%.

Përgjatë vitit 2024, sipërmarrësit e rrjeteve fikse kanë kryer rreth 2.86 miliardë lekë investime në rrjetet e tyre duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2023 ku kjo shifër ishte rreth 2.7 miliardë lekë. Sipas raportimeve, edhe në këtë vit investimet janë kanalizuar kryesisht në funksion të përmirësimit të aksesit të shërbimeve broadband rreth 87% e totalit, ku ndër

investimet kryesore është fokusimi drejt zhvendosjes së rrjeteve të transmetimit nga teknologjia DSL drejt teknologjisë me fibër.

2.2.Shërbimet dhe rrjetet celulare

Në tabelën në vijim paraqiten disa nga treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare përgjatë periudhës 2020 – 2024, bashkë me normën e ndryshimit vjetor të dy viteve të fundit.

Tabela 1. Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2020-2024

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:						
– sipas kartave SIM	3,337,824	3,484,158	3,771,419	3,863,435	3,399,173	-12.02%
– Përdorues aktivë	2,618,880	2,635,466	2,782,226	2,614,764	2,488,380	-4.83%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:						
– Totali	2,469,850	2,789,023	2,794,443	2,796,271	2,793,308	-0.11%
– Përdorues aktivë	1,998,579	2,056,444	2,140,180	2,082,525	2,091,266	0.42%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	5,286,361,927	5,602,663,590	5,006,718,174	4,286,805,307	4,080,183,381	-4.82%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	2,306,339,577	2,501,744,337	2,159,758,675	1,649,113,325	1,628,806,950	-1.23%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	187,708,510	144,033,382	119,836,468	101,253,187	84,957,388	-16.09%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	660,604,925	555,701,627	553,607,871	412,566,297	384,719,599	-6.75%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	88,950,833	155,585,664	184,480,857	193,620,759	223,432,669	15.40%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se përgjatë vitit 2024, treguesit kryesorë të marrë në konsideratë kanë pësuar ulje në krahasim me vitin 2023, ku norma më e madhe e uljes është për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, e ndjekur nga ulja e numrit të pajtimtarëve mobile sipas kartave SIM. Treguesi që ka shfaqur përmirësim është ai i përdorimit të numrit të pajtimtarëve aktivë të shërbimit internet, tregues i cili ndikon edhe në rritjen e volumit të të dhënave (internet) të transmetuara nga rrjetet celulare, i cili ka rezultuar me rritje me më shumë se 15% krahasuar me vitin 2023. Rritja e përdorimit të internetit nëpërmjet telefonave celularë evidenton faktin se tashmë telefonat celularë e kanë ridimensionuar rolin e tyre duke kaluar nga përdorimi tradicional për kryerjen e thirrjeve zanore, drejt ofrimit të aksesit të gjerë në botën virtuale (shfletim informacionesh, transmetim të dhënash, kryerje e thirrjeve audio/video, sms, etj.), gjë e cila impakton drejtpërdrejt volumin e të dhënave të transmetuara në shërbimet celulare.

Edhe pse ka shënuar rënie, numri total i kartave SIM për vitin 2024 rezulton të jetë rreth 3.4 milionë, numër i cili reflektohet në rreth 1.4 karta SIM për banor, shifër kjo më e lartë se mesatarja e rajonit të Evropës dhe ajo globale, përkatësisht 1.25 dhe 1.12 karta SIM për banor⁵, ndërkohë numri i pajtimtarëve aktivë⁶ të shërbimeve celulare përgjatë vitit të kaluar, arriti rreth 2.5 milionë, duke shënuar rënie krahasuar me vitin e mëparshëm.

Gjatë vitit 2024 ka vijuar tendenca e ndryshimit të strukturës së pajtimtarëve, ku evidentohet se ka një ulje të numrit të pajtimtarëve me parapagim (58% nga 62% që ishte në vitin 2023), si dhe një rritje e blerjes së shërbimeve celulare përmes kontratave me paspagim, praktikë e cila

⁵ <https://www.itu.int/itu-d/reports/statistics/facts-figures-2024/>

⁶ Pajtimtar i cili ka përdorur shërbimet celulare të paktën një herë brenda tre muajve të fundit.

aplikohet gjerësisht edhe në vendet e rajonit dhe të BE-së (në vitin 2024 rezulton të jetë 42%, nga 38% që ishte në vitin 2023).

Aksesi *broadband* në rrjetet celulare 3G/4G

Numri i pajtimtarëve aktivë që kanë përdorur shërbimin internet celular në fund të vitit 2024, rezultoi të jetë rreth 2.1 milionë pajtimtarë, çka përbën një rritje me rreth 0.42% krahasuar me vitin pararendës.

Tabela 2. Numri i pajtimtarëve aktivë me akses *broadband* 3G/4G (2020-2024)

Viti	One Albania	Vodafone Albania	Albtelecom	Total	Norma e pëntimit për popullsi
2020	718,631	981,483	298,465	1,998,579	70%
2021	825,707	925,967	304,770	2,056,444	73%
2022	836,931	1,033,888	269,361	2,140,180	77%
2023	916,755	1,165,770		2,082,525	75%
2024	893,505	1,197,761		2,091,266	87%


Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP

Penetrimi për popullsi i përdoruesve aktivë celularë të aksesit *broadband* nga rrjetet 3G/4G në fund të vitit 2024 arriti në 87%, tregues ky në rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2023, rritje e cila është impaktuar nga të dhënat e CENSUS 2023 për numrin e popullsisë.

Trafiku telefonik dalës

Volumi i thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, rezulton se gjatë vitit 2024 rreth 38% e thirrjeve të realizuara kanë qenë drejt operatorëve të tjerë celularë '*off-net*' dhe rreth 61% brenda rrjetit '*on-net*', duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin e kaluar për të dy treguesit.

Figura 5. Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2020-2024



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Siç vërehet nga të dhënat e grafikut të mësipërm, edhe përgjatë vitit 2024 ka vijuar rënia e volumit total të thirrjeve dalëse, duke u ulur me rreth 5% krahasuar me periudhën pararendëse.

Pjesët e tregut e dy sipërmarrësve të ofrimit të shërbimeve celulare

Duke filluar nga 1 janari 2023 në tregun e komunikimeve elektronike ofrojnë shërbimet celulare vetëm dy operatorë, One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a..

Në lidhje me pjesët e tregut të operatorëve celularë, gjatë vitit 2024, sipërmarrësi Vodafone Albania vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.

Konkretisht, pjesët e tregut e të dy sipërmarrësve për vitin 2024, për treguesit kryesorë të tregut celular, janë sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 3 Pjesët e tregut të operatorëve celularë (2024)

	One Albania	Vodafone Albania
Përdoruesit e SIM card aktive	50%	50%
Thirrjet dalëse	45%	55%
Përdoruesit aktivë të internetit (<i>broadband</i>)	43%	57%
Volumi i të dhënave (internetit)	43%	57%
Të ardhurat totale dhe nga shërbimet me pakicë	42%	58%

Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2020 deri në 2024, sipas treguesit të përdoruesve aktiv. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njëkohësisht, tabela përmban dhe përdorimin mesatar mujor për SMS-të dalëse, si dhe për përdorues aktivë *broadband*.

Tabela 4. Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023
Thirrje dalëse	168	178	154	132	133	0%
Thirrje të marra	174	182	157	135	138	2%
MOU	342	360	311	268	271	1%
SMS Dalese	21	18	17	13	13	2%
Trafik Data (GB)	3.91	6.39	7.30	7.64	8.92	17%

Bazuar në të dhënat sa më sipër, vërehet se një përdorues celular aktiv ka kryer mesatarisht 133 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 13 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar rreth 8.92 GB në

Internet *broadband*. Treguesit e përdorimit mestar të thirrjeve janë me tendencë rritjeje shumë të vogël përgjatë vitit 2023, me 2% për thirrjet dhe rreth 17% për trafikun e të dhënave, si dhe me 2% për SMS dalëse.

Tarifimi i shërbimeve celulare

Tarifat për shërbimet e aksesit *broadband* celular të paketave variojnë sipas afatit të vlefshmërisë dhe njësive të komunikimit dhe/ose aksesit në Internet të përfshira në pagesën fikse. Programet tarifore të dy operatorëve celularë tregojnë se shumica e paketave janë të integruara: telefoni/SMS dhe akses në Internet 3G/4G. Këto paketa janë të shumëllojshme dhe mund të blihen nga përdoruesit me parapagim për konsum ditor, 3-ditor, javor, 10-ditor dhe mujor.

Për të mundësuar lehtësi në krahasueshmërinë e planeve tarifore (që janë në shumicën e rasteve paketa të integruara me shërbime telefonie, SMS dhe të dhëna) të aplikuara nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, AKEP përgatit dhe publikon në faqen e internetit informacion mbi planet dhe tarifin celulare të ofruara nga të dy sipërmarrësit, si për komunikimet brenda vendit ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve *roaming*.

Ndërkohë, ndryshimet e ndodhura në strukturën e tregut të rrjeteve/shërbimeve celulare, kanë sjellë efekte edhe në aspektin e tarifimit të shërbimeve me pakicë. AKEP e ka monitoruar në vijimësi njoftimin e ndryshimeve të planeve tarifore të sipërmarrësve mobile dhe, në kuadër të bashkëpunimit dhe kërkesave të Autoritetit të Konkurrencës, ka përcjellë pranë këtij të fundit njoftimet dhe përmbledhjen e planeve tarifore të njoftuara pranë AKEP.

Në ndryshim nga periudhat pararendëse vërehet se pas bashkimit me përthithje të One Telecommunications me Albtelecom, përgjatë periudhës 2023 – 2024 ka pasur një reduktim të konsiderueshëm të numrit të paketave ekzistuese të këtyre sipërmarrësve, sjellje kjo e vërejtur edhe tek sipërmarrësi Vodafone Albania. Ndryshimet në planet tarifore të ofruara për pajtimtarët fundorë janë reflektuar në uljen e numrit të planeve tarifore dhe larmshmërisë së tyre, veçanërisht tek pajtimtarët me parapagesë.

Tarifat për njësi komunikimi (minuta, sms, internet) për rastet e komunikimit jashtë planeve standarde ‘*Pay As You Go* (PAYG)’ brenda operatorëve vendas (brenda rrjetit të vet dhe jashtë rrjetit të vet) janë dukshëm shumë më të larta se tarifin për njësi të ofruara brenda planeve standarde, madje në disa raste edhe më të larta se tarifin PAYG përgjatë qëndrimit në *roaming* në rrjetet e operatorëve të tjerë.

Tregues të *Roaming* në Ballkanin Perëndimor


Pas marrëveshjes historike mes vendeve të Ballkanit Perëndimor për heqjen e tarifave *Roaming* mes këtyre vendeve, e cila e filloi aplikimin me datën 1.7.2021, me datën 6 dhjetor 2022 u arrit marrëveshja për reduktimin e tarifave *Roaming* mes vendeve të Ballkanit Perëndimor me vendet e tjera të Bashkimit Evropian (Zona Ekonomike Evropiane EEA).

Deklarata e përbashkët e nënshkruar për këtë qëllim përcakton se, duke filluar nga data 1.10.2023, një sërë operatorësh palë nënshkruese të deklaratës do të angazhohen në uljen

graduale të tarifave *roaming* për të dhënat (internet) midis vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, duke filluar me reduktimin në 2.4 lekë/MB apo 22 euro/GB, deri në zerim të tyre.

Figura në vijim paraqet informacion mbi ecurinë e numrit të përdoruesve të shërbimeve *roaming* dhe volumet e komunikimeve elektronike (voice, data dhe sms) gjatë qëndrimit të tyre në vendet e rajonit BP.


Figura 6. Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur shërbimet *roaming* në BP (2020-2024)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit.

Nga grafiku i mësipërm numri i pajtimtarëve që kanë përdorur shërbimet *roaming* gjatë qëndrimit të tyre në një nga vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar rritje të vazhdueshme, duke arritur rreth 860 mijë pajtimtarë në vitin 2024, me një rritje rreth 5% nga viti pararendës. Figura në vijim paraqet ecurinë e volumit të konsumit të shërbimit të internetit të pajtimtarëve të operatorëve mobile të Shqipërisë gjatë qëndrimit të tyre në vendet e rajonit, pjesë e marrëveshjes së *roaming*.

Figura 7. Të dhënat e përdorimit të internetit në *roaming* në BP (në GB)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit.

Në të njëjtën linjë me trendin rritës të numrit të përdoruesve të shërbimeve *roaming* gjatë qëndrimit të tyre në vendet e rajonit, ka vijuar edhe rritja e njësive të internetit të përdorur nga

këta pajtimtarë në *roaming*, por kjo rritje ka qenë ndjeshëm më e lartë duke rezultuar në konsum të internetit me rreth 38% më shumë se viti 2023.

Mbulimi me rrjetet e teknologjisë 3G/4G dhe 5G

Bazuar në raportimet e kryera nga të dy ofruesit e shërbimeve mobile rezulton se mbulimi i popullsisë me rrjet 3G në shkallë kombëtare ka arritur në nivelin rreth 99%. Për sa i përket mbulimit të territorit dhe popullsisë me rrjet LTE (4G), bazuar në raportimet e kryera për vitin 2024 rezulton se, sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., ka mbulimin më të gjerë me këtë teknologji, duke arritur nivelin e rreth 97% të mbulimit të territorit me rrjet 4G dhe rreth 100% të mbulimit të popullsisë. Ndërsa, sipërmarrësi One Albania sh.a., ka mbulim të territorit me rrjet 4G rreth 96% dhe mbulim të popullsisë rreth 99%.

2.3 Shërbimet dhe rrjetet fikse

Mbështetur në të dhënat e publikuara në regjistrin e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike të AKEP-it, në fund të vitit 2024 numri i sipërmarrësve që kanë njoftuar ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse në Shqipëri është 251, të cilët ofrojnë shërbime interneti (ISP), telefonisë apo edhe shërbime të tjera të kombinuara. Bazuar në raportimet e kryera, pjesa më e madhe e operatorëve janë të vegjël dhe me prani të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane.


Ofrimi i shërbimeve të telefonisë fikse për kryerjen e thirrjeve *voice* gjithnjë e më shumë e ka ulur pjesën e saj në treg, kjo edhe si rezultat i lehtësisë dhe rritjes së vazhdueshme të shërbimeve nga rrjetet celulare. Shërbimi i telefonisë fikse ofrohet kryesisht si pjesë e paketave të shërbimeve të rrjeteve fikse të kombinuara (internet, IPTV, telefoni fikse dhe së fundmi edhe mobile), trendi rënës për këtë tregues evidentohet në të gjitha ekonomitë e botës.

Ofrimi i shërbimeve të internetit nëpërmjet rrjeteve fikse ka ardhur gjithnjë në rritje, si në terma të shtimit të numrit të pajtimtarëve ashtu edhe në terma të rritjes së nivelit të shpejtësisë së ofruar të shërbimit dhe ofrimit të tij nëpërmjet rrjeteve që mundësojnë transmetim të shpejtësive të larta apo shumë të larta.

Telefonia fikse

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2024 ishte rreth 165 mijë, duke shënuar rënie krahasuar me vitin 2023 me rreth 4%. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2024 arriti në 6.9%, që është më e ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), dhe rreth dy herë më e ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje më e ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

Figura 8. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2020-2024



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 55% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe. Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse.

Aksesi broadband nga rrjete fikse


Numri i pajtimtarëve

Në ndryshim nga shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse, ku numri i pajtimtarëve gjatë viteve të fundit kanë pësuar ulje të vazhdueshme, shërbimet e aksesit *broadband* nga rrjete fikse kanë shënuar rritje të vazhdueshme, duke u bërë një mbështetje mjaft e rëndësishme në lehtësimin e komunikimit për përdoruesit fundor.

Në fund të vitit 2024, numri i pajtimtarëve me akses *broadband* nga rrjetet fikse raportohet në mbi 693 mijë, e thënë ndryshe rreth 10% më shumë se viti i kaluar. Norma e penetrimit të aksesit *broadband* nga rrjetet fikse për familje⁷ në fund të vitit 2024 arriti në 92%, duke shënuar rritje me rreth 4% krahasuar me periudhën pararendëse.

⁷ Numri i familjeve dhe popullsisë për vitin 2024 është llogaritur sipas Censurit 2023

Figura 9. Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve (2020-2024)



Burimi: Të dhënat e ardhura nga operatorët dhe INSTAT

Bazuar në të dhënat rajonale në 2024 vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit *broadband* nga rrjetet janë Tirana, Vlora, Shkodra dhe Durrësi, përkatësisht me nga 41.9%, 31.5%, 28.9% dhe 28.5%.


Bazuar në të dhënat e raportuara, për vitin 2024 operatorët me pjesët më të mëdha të tregut *broadband* fiks për sa i përket treguesit të numrit të pajtimtarëve paraqiten si më poshtë vijon:

- One Albania zotëron rreth 22% pjesë tregu;
- Vodafone Albania zotëron rreth 21% pjesë tregu;
- A.S.C zotëron rreth 9% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 6% pjesë tregu;
- Digicom zotëron rreth 5% pjesë tregu;
- Nisatel zotëron rreth 4% pjesë tregu;
- OA (operator të tjerë), me rreth 33% të tregut.

Paketat e integruara (Bundles)

Të dhënat e raportuara tregojnë se shërbimi telefonik për disa vjet tashmë rezulton të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, ndërsa nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve janë shërbimet e aksesit *broadband* dhe sidomos shërbimet e integruara. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa të kombinuara (*bundles*) të shërbimeve internet, telefoni fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2024 arriti në rreth 300 mijë, rreth 2% më shumë se në vitin 2023.

Figura 10. Numri i pajtimtarëve me akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)



Burimi: Të dhënat e ardhura nga operatorët

Nga të dhënat e paraqitura në figurën më sipër, vërehet përdorimi i shërbimeve të integruara (Internet dhe TV) është më i përdoruri ndër tre klasifikimet, i shoqëruar me një rritje prej rreth 3% krahasuar me vitin 2023.


Përgjatë viteve 2023 – 2024 nga dy sipërmarrësit që ofrojnë shërbime në tregjet fikse dhe atë mobile është vënë re promovimi i ofrimit të paketave që përmbajnë shërbime të kombinuara të rrjeteve fikse dhe mobile, me përmbajtje shërbim interneti fiks, njësi komunikimi mobile (internet, minuta, sms), si edhe kanale TV.

Lidhjet internet fiks sipas shpejtësisë

Rritja e vullshme e përdorimit të marrjes së shërbimeve nëpërmjet rrjetit të internetit, ka sjellë gjithnjë e më shumë nevojën për lidhje që mundësojnë transmetim të dhënash broadband më shpejtësi dhe cilësi të lartë. Të dhënat e raportuara nga sipërmarrësit e ofrimit të rrjeteve fikse tregojnë së përveç rritjes së numrit të pajtimtarëve, zhvillim mjaft pozitiv ka pasur edhe në drejtim të zhvendosjes drejt shpejtësive më të larta, duke i ofruar këto shërbime me rrjet teknologjik të aftë që mundësojnë transmetim me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë (kryesisht nëpërmjet fibrave).

Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve që kanë akses në lidhje fikse me shpejtësi më shumë se 100 Mbps është një tregues mjaft pozitiv në funksion të arritjes së objektivave të parashikuara në planin kombëtar të broadband për infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit.


Figura 11. Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë 2020-2024



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët

Nga të dhënat e paraqitura në grafikun sa më sipër, vihet re se në fund të vitit 2024 numri i pajtimtarëve që kanë akses me shpejtësi më shumë se 30 Mbps përbën rreth 83% të totalit të numrit të pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fiks, duke shënuar rritje të konsiderueshme me periudhën pararendëse ku pajtimtarët me shpejtësi më shumë se 30 Mbps përbënin rreth 69% të totalit. Ndërkaq, numri i pajtimtarëve të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse me akses mbi 100 Mbps është 294,081 (rreth 43% e pajtimtarëve) duke shënuar rritje mjaft të konsiderueshme krahasuar me vitin pararendës (rreth 28% të totalit të pajtimtarëve për 2023). Bazuar në të dhënat e raportuara lidhur me teknologjinë e ofrimit të shërbimit broadband fiks vërehet se gjithnjë e më shumë sipërmarrësit që ofrojnë këto shërbime po i zhvendosin linjat e tyre nga lidhjet tradicionale me DSL (dhe kombinimet me të) drejt ofrimit të këtij shërbimi nëpërmjet fibrave optike FTTH/FTTB, të cilat mundësojnë transmetim me shpejtësi dhe cilësi shumë herë më të lartë se DSL.

Figura 12. Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë Shqipëri 2024



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit

Nga të dhënat e pasqyruara në figurë rezulton se teknologjia kryesore mbi të cilën mundësohet aksesimi në rrjete fikse është FTTH/FTTB në rreth 69% e ndjekur nga modem kabllor koaksial me rreth 16%. Ndërsa pjesa tjetër mundësohet nga teknologji mikse, bakër dhe DSL.

Gjatë vitit 2024, trafiku i internetit broadband nga rrjete fikse arriti në rreth 1.78 miliardë GB ose rreth 41% më shumë se viti 2023, çka tregon se pajtimtarët e këtij shërbimi kanë shfrytëzuar këtë rrjet për të aksesuar shërbimet e tyre, financiare, informative, sociale, shëndetësore, etj. Struktura e pajtimtarëve me akses në shërbime interneti fiks po evoluon në mënyrë të pandërprerë drejt shërbimeve broadband me shpejtësi shkarkimi mbi 30 Mbps. Rreth 84% e pajtimtarëve kanë pasur në vitin 2023 akses në lidhje fikse të kësaj shpejtësie.

Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës

Gjatë vitit 2024 ofrimi i kapaciteteve me qira nga linja ndërkombëtare pësoi një rritje me 28% krahasuar me vitin 2023, ndërkohë ofrimi i kapaciteteve me qira nga linja kombëtare pësoi një rritje me 42% e shoqëruar me një rritje të kapacitetit total të dhënës me qira me 36% krahasuar me vitin 2023. Ndërsa ofrimi i infrastrukturës pasive si aksesimi në dark fiber dhe tubacione rezultojnë me rënie në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, respektivisht me 2% dhe 5%. One Albania vazhdon të mbetet ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse.

Tabela 5. Ofrimi me shumicë linja/kapacitete me qira 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023
Ofrim akses në infrastrukturë aktive						
Numri i linjave/lidhjeve të dhëna	1,432	1,018	1,291	1,450	2,047	41%
Kombëtare	1,404	991	1,228	1,382	1,960	42%
Ndërkombëtare	28	27	63	68	87	28%
Kapaciteti total i dhënës me qira (Mbps)	194,143	197,912	299,622	276,960	375,854	36%
Kombëtare	191,713	195,360	291,910	184,060	257,004	40%
Ndërkombëtare	2,430	2,552	7,712	92,900	118,850	28%
Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)						
Dark fiber	2,084	2,634	2,943	2,373	2,323	-2%
Akses në tubacione	76	76	73	111	106	-5%
Aksesin në rrjetin ajror	N/A	367	266	191	212	11%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP

Aksesi dhe ndarja e infrastrukturës në rrjete ofruese ekzistuese të komunikimeve elektronike ka prioritet edhe për faktin se vetë infrastruktura fizike përveç përshtatshmërisë teknike është edhe më e menaxhueshme nga pikëpamja e rregullave dhe ndërhyrjeve të mundshme rregullatore që i shërbejnë qëllimit të zhvillimit të rrjeteve/shërbimeve/produkteve të komunikimeve elektronike. Ndarja dhe përdorimi i infrastrukturës së rrjeteve të utiliteteve të tjera, të cilat kanë disavantazh jo vetëm mungesën e përshtatshmërisë së plotë të tyre, por edhe kanë si barrierë edhe peshën e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet palëve në rastin e përdorimit të tyre, barrierë të cilat nuk janë vetëm ekonomike, por mund të jenë edhe të natyrës kufizuese për kontroll të rrjetit ofrues në

parametrat cilësorë të kërkesës për shërbime/produkte përkatëse, pasi duhet të kuptojmë se utilitetet e tjera kanë prioritet shërbimin e tyre bazik, p.sh. energjinë, ujin etj.

Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike kanë ngritur shqetësimin se jo në të gjitha rastet iu krijohet mundësia për shtrimin e tubacioneve të tyre. Ata janë përballur me vështirësi në marrjen e lejeve për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme apo për të drejtat e përdorimit të tubacioneve nëntokësore që janë në administrim nga Bashkitë, apo entitete të tjera.

3. Rregullimi ex-ante i tregjeve të komunikimeve elektronike

Aspektet e rregullimit të tregjeve të komunikimeve elektronike janë një proces në vetvete me ndikim të fortë në përcaktimin e dimensioneve të konkurrencës, të cilat në thelb të tyre mbartin si synim kryesor uljen e tarifave për shërbimet dhe eliminimin në vijimësi të sjelljeve monopoliste për shërbime të caktuara në komunikimet elektronike. Këto kanë shërbyer si nxitësit kryesorë të investimeve të reja dhe rritjes së shkallës së inovacionit, rrjedhimisht edhe të zhvillimit ekonomik. Procesi i rregullimit mundëson që nëpërmjet analizave të kryera, të orientojë vëmendjen kryesore në identifikimin e kushteve dhe kriterëve që promovojnë zhvillimin e një konkurrence efektive dhe në përputhje me gjetjet përkatëse në analizat e tregjeve që zhvillohen, në referencë me përcaktimet ligjore që synojnë orientimin e situatës së tregut drejt konkurrencës efektive.

Përfundimet e dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme”

Pas procesit të këshillimit publik, KD i AKEP me Vendimin nr. 4, datë 16.02.2024⁸ miratoi dokumentin “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme”.

Objektivi kryesor i analizës së tregut celular është vlerësimi i konkurrueshmërisë dhe marrja e masave të përshtatshme për rregullimin ‘ex-ante’, me synim nxitjen e konkurrencës dhe efikasitetit në këtë treg.

Dokumenti i analizës së tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare u përgatit në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe duke marrë në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian, me synim përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile në Republikën e Shqipërisë, karakteristikat e tregut vendas, si dhe trajton zhvillimet në treg dhe pritshmëritë e AKEP-it për të ardhmen e afërt dhe të mesme, si dhe masat rregulluese përkatëse për sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregjet përkatëse të analizuara.

Dokumenti gjithashtu përmban dhe një rishikim të ecurisë dhe zhvillimeve të tregut me pakicë të telefonisë celulare, efektet e rregullimit në tregun celular si dhe paraqet përfundimet e analizës për operatorët me statusin me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) dhe masat përkatëse rregulluese për tregjet e analizuara, sigurisht pas marrjes në konsideratë të komenteve të paraqitura nga palët në Këshillimin Publik.

⁸ https://akep.al/wp-content/uploads/2024/10/2024_014_16022024.pdf

Nëpërmjet miratimit të kësaj analize tregu, AKEP vendosi përcaktimin e sipërmarrësve One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., si sipërmarrës me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare. AKEP përcaktoi masat rregullore si më poshtë:

- Detyrimi i mosdiskriminimit (neni 39);
- Detyrimi i transparencës (neni 40);
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (neni 42);
- Detyrimi për kontroll të tarifave (neni 45);
- Rishikimin e MTR kombëtare për të dy operatorët sipas tabelës së mëposhtme:

Tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet mobile (lekë)				
Sipërmarrësi	1.12.2019	01.10.2024	01.04.2025	01.10.2025
One Albania	1.11	1.02	0.89	0.75
Vodafone Albania	1.11	1.02	0.89	0.75

Reduktimi i tarifës së terminimit MTR për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT do të bëhet në mënyrë të përshkallëzuar *glide path*, kjo në zbatim të rezultateve të modelit të kostove të miratuara me VKD nr. 10, datë 22.7.2021.

AKEP-i në këtë proces vendimmarrje, duke konsideruar faktorët *pro* dhe *kundër* të referuar në dokumentin e analizës për shërbimin e terminimit të thirrjeve mobile, karakteristikat dhe rrethanat kombëtare, qasjen e Komisionit Evropian për mosrregullimin e thirrjeve ndërkombëtare nga dhe drejt vendeve të treta (jashtë BE-së), ka vendosur lënien në de-rregullim të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, deri në fazën e ardhshme të analizës së tregut ku do të analizohet edhe mundësia për të orientuar tarifat drejt një *'euro tarife'* të njëjtë për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në Shqipëri, njësoj si tarifa e unifikuar e BE-së në tregjet e terminimit.

Gjithashtu, AKEP-i ka vlerësuar se masa rregullore për mosdiskriminim e thirrjeve mobile on-net/off-net, e vendosur në vitin 2014, e ka dhënë efektin e saj në përputhje me qëllimin e vendosur dhe si të tillë ka vendosur që kjo masë të tërhiqet në referencë me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar. Arsyet për tërheqjen e kësaj mase rregullore ndër të tjera argumentohen nga faktorët si:

- struktura e re e tregut me dy operatorë mobile;
- mungesa e stimuljeve të nevojshëm për aplikim të tarifave grabitqare për krijimin e grupeve të mbyllura;
- struktura e thirrjeve e balancuar për një periudhë relativisht të gjatë, etj.

Në këtë dokument analize në një seksion të veçantë është trajtuar dhe mundësia e futjes së operatorëve të rrjetit virtual mobile (MVNO) në tregun e shërbimeve celulare si një faktor i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të konkurrencës në tregun e telefonisë mobile.

Përfundimet e dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të infrastrukturave të rrjeteve fikse dhe aksesit në *Broadband*”

Për kryerjen e procesit të analizës së tregjeve me shumicë të ofrimit të shërbimeve *broadband* nga rrjetet fikse, AKEP, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, kontraktoi marrjen e shërbimit “Konsulencë për vlerësimin për kryerjen e analizave të tregut *broadband*”, proces i cili u realizua nga bashkimi operatorëve Albanian Business Partner sh.p.k., dhe Tera Consultants (kompani franceze).

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 1, datë 10.1.2024, miratoi për Këshillim Publik dokumentin “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në *broadband* fiks”. Ky dokument është përgatitur në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe duke marrë në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për këto tregje, me synim përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun *broadband* internet nga vendndodhje fikse në Republikën e Shqipërisë. Procesi i Këshillimit Publik u krye për një periudhë 60 ditore, 11.1.2024 – 11.3.2024.

Kapacitetet e tregut shqiptar të telefonisë së lëvizshme për hyrjen e operatorëve të rinj

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit, AKEP-i ngriti një Grup Pune për kryerjen e një studimi lidhur me vlerësimin e kuadrit ligjor, rregullator, teknik dhe administrativ në fuqi për krijimin dhe hyrjen në treg të operatorëve virtualë të shërbimeve të lëvizshme (MVNO).

Studimi i përgatitur nga Grupi i Punës paraqet një përshkrim mbi mënyrën e funksionimit të MVNO-ve dhe llojet e tyre, bazës ligjore dhe rregullatore në Shqipëri dhe në disa nga vende të Bashkimit Evropian. Operatorët e rrjeteve celulare (MNO) ofrojnë akses në nivel shumice për operatorët e rrjetit virtual celular (MVNO) mbi baza komerciale, duke ju mundësuar këtyre të fundit të ofrojnë shërbime celulare me pakicë duke u mbështetur në inputet e blerjes së aksesit me shumicë nga operatorët celularë.

Për herë të parë në historinë e akordimit të frekuencave (3400 mhz - 3800 mhz) në vendin tonë, AKEP-i ka vendosur detyrimin e fituesve të tenderit që t’i japin akses MVNO-ve. Përcaktimi, pjesë e autorizimit individual me të cilin pajisen operatorët fitues, është i formuluar si vijon: “Mbi bazën e një kërkesë të arsyeshme, mbajtësi i autorizimit është i detyruar të negociojë përdorimin e përbashkët të kapaciteteve radio me ofrues shërbimesh të përshtatshëm (të tillë si MVNO), në mënyrë jodiskriminuese.”

Nga ana tjetër, Autoriteti i Konkurrencës, në vendimin nr. 869, datë 8.3.2022, ka vendosur detyrimin e shoqërisë mëmë të ONE Albania të mos krijojë pengesa të paligjshme për hyrjen e operatorëve të rinj në treg (MNVO).

Në bazë të kuadrit rregullator ekzistues për komunikimet elektronike në Shqipëri, aktualisht është e mundur që një operator i tretë, MNO apo MVNO, të shprehë interes dhe të përfitojë interkoneksion në rrjetin e dy operatorëve ekzistues.

Deri më sot nuk është paraqitur asnjë kërkesë apo ankim pranë AKEP-it dhe, për aq sa jemi në dijeni, as pranë Autoritetit të Konkurrencës me objekt të kësaj natyre.

4. Dhënia e Autorizimeve individuale për përdorimin e brezave pionierë 3.4 – 3.8 Ghz dhe implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë

4.1 Zhvillimi i tenderit publik ndërkombëtar

Në vitin 2024 AKEP zhvilloi procedurën e tenderit të hapur ndërkombëtar për dhënien në përdorim të frekuencave të brezit 3.4-3.8 GHz. Ky ishte një proces shumë i rëndësishëm për tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri, pasi në përfundim të procesit të tenderimit, u dhanë nga AKEP dy të drejta përdorimi (autorizime individuale) për dy operatorët celularë One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., duke shënuar kështu edhe fillimin e ndërtimit të rrjeteve të gjeneratës së re 5G dhe ofrimin e shërbimeve me anën e tyre. Menjëherë pas marrjes së autorizimit, në datën 26.11.2024, të dy operatorët celularë filluan operimin e teknologjisë 5G me disa stacione (antena). Kështu, Shqipëria bëhet pjesë e shteteve që kanë implementuar rrjetet 5G në Evropë dhe në rajon.

Procesi u zhvillua në disa faza, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, dhe në aktet nënligjore respektive të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Faza e parë nisi pas shprehjes në AKEP të interesit zyrtar nga dy operatorët celularë në fund të muajit dhjetor 2023, për marrjen në përdorim të brezit 3.4-3.8 GHz. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 3, datë 7.2.2024, ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz (3.5 GHz)”. Qëllimi kryesor ishte marrja e mendimit të palëve të interesuara, në mënyrë që:

- Të krijohet një panoramë më e qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre frekuencave nga sipërmarrës të komunikimeve elektronike si edhe nëse do të ketë kërkesa për hyrje të reja në treg;
- Të njihet interesi për marrjen në përdorim të këtyre frekuencave (numri i kërkesave);
- Të njihet çmimi që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për një sasi spektri të caktuar të këtij brezi frekuencash;
- Të mundësohet krijimi i një terreni të përshtatshëm për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave, etj.;
- Të përcaktohet mënyra e vlerësimit dhe kriteret në procedurën e tenderit;
- Të përcaktohen kushtet e mbulimit me shërbime *broadband* dhe kohëzgjatjen e autorizimeve.

Ky dokument mori parasysh:

- Objektivat e politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike;
- Përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave për këtë brez frekuencash;
- Rekomandimet e Bashkimit Evropian dhënë për Shqipërinë në lidhje me përdorimin e këtij brezi për shërbime të lëvizshme *broadband*;
- Kërkesën e tregut dhe faktin që zhvillimi i infrastrukturës *broadband* dhe zhvillimi i rrjeteve të gjeneratës së re 5G, është në interes të zhvillimit të vendit.

Synimet kryesore të AKEP, të shprehura në dokumentin e Këshillimit Publik, ishin:

- Nxitja e një konkurrence sa më efektive në tregun e komunikimeve elektronike;

- Përdorimi sa më i frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre.

Këshilli Drejtues i AKEP, në përfundim të Këshillimit Publik (7.2.2024 – 7.4.2024), me vendim nr. 11, datë 7.5.2024, ka miratuar qëndrimin e AKEP-it për komentet e palëve të interesuara dhe propozimin për Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz, përcaktimet për kufizimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave, procedurën e konkurrimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre.

Në muajin qershor 2024, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar kufizimet dhe procedurën për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 3400-3800 MHz. Në vijim, Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 20, datë 27.8.2024, miratoi Dokumentin e Tenderit publik “Procedurë e hapur” (ndërkombëtare), për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz.

Tenderi publik u zhvillua në datën 17.10.2024. Në tender u paraqitën vetëm dy kompanitë vendase celulare One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a.

Rezultuan fituese ofertat e kompanive, si më poshtë:

- One Albania sh.a., për sasi spektri 120 MHz, me çmim 5,436,000 Euro.
- Vodafone Albania sh.a., për sasi spektri 120 MHz, me çmim 5,436,500 Euro;

Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 29, datë 25.11.2024, ka miratuar pajisjen me Autorizim Individual të sipërmarrësit One Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz (3420-3540 MHz, spektër i paçiftuar)”.

Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 30, datë 25.11.2024, ka miratuar pajisjen me Autorizim Individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz (3680-3800 MHz, spektër i paçiftuar)”.

Në përfundim të këtij procesi, në brezin 3400-3800 MHz, spektri i alokuar dy operatorëve celularë ishte 240 MHz, ndërsa një sasi spektri prej 160 MHz është e lirë dhe e mundshme për t’u alokuar, nëse do të ketë shprehje interesi nga operatorë në AKEP.

Vlen të theksohet se dhënia në përdorim e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, është në përputhje edhe me kërkesat e Komisionit Evropian në kuadër të përafrimit të legjislacionit të Shqipërisë me BE, ku disa Vendime dhe Direktiva të Komisionit Evropian janë kërkuar të implementohen sa më shpejt.

Këto Vendime dhe Direktiva janë identifikuar në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe në takimet bilaterale gjatë procesit të integritimit.

4.2 Nevoja për investimet e sektorit për kalimin në teknologjinë 5G

Autorizimet individuale të lëshuara nga AKEP për dy operatorët celularë për përdorimin e frekuencave 3400-3800 MHz, shoqërohen me disa kushte, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me investime në teknologji. Këto frekuenca janë të caktuara për përdorimin e teknologjive të reja të gjeneratës së pestë celulare (5G).

Implementimi i teknologjive të reja shoqërohet me investime për ndërtimin e stacioneve (antenave) të reja, investime në pajisjet e rrjetit qendror (core) të operatorit celular, investime në

rrjet fiks mbështetës të fibrave optike, investime në punimet civile të nevojshme, investime në mirëmbajtjen e këtij rrjeti, etj.

Kushtet kryesore të vendosura në autorizimet individuale të operatorëve për brezin 3400-3800 MHz, jepen më poshtë:

Kushtet e mbulimit:

Përdorimi i frekuencave 3400-3800 MHz (5G) të fillojë brenda 6 muajve nga data e dhënies së autorizimit individual nga AKEP.

Mbulimi me shërbim në shkallë popullore:

% e Popullsisë	Afati (viti)
<u>55% e popullsisë</u>	<u>2027</u>
<u>85% e popullsisë</u>	<u>2030</u>

Mbulimi me shërbime 5G në brezin e autorizuar 3400-3800 MHz në të gjitha zonat e mëposhtme, deri në fund të vitit 2025:

- Porti Durrës, Vlorë, Shëngjin, Sarandë, Porto Romano;
- Tirana International Airport, Kukës Airport, Vlora Airport;
- Zona industriale Tiranë – Durrës;
- Qendrat Spitalore të Tiranës.

Mbulim me shërbim 5G në brezin e autorizuar 3400-3800 MHz, në të gjitha qytetet e Shqipërisë deri në fund të vitit 2028.

Sipërmarrësi është i detyruar që, sipas rastit dhe bazuar në raportet e matjeve, të vendosë në parametrat e kërkuara të cilësisë së mbulimit me shërbim sipas përcaktimeve në aktin rregullator përkatës të AKEP-it, për zonat e rëndësishme të veçantë ku përfshihen:

- zonat turistike;
- parqet kombëtare;
- rrugët, autostradat e tunelet;
- zona të përfshira në projekte zhvillimore të ndryshme.

Sipërmarrësi duhet të zbatojë masa teknike dhe organizative, për të realizuar rrjete të sigurta e të besueshme, në të gjithë komponentët e tyre, bazuar në kërkesa e standarde në të cilat është angazhuar Republika e Shqipërisë.

Mbi bazën e një kërkesë të arsyeshme, mbajtësi i autorizimit është i detyruar të negociojë përdorimin e përbashkët të kapaciteteve radio me ofrues shërbimesh të përshtatshëm (të tillë si MVNO), në mënyrë jodiskriminuese.

Antenat e para që përdorin frekuencat 3400-3800 MHz (5G) u vendosën në funksionim nga operatorët celularë menjëherë pas marrjes së autorizimit individual, fillimisht në bashkinë e Tiranës. Aktualisht operatorët po punojnë për shtimin e antenave të reja dhe rritjen e mbulimit me rrjet dhe shërbime 5G.

Duke pasur parasysh problematikat e hasura me sulmet kibernetike në rrjete private apo shtetërore, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shumë shtete të zhvilluara, u gjykua e arsyeshme që në autorizimin individual të përdorimit të frekuencave, të vendosen kushte për operatorët celularë, për masa teknike dhe organizative, për të realizuar rrjete të sigurtat e të besueshme, në të gjithë komponentët e tyre, bazuar në kërkesa e standarde në të cilat është angazhuar Republika e Shqipërisë. Ky ishte një kusht risi, i paaplikuar më parë në autorizimet individuale të përdorimit të frekuencave.

AKEP-i ka miratuar rregullore specifike për masat teknike dhe organizative që çdo sipërmarrës duhet t'i aplikojë në rrjetet e tyre për t'i pasur ato të sigurtat nga sulmet kibernetike, funksionale dhe në operim gjatë gjithë kohës. Kjo rregullore do të pësojë ndryshimet e nevojshme gjatë vitit 2025, për t'a përshtatur me rregulloret e vendeve të zhvilluara, sipas udhëzimeve të BEREC (Trupa e Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike) dhe në frymën e Direktivës EU 2022/2555, e njohur si NIS2, "Rregullat e reja për sigurinë kibernetike të rrjeteve dhe sistemeve të informacionit". NIS2 vjen si një përmirësim i Direktivës së mëparshme NIS1, ku janë shtuar rregulla të reja specifike për shumë lloje rrjetesh teknike. Natyrisht, AKEP do t'i përmbahet parimit të asnjësisë teknologjike si detyrim ligjor nga ligji nr. 54/2024, por do të bashkëpunojë me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), për të evidentuar çështjet teknike që ju takojnë rrjeteve të operatorëve (mobile dhe fiks) që mbulohen nga AKEP dhe ligji nr. 54/2024.

Aktualisht operatorët e rrjeteve aplikojnë masa sigurie në përputhje me rregulloren përkatëse të AKEP-it, por kjo rregullore do të përmirësohet dhe përditësohet nga AKEP brenda vitit 2025.

Kushti tjetër risi ishte që, mbajtësi i autorizimit është i detyruar të negociojë përdorimin e përbashkët të kapaciteteve radio me ofrues shërbimesh të përshtatshëm (të tillë si MVNO), në mënyrë jodiskriminuese. Ky kusht u vendos për të detyruar operatorët celularë që frekuencat e autorizimit individual t'i bashkëpërdorin me operatorë pa rrjet (MVNO), nëse do të ketë të tillë, por duke pasur parasysh edhe një vendim të Autoritetit të Konkurrencës, i cili lejoi bashkimin e dy operatorëve celularë, ku një nga kushtet ishte edhe detyrimi i lejimit të operatorëve pa rrjet, të funksionojë në rrjetin e operatorit celular me rrjet të bashkuar.

Në kushtet kur tregu celular në Shqipëri është vetëm me dy operatorë, vendosja e këtij kushti krijon më shumë mundësi për një ose disa operatorë të rinj celularë në treg, të cilët nuk do të ndërtojnë rrjetin e tyre, por mund të përdorin frekuencat e rrjeteve të operatorëve celularë aktualë, për të ofruar shërbimet e tyre celulare, natyrisht, edhe nën frymën e rregullimeve të tjera që mund të jenë të nevojshme nga AKEP.

5. Nevoja e përdorimit të brezit 700 Mhz në implementimin e teknologjisë 5G

Brezat kryesorë të frekuencave 5G janë brezi 700 MHz (694-790 MHz), brezi 3400-3800 MHz dhe brezi 26 GHz (24.25-27.5 GHz).

Brezi 700 MHz është nën administrimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe do të kalojë nën administrimin e AKEP-it menjëherë pas lirimit nga AMA. Ky brez frekuencash aktualisht vijon të përdoret nga disa media audiovizive.

Brezi 700 MHz mbetet prioritet dhe me vëmendje të lartë për AKEP-in. Menjëherë pas lirimit nga AMA, AKEP do të fillojë procedurat për dhënien në përdorim të këtij brezi frekuencash për operatorët celularë.

Brezi 700 MHz (694-790 MHz), teknikisht është brezi më i mirë i frekuencave për ndërtimin e rrjeteve 5G, veçanërisht për shkak se frekuencat e këtij brezi realizojnë mbulim shumë të mirë me një numër të caktuar stacionesh (antenash).

Lirimi sa më shpejt i këtij brezi frekuencash do të krijojë mundësinë e mbulimit më të shpejtë të gjithë territorit të vendit me rrjet 5G, por do të shmangen edhe problematikat e interferencave që transmetuesit e mediave audiovizive iu shkaktojnë operatorëve 5G në zonat kufitare me shtetet fqinje, madje edhe me vende të BE-së si me Greqinë, Italinë dhe Kroacinë.

Për brezin 26 GHz, operatorët celularë janë shprehur që nuk kanë interes për shkak të mbulimit të vogël që sigurojnë antenat e këtij brezi frekuencash dhe numrit të madh të antenave që nevojiten për të siguruar mbulimin e nevojshëm.

Brezi 3400-3800 MHz teknikisht është brezi i preferuar për rrjete në zona urbane me dendësi të konsiderueshme popullore, por nuk është shumë i preferuar për zonat rurale apo malore, pasi karakteristikat teknike të valëve të këtij brezi janë të tilla që nuk ofrojnë mbulim shumë të madh territori.

Brezi 3400-3800 MHz filloi të përdorej nga operatorët celularë në datën 26.11.2024 dhe gjatë vitit 2025 e në vijim, operatorët celularë do të zgjerojnë rrjetin 5G me këto frekuenca, sipas kushteve të autorizimeve individuale të lëshuara nga AKEP.

6. Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike

Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918/2008 objektivi kryesor i sigurimit të Shërbimit Universal në sektorin e komunikimeve elektronike është që përdoruesit në të gjithë territorin e RSH, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, të kenë mundësinë e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve bazë të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike (për kryerjen dhe marrjen e thirrjeve telefonike dhe akses funksional, me shpejtësi të kënaqshme në internet), dhe me çmim të përballueshëm. Realizimi i këtij objektivi duhet të arrihet duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë e realizimit teknologjik, sipas kushteve kombëtare.

Bazuar në të dhënat për mbulimin territorial dhe të popullsisë si dhe përdorimin e rrjeteve fikse dhe celulare në Shqipëri, rrjetet celulare kanë shërbyer si teknologjia mbizotëruese e përdorur në sigurimin e shërbimit universal për akses në shërbimet bazë të rrjeteve dhe shërbimeve të

komunikimeve elektronike publike, pavarësisht vendndodhjes gjeografike dhe me çmime të përballueshme.

Mbulimi me rrjet celular GSM/3G që mundëson akses në rrjet publik të komunikimeve elektronike, përfshirë akses dhe përdorim interneti funksional, në fund të vitit 2024 rezultoi në pothuajse 99% të popullsisë dhe 96% të territorit. Në vitet e fundit ka pasur rritje të ndjeshme dhe të mbulimit me rrjetet 4G që mundëson akses *broadband* në internet nga rrjetet celulare, dhe sipas raportimeve të operatorëve, në fund të vitit 2023 mbulimi me rrjet 4G arriti 100% të popullsisë dhe 97% të territorit.

Nivelet shumë të larta të mbulimit të popullsisë dhe territorit të RSH nga rrjetet celulare, mundësojnë akses në rrjetet publike të komunikimeve elektronike për të gjithë banorët, pavarësisht vendndodhjes gjeografike. Përveç mundësisë së aksesit në rrjetet celulare, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, edhe përdorimi i shërbimeve të ofruara nga rrjetet celulare është në nivel të lartë. Në fund të vitit 2024 numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare ishte 2,5 milionë, ndërsa numri i përdoruesve aktivë të aksesit *broadband* celular ishte 2,1 milionë, që përbëjnë respektivisht 107% dhe 87% të popullsisë së Shqipërisë.

Zhvillimet teknologjike, konkurrenca në treg dhe ndryshimet në kërkesën konsumatore (orientimi drejt përdorimit të aksesit *broadband* në internet) kanë bërë që në vitet e fundit të ketë një rritje të konsiderueshme të mbulimit dhe përdorimit/numrit të pajtimtarëve të aksesit *broadband* nga rrjetet fikse në Shqipëri. Ndryshimet në kërkesën për shërbimet e telefonisë dhe aksesit *broadband* në rrjetet fikse kanë rezultuar në trende të kundërta në përdorimin e këtyre shërbimeve në vitet e fundit: rënie e qëndrueshme e përdorimit të telefonisë fikse dhe rritje vjetore dyshifrore e numrit të pajtimtarëve të aksesit *broadband* fiks. Këto kanë çuar në një rritje të konsiderueshme të përqindjes së familjeve me akses *broadband* nga rrjete fikse nga 243 mijë në vitin 2015, në 693 mijë në vitin 2024, duke arritur në 92% të totalit të numrit të familjeve.

Ndërsa të dhënat e mësipërme i referohen informacionit të deklaruar në AKEP nga sipërmarrësit (ana e ofertës), shkalla e lartë e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të aksesit në internet konfirmohet dhe nga të dhënat në anën e kërkesës sipas vrojtimeve/anketave të INSTAT për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nga Familjet dhe Ndërmarrjet.

Tregues të përdorimit të aksesit në internet nga Familjet dhe Individët, 2024

Përdorues aktivë të internetit: 86.2% e popullsisë (grup-mosha 16-74 vjeç) përdorin internetin, nga të cilët 96.4% e përdorin çdo ditë;

Akses rrjet fiks v mobile: 97.1% e familjeve shqiptare kanë akses në internet, prej të cilave 91.5% kanë akses në internet me rrjet fiks *broadband* (fiber optike, kabllor, ADSL, etj.), dhe 99.3% kanë akses në internet nëpërmjet lidhjes “mobile *broadband*” (3G/4G, tablet, etj.).

Pajisjet fundore të përdorur për aksesin në internet:

99.9% e individëve përdorin aparat celularë/telefona inteligjent (smart);

29.2% kompjuter/desktop;

28.5% laptop;

19.4 % tablet.

Përdorimi:

98,9% kryejnë thirrje/video thirrje përmes përdorimit të aplikacioneve OTT (p.sh., WhatsApp,

etj.);

42.4% kanë kryer blerje *online*;

99.4% kanë llogari në e-albania; 54.8% përdorim për marrje informacioni dhe 64% për shkarkim/printim të formularëve.

Burimi: Publikim i INSTAT, datë 11.12.2024, bazuar në rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në NjEF dhe Individë.

Tregues të përdorimit të aksesit në internet nga Ndërmarrjet (me 10 ose më shumë të punësuar), 2024

Përdorimi i internetit: 99.3% e ndërmarrjeve kanë përdorur kompjuter me akses në internet;

99.32% e ndërmarrjeve të vogla (10-49 të punësuar)

99.22% e ndërmarrjeve të mesme (50-249 të punësuar)

100% e ndërmarrjeve të mëdha

Shpejtësia e aksesit në internet:

12% me shpejtësi < 12 Mbps;

88% me shpejtësi 30 Mbps ose më të lartë;

47% me shpejtësi 30 deri < 100 Mbps;

38.1% me shpejtësi 100 deri < 1 Gbps;

2.8% me shpejtësi 1 Gbps ose më të lartë;

57.7% e ndërmarrjeve kanë faqe interneti;

24.5% e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime *online* që përbën 9.5% të shitjeve neto totale të ndërmarrjeve.

Burimi: Publikim i INSTAT, datë 19.9.2024, bazuar në rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje

Të dhënat e mësipërme në lidhje me shkallën e mbulimit të territorit dhe popullsisë si dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, dëshmojnë se rrjetet celulare dhe fikse mundësojnë akses në rrjet publik të komunikimeve elektronike dhe akses *broadband* në internet për pothuajse të gjitha familjet dhe popullsinë e Shqipërisë, pra, pavarësisht vendndodhjes gjeografike të përdoruesit.


Përballueshmëria e tarifave

Bazuar në të dhënat më të fundit të publikuara nga ITU⁹, AKEP në figurën e mëposhtme ka paraqitur ecurinë e shpenzimeve për pesë shportat TIK të ITU në raport me GNI për frymë për Shqipërinë për periudhën 2008-2023.

Në këtë grafik është përfshirë dhe objektivi i përballueshmërisë Komisionit Broadband të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm të Internetit¹⁰ që në vitin 2025 shpenzimet për akses *broadband* të mos jenë më shumë se 2% e të ardhurave bruto për frymë.

⁹ <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Dashboards/Pages/IPB.aspx>

Figura 13. Ecuria e përballueshmërisë së shpenzimeve për shportat TIK të ITU: Shqipëria 2008-2023



Burimi: AKEP sipas të dhënave të publikuara nga ITU

Nga të dhënat rezulton se shpenzimet për shumicën e shportave të ITU kanë qenë poshtë nivelit 2% të të ardhurave bruto në Shqipëri prej vitit 2015 dhe vetëm në disa raste mbi këtë kufi. Gjithashtu pavarësisht rritjes në vitin 2023, shpenzimet për të pesë shportat TIK të ITU janë brenda kufirit 2% të GNI/pc, me 2 shporta 0.4 pikë përqindje poshtë kufirit dhe 3 shporta në kufirin 2%.


Për shkak të kompleksitetit të krahasimit të tarifave të shërbimeve celulare dhe profileve të ndryshme të përdorimit të shërbimeve celulare në vende të ndryshme, një tregues i rëndësishëm që përdoret për të vlerësuar shpenzimet e përdoruesve celular është ARRP (Average Retail Revenue per User)¹¹ apo ardhurat mujore mesatare për përdorues të operatorëve nga shërbimet me pakicë celulare. Ky tregues mat njëkohësisht shpenzimet që një përdorues celular kryen mesatarisht për të përdorur shërbimet celulare gjatë një muaji (përdorimi mesatar mujor i thirrjeve, SMS dhe internetit/ minuta, SMS, GB etj).

Figura e mëposhtme paraqet ARRP në vendet e BE/EEA dhe Ballkanit Perëndimor (BP) në tremujorin e tretë 2024, duke iu referuar të dhënave të raportit më të fundit të BEREC për roamingun ndërkombëtar në vendet e BE/EEA dhe për 6 vendet e BP.

¹⁰ UN Broadband Commission for Sustainable Development në vitin 2018 ka përcaktuar disa objektiva me qëllim universalizimin e aksesit broadband, përfshirë arrijten deri në vitin 2025 të nivelit të synuar prej jo më shumë se 2% të shpenzimeve për aksesin në shërbimin bazë broadband në raport me të ardhurat kombëtare bruto për frymë (GNI per capita).

¹¹ Të ardhurat me pakicë përfshijnë vetëm të ardhurat nga shërbimet e ofruara brenda vendit, pra nuk përfshijnë të ardhurat nga roamingu ndërkombëtar.

Figura 14. Të ardhurat me pakicë mesatare mujore për përdorues (ARRPU), Q3 2024




Nga të dhënat e figurës vërehet se ARRPU në Shqipëri prej 7.14 Euro/muaj është në nivelet më të ulëta të vendeve evropiane dhe më e ulët se mesatarja 11.09 Euro/muaj në 28 vendet e EEA.

Ndërkohë bazuar dhe në përfundimet e dokumentit të analizës së tregut Broadband (BB) fiks të kryer nga AKEP (me konsulencë ndërkombëtare) në vitin 2024, është evidentuar se tarifat me pakicë të aksesit BB fiks standalone (vetëm internet) për shpejtësi download 12 Mbps deri më pak se 30 Mbps si dhe për paketa të integruara (internet BB fiks plus shërbime telefoni dhe/ose TV) janë më të ulëta se tarifat mesatare në BE, të matura në Euro PPP (Kurs këmbimi sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse).

Bazuar në përfundimet e dy analizave të fundit të tregut BB fiks të kryera nga AKEP në vitin 2016 dhe në vitin 2024, rezulton se tarifa mujore për shërbimin e aksesit BB fiks (standalone) për shpejtësi bazë 12 Mbps deri në më pak se 30 Mbps të ofruar nga operatori kryesor fiks ishte:

- 77 Euro PPP (4799 Lekë/34 Euro) apo 3 herë më e lartë se mesatarja BE27 prej 23 Euro PPP (Sipas analizës së tregut BB në vitin 2016) ;
- 20 Euro PPP (1200 Lekë/12 Euro) apo 10% më e ulët se mesatarja BE 27 (Sipas Analizës së tregut BB në vitin 2024).

Figura 14. Ndryshimi i tarifës së aksesit standalone BB fiks me shpejtësi bazë (12 deri më pak se 30 Mbps)



Burimi : AKEP, Analiza e tregut BB 2016

Burimi : AKEP, Analiza e tregut BB 2024

Kuadri rregullator i Bashkimit Evropian për Shërbimin Universal (SHU)

Ligji nr. 9918/2008, në fuqi deri më 20.12.2024, ishte i bazuar në Direktivat e vitit 2002 të BE, sipas të cilave fokusi i shërbimit universal në komunikimet elektronike ishte sigurimi i aksesit/lidhjes në rrjetin publik telefonik/komunikime elektronike e cila, duhet t'i krijonte mundësi përdoruesit fundor për përdorimin e shërbimit publik telefonik për kryerje dhe marrje të thirrjeve telefonike, komunikim me faks dhe komunikimin e të dhënave me një shpejtësi të kënaqshme për të mundësuar akses funksional në internet dhe me çmim të përballueshëm pavarësisht vendndodhjes gjeografike. Pra sipas përcaktimeve të Direktivave të vitit 2002 të BE-së, të reflektuara dhe në ligjin nr. 9918/2008, aksesin në internet si pjesë e SHU nuk përfshinte detyrim për sigurim të shërbimit të aksesit *broadband* në internet, por vetëm mundësimin e aksesit funksional në internet si pjesë e lidhjes në rrjet publik të komunikimeve elektronike, që e ofronte shërbimin publik telefonik si shërbimin kryesor/bazë për përdoruesit fundorë.

Direktivat e vitit 2002 të BE-së u shfuqizuan më 21.12.2020, duke u zëvendësuar me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike (në vijim EECC)¹², duke sjellë një sërë ndryshimesh të rëndësishme në kuadrin rregullator të BE-së për komunikimet elektronike, përfshirë për ofrimin e shërbimit universal si një rrjet sigurie për të garantuar që të paktën një set minimum shërbimesh të jetë i disponueshëm për të gjithë përdoruesit fundorë.

EECC ka bërë pjesë të objektit të shërbimit universal edhe shërbimin e aksesit *broadband* në internet nga vendndodhje fikse me shpejtësi të përshtatshme, që përbën një ndryshim të rëndësishëm nga koncepti i aksesit funksional të internetit me shpejtësi të kënaqshme, pjesë e kuadrit të mëparshëm rregullator të BE-së (Direktivat e vitit 2002, të ndryshuara në vitin 2009). Përfshirja e aksesit *broadband* në internet dhe ndryshimet e tjera në objektin e shërbimit universal janë bazuar në nevojën për të reflektuar përparimet në teknologji, zhvillimet e tregut dhe ndryshimet në kërkesën e përdoruesve të ndodhura në vendet e BE-së (në vitin 2015 rrjetet fikse *broadband* mbulonin 97% të familjeve dhe 72% e familjeve të BE-së ishin pajtimtarë të

¹² Direktiva (EU) 2018/1972 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2018, "Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike".

shërbimit të aksesit *broadband* në internet nga rrjete fikse, ndërsa shërbimet e bazuara në rrjetet pa tela kanë mbulim dhe përdorim akoma më të madh).

EECC përcakton se shpejtësia adekuate e aksesit *broadband* në internet si pjesë e Shërbimit Universal (në vijim, SHU) duhet të përcaktohet nga çdo vend anëtar në mënyrë që të sigurohet niveli i shpejtësisë së nevojshme për pjesëmarrje sociale dhe ekonomike në shoqëri, sipas kushteve kombëtare dhe shpejtësisë minimale që përdoret nga shumica e konsumatorëve, duke marrë në konsideratë dhe raportet e BEREC¹³ për praktikatat më të mira për këtë qëllim.

Aksesi BB në internet si pjesë e shërbimit universal

Situata në lidhje me përfshirjen e aksesit BB në internet në objektin e SHU ka ndryshime të konsiderueshme në krahasim me raportin e mëparshëm të vitit 2020 të BEREC (BoR (20) 99), pasi shumica e vendeve anëtare të BE/EEA në vitin 2023 kanë transpozuar tashmë (në vitin 2023) kodin e komunikimeve elektronike të BE-së (EECC) në legjislacionin kombëtar dhe kanë përcaktuar parametrat për shërbimin adekuat të aksesit *broadband* në internet në kuadër të SHU-së. Deri në mesin e vitit 2023, 19 vende e kanë përkufizuar tashmë shërbimin adekuat të internetit për SHU, 1 vend nuk e ka përcaktuar, ndërsa 9 vende nuk e kanë përcaktuar ende (por janë në proces Këshillimi Publik ose kanë parashikuar ta kryejnë atë, ose nuk e kanë transpozuar ende EECC në legjislacionin e tyre vendas).

Rritja e madhe (nga 9 në 19) e numrit të vendeve që kanë përfshirë tashmë aksesin BB në fushën e SHU ka ndodhur në periudhën 2021-2022 që përkon me transpozimin e EECC në legjislacionin kombëtar të këtyre vendeve.

Shpejtësia minimale e aksesit *broadband* si pjesë e SHU

Shumica e vendeve që kanë përfshirë aksesin BB në SHU (17 nga 19 vende) kanë përcaktuar dhe parametra/kërkesa për shpejtësinë minimale të shkarkimit (*download*):

- ✓ 9 vende kanë përcaktuar 10 Mbps;
- ✓ 3 vende kanë përcaktuar shpejtësi më të ulët (6-8 Mbps), dhe
- ✓ 5 vende kanë përcaktuar (2 vende) apo janë në proces (3 vende) për të përcaktuar shpejtësi më të lartë (30 Mbps).

Shumica e vendeve kanë përcaktuar dhe shpejtësi minimale të ngarkimit (*upload*) të aksesit *broadband* në internet për SHU në nivelin 1 Mbps, ndërkohë që disa vende nuk kanë përcaktuar shpejtësi minimale ngarkimi, dhe vetëm në 6 vende kjo shpejtësi është caktuar në nivel më të lartë se 1 Mbps (1.5 - 2 Mbps).

¹³Raport i BEREC mbi praktikatat më të mira të vendeve anëtare për të mbështetur përkufizimin e shërbimit adekuat të aksesit *broadband* në internet”, të publikuar më 7 mars 2024 (BoR (24) 40)

Figura 15. Parametrat e shërbimit të përshtatshëm të aksesit në Internet (SHU): shpejtësitë minimale të ngarkimit dhe shkarkimit në vendet anëtare të BE/BEREC




Figure 4. Adequate broadband IAS parameters – minimum download and upload speed

Burimi: BEREC BoR (24) 40. “BEREC Report on Member States’ best practices to support the defining of adequate broadband internet access service”, 7 March, 2024.

Ligji i ri nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008. Ligji nr. 54/2024, në përputhje me përcaktimet e EECC ka bërë pjesë të objektit të shërbimit universal edhe shërbimin e aksesit *broadband* në internet nga vendndodhje fikse, që përbën një ndryshim të rëndësishëm nga koncepti i aksesit funksional të internetit me shpejtësi të kënaqshme, pjesë e kuadrit të mëparshëm rregullator të BE-së dhe ligjit nr. 9918/2008.

Në kuadër të ndryshimeve ligjore për shërbimin universal dhe masave për implementimin e ligjit të ri të komunikimeve elektronike nr. 54/2024, AKEP parashikon që në vitin 2025 të kryejë një vlerësim të detajuar të shërbimit universal dhe aspekteve më të rëndësishme të tij si:

- përkufizimi i parametrave (shpejtësisë minimale) të aksesit BB si pjesë e SHU (sipas përcaktimeve të nenit 110 të ligjit nr. 54/2024);
- vlerësimi i përballueshmërisë së çmimeve të SHU, sidomos për konsumatorët me të ardhura të ulëta ose nevoja të veçanta sociale (sipas nenit 112 të ligjit nr. 54/2024).

Në këtë vlerësim, AKEP do të marrë në konsideratë dhe praktikatat më të mira për SHU sipas raporteve të BEREC si dhe marrjen e masave për adresimin e problematikave të evidentuara në lidhje me përballueshmërinë e tarifave.

III. TREGU POSTAR

Sektori i shërbimeve postare rregullohet me ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij dhe referuar në aktet rregullatore të UPU, udhëzimet dhe objektivat e përcaktuara në dokumentet e politikave postare të hartuara dhe miratuara nga qeveria.

Tregu i shërbimeve postare ka ndryshuar ndjeshëm vitet e fundit, duke u karakterizuar nga disa zhvillime, si: zhvendosja nga komunikimi tradicional i bazuar në letër drejt komunikimeve me mjete elektronike, gjë e cila ka çuar në rënie të konsiderueshme të vëllimeve të objekteve postare. Shërbimet postare në Shqipëri përgjatë vitit 2024 u ofruan nga 24 subjekte të pajisur me Autorizim të Përgjithshëm.

1. Ecuria e tregut postar

Sektori postar është sektor i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare dhe përbën një nga sektorët me numrin më të madh të punonjësve në vend me rreth 3.297 të punësuar . Të punësuarit kanë pasur rritje me 4.3% në krahasim me vitin e kaluar.

Numri total i objekteve postare të pranura gjatë vitit 2024 nga Posta Shqiptare sh.a., dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 25.4 milionë, me një rritje me 10% krahasuar me vitin 2023.

Në vitin 2024 “Shërbimi Jo Universal Postar” ka pasur rritje me 27%, i ndikuar kryesisht nga shërbimi “Postë brenda vendit” me 29%, ndërsa shërbimi “Postë Ndërkombëtare” ka shënuar rënie me 71% krahasuar me vitin 2023. Edhe Shërbimi Ekspres ka pasur rritje me 31% krahasuar me vitin 2023, ku ndikimin më të madh në këtë rritje e ka pasur zëri “Ekspres Ndërkombëtar” me një rritje të konsiderueshme prej 82% krahasuar me vitin 2023 dhe zëri “Ekspres brenda vendit” me 24% krahasuar me vitin 2023.

Tabela 6. Të dhëna përmbledhëse të shërbimeve postare (2020-2024)


Shërbime postare të ofruara		Objekte postare 2020	Objekte postare 2021	Objekte postare 2022	Objekte postare 2023	Objekte postare 2024	Ndryshim 2024/2023
Posta Shqiptare sh.a.,							
1	Shërbim Universal Postar						
1.1	<i>Postë brenda vendit</i>	17,487,538	20,219,877	21,229,943	17,652,148	18,321,381	4%
1.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	903,336	662,949	729,430	743,008	977,951	32%
1.3	Totali 1.1+1.2	18,390,874	20,882,826	21,959,373	18,395,156	19,299,332	5%
2	Shërbim joniversal postar						
2.1	<i>Postë brenda vendit</i>	873,512	301,052	406,700	402,014	366,523	-9%
2.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	2,344	2,762	3,149	3,320	623	-81%
2.3	Totali 2.1+2.2	875,856	303,814	409,849	405,334	367,146	-9%
3	Shërbim ekspres						
3.1	<i>Ekspres brenda vendit</i>	486,531	669,874	541,210	491,782	473,872	-4%
3.2	<i>Ekspres ndërkombëtar</i>	12,874	18,902	15,177	12,400	15,562	26%
3.3	Totali 3.1+3.2	499,405	688,776	556,387	504,182	489,434	-3%

Ofruesit e shërbimeve postare							
4	Shërbim JoUniversal Postar						
4.1	Postë brenda vendit	1,914,761	1,757,313	956,465	457,644	746,641	63%
4.2	Postë ndërkombëtare	45,036	77,419	45,072	21,847	6,441	-71%
4.3	Totali 4.1+4.2	1,959,797	1,834,732	1,001,537	479,491	753,082	57%
5	Shërbim ekspres						
5.1	Ekspres brenda vendit	2,796,387	3,240,553	2,867,337	2,883,871	3,702,691	28%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	272,860	268,528	267,416	442,779	814,684	84%
5.3	Totali 5.1+5.2	3,069,247	3,509,081	3,134,753	3,326,650	4,517,375	36%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	24,795,179	27,219,229	27,061,899	23,110,813	25,426,369	10%

Të ardhurat dhe investimet e tregut postar

Bazuar në raportimet e kryera nga ofruesit e shërbimeve postare që kanë ushtruar aktivitet përgjatë vitit 2024, rezulton se këta sipërmarrës kanë gjeneruar rreth 2.7 miliardë lekë të ardhura nga këto shërbime, e cila përbën një rritje me rreth 9% krahasuar me periudhën pararendëse.

Figura 16. Ecuria e të ardhurave dhe investimeve të ofruesve të shërbimeve postare 2020 - 2024



sipërmarrësi me pjesën më të madhe të të ardhurave në fushën e ofrimit të shërbimeve postare. Duhet theksuar se Posta Shqiptare është përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP edhe si ofrues i Shërbimit Universal Postar, shërbim nga i cili gjeneron edhe pjesën më të madhe të të ardhurave të saj.

Përgjatë vitit 2024, sipërmarrësit e ofrimeve postare kanë investuar rreth 300 milionë lekë në përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit të shërbimeve postare, e cila përbën një rritje me rreth 6% krahasuar me vitin 2023. Pjesa më e madhe e investimeve është kryer nga sipërmarrësit Posta Shqiptare me rreth 46% dhe United Transport me rreth 44%.

2. Transparenca për tarifën e pakove postare ndërkufitare

Në vijim të bashkëpunimit me vendet e CEFTA për përafrimin e legjislacionit të BE-së në fushën e shërbimit të dorëzimit të pakove postare ndërkufitare, Shqipëria ka qenë vendi i parë që ka realizuar harmonizim të pjesshëm të rregullores së BE-së në këtë fushë nëpërmjet miratimit të Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE) nr. 5, datë 25.6.2021, “Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare”, mbi bazën e të cilit AKEP, në shkurt 2023, ka miratuar ndryshimet përkatëse në rregulloren për mbledhjen e të dhënave statistikore postare. Këto ndryshime synojnë rritjen e transparencës mbi tarifën që aplikojnë ofruesit e shërbimeve postare ndërkufitare duke lehtësuar proceset dhe kostot e tregtisë elektronike midis vendeve të rajonit të CEFTA dhe BE-së.

Në kuadër të këtij procesi, AKEP është angazhuar në mbledhjen e informacionit nga ofruesit e shërbimeve postare ndërkufitare, si edhe publikimin në faqen e internetit, të raporteve me përmbledhjen e tarifave të ofruesve të këtyre shërbimeve.

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MIE nr. 5/2021, në funksion të transparencës dhe informacionit për konsumatorët/përdoruesit e shërbimit postar, AKEP në muajt janar - shkurt 2025 ka mbledhur dhe publikuar raportin e katërt radhazi për tarifën e shpërndarjes së pakove postare ndërkufitare të cilat gjenden në linkun <https://akep.al/publikime/tarifa/>.

Gjithashtu, në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të MIE nr. 5/2021, AKEP ka përgatitur dhe përcjellë në MIE raportin e vlerësimit për tarifën e pakove postare ndërkufitare për vitin 2024.

3. Statusi i Shërbimit Universal Postar

AKEP-i, si organ rregullator në fushën e shërbimeve postare, ndër të tjera, ka detyrimin për të përcaktuar ofruesin e Shërbimit Universal Postar në përputhje me ligjin nr. 46/2015 si dhe aktet nënligjore për ofrimin Shërbimit Universal Postar. Bazuar në këto përcaktime, AKEP me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 13, datë 30.6.2020, ka miratuar dhënien e autorizimit individual shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., për ofrimin e Shërbimit Universal Postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga data 7 korrik 2020.

Posta Shqiptare sh.a., si ofruesi i Shërbimit Universal Postar ka një sërë detyrimesh për të garantuar disponueshmërinë e këtij shërbimi në të gjithë territorin e RSH me çmime të përballueshme sipas treguesve të mbulimit dhe cilësisë, të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Për të garantuar mbulimin e territorit dhe popullsisë me Shërbim Universal sipas kërkesave të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës me nr. 6174, datë 16.12.2019, Posta Shqiptare sh.a., gjatë vitit 2024 ka raportuar treguesit e mëposhtëm lidhur me numrin e pikave të aksesit të shërbimit postar:


- 535 zyra postare të përhershme të hapura për publikun;
- 704 sportele, nga të cilët 576 sportele të automatizuar/kompjuterizuar, krahasuar me 525 në vitin 2023;
- 579 kuti postare për pranimin e objekteve postare;
- 667 kuti postare për dorëzimin e objekteve postare.

Për sa i përket infrastrukturës së automjeteve të transportit, Posta Shqiptare ka raportuar se në vitin 2024 ka pasur në përdorim 168 mjete transporti (furgona, vetura, motoçikleta/biçikleta) apo 10% më shumë se 153 mjete të raportuar për vitin 2023.

Pas një tkurrje me 16% në vitin 2023, numri total i objekteve postare të Shërbimit Universal në vitin 2024 u rrit me 4%, duke arritur në 19.3 milionë.

Rritja e numrit të objekteve postare të SHU ka ardhur për shkak të rritjes me 4% të numrit të objekteve postare brenda vendit, të cilat përbëjnë 96% të totalit të SHU. Objektet postare ndërkombëtare rezultuan me rritje të ndjeshme me 32% në vitin 2024, ku numri i objekteve postare ndërkombëtare dalëse u rrit me 89% dhe objektet postare ndërkombëtare hyrëse u rritën me 17%.

Figura 16 Ecuria e numrit të objekteve Shërbimit Universal Postar (2020-2024)



Për sa i përket standardeve të cilësisë në lidhje me kohën e shpërndarjes së objekteve postare të SHU, tabela e mëposhtme paraqet të dhënat për afatet kohore të shpërndarjes së objekteve postare brenda vendit sipas objektivave të përcaktuara në Rregulloren nr. 36/2015 të AKEP për SHU postar dhe realizimin e tyre nga Posta Shqiptare për vitin 2024.

Tabela 7. Koha e shpërndarjes së objekteve postare brenda vendit 2024


	Afati kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje sipas afatit)	Realizimi 2024
Brenda qytetit	D+1	95%	96.8%
	D+2	5%	3.2%
Midis qyteteve	D+1	85%	96.5%
	D+2	15%	3.5%
Në fshatra	D+2	60%	85.3%

Shënim:

D: data e depozitimit (pranimit) të objektit postar në (nga) ofruesi i Shërbimit Universal Postar.

n: numri i ditëve të punës që duhen për shpërndarjen e objektit nga data e pranimit deri në datën e dorëzimit tek i adresuari.

Në vitin 2024 treguesit e kohës së shpërndarjes së objekteve postare brenda vendit janë realizuar nga Posta Shqiptare brenda afateve të përcaktuara nga Rregullorja e AKEP për SHU, ku 97% e objekteve postare në zonat urbane janë shpërndarë në D+1 (1 ditë pas pranimit), krahasuar me objektivat 95% dhe 85% për dorëzimin brenda qytetit dhe midis qyteteve respektivisht. Për objektet postare me destinacion zonat rurale/fshatra, 85% e objekteve postare janë dorëzuar në D+2 (2 ditë pas pranimit), krahasuar me detyrimin 60% sipas Rregullore së SHU të AKEP.



IV. MBROJTJA E KONSUMATORIT

1. Kontrata e pajtimit të konsumatorit/Klauzola e indeksimit të tarifave me indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK)

Një çështje e rëndësishme që ka qenë pjesë e komunikimeve në dy vitet e fundit me dy operatorët për termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit ka qenë përfshirja nga dy sipërmarrësit në këto dokumente, e kushtit kontraktor që parashikon të drejtën e sipërmarrësit për të indeksuar/rritur tarifën/tarifat e shërbimeve sipas inflacionit/normës mesatare të ndryshimit të indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), të publikuara nga INSTAT për vitin e mëparshëm. Kjo klauzolë parashikon që sipërmarrësi ka të drejtë të rritë tarifën/tarifat me një përqindje të barabartë me vlerën e IÇK të publikuar nga INSTAT, dhe ky ndryshim tarife të mos konsiderohet ndryshim në termat dhe kushtet e kontratës që i jep të drejtën pajtimtarit të zgjidhë kontratën me afat të caktuar pa penalitet, pasi është zbatim i një kushti kontraktor për të cilin pajtimtari ka rënë dakord në kohën e lidhjes së kontratës apo njoftimit të përfshirjes së klauzolës në kontratë.

AKEP bazuar në përcaktimet ligjore dhe nënligjore, si dhe në praktikën në vende të tjera evropiane, ka vlerësuar që klauzola kontraktore e IÇK e përfshirë në termat dhe kushtet e përgjithshme është kusht kontraktor shumë i rëndësishëm për pajtimtarin pasi është i lidhur drejtpërsëdrejti me tarifën/tarifat që do të paguajë pajtimtari gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Në mënyrë që aplikimi i klauzolës së IÇK i përfshirë në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së pajtimit të mos konsiderohet si ndryshim kushti kontraktor (pika 3 e nenit 99 të ligjit 9918), pajtimtari duhet të jetë i mirinformuar për këtë kusht kontraktor, në kohën e nënshkrimit/lidhjes së kontratës dhe/ose në kohën e përfshirjes së klauzolës në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës. Në rast të kundërt, pika 3 e nenit 99 të ligjit nr. 9918/2008 duhet të zbatohet në kohën e aplikimit të klauzolës nga sipërmarrësi (kryerjen e rritjes së tarifës). Në mënyrë që pajtimtari të konsiderohet se është i mirinformuar për klauzolën e IÇK të përfshirë në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës, në kohën e nënshkrimit të kontratës, AKEP ka kërkuar nga të dy operatorët që informacioni për klauzolën e IÇK duhet të përfshihet në mënyrë të qartë edhe në:

- Aneksin e kontratës së nënshkruar nga pajtimtari që përmban planin tarifor të pajtimtarit (neni 16 i Rregullores nr. 49/2021), në formën e një shënimi për planin tarifor të përzgjedhur nga pajtimtari;
- Informacionin parakontraktor të referuar në nenin 9, të Rregullores nr. 49/2021;
- Informacionin e publikuar për planet tarifore, të cilat janë objekt i indeksimit (neni 98 i ligjit nr. 9918/2008 dhe përcaktimet e Rregullores nr. 49/2021 dhe Rregullores nr. 27/2012).

Për pajtimtarët ekzistues me terma dhe kushte të përgjithshme pa klauzolë IÇK, përfshirë pajtimtarët që kanë nënshkruar kontratë me klauzolën e IÇK në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës, por që nuk plotësohen kushtet e mirinformimit të pajtimtarit të cituara më sipër, AKEP-i ka kërkuar që sipërmarrësi të zbatojë detyrimin e pikës 3 të nenit 99 të ligjit nr. 9918/2008, pra njoftimin e pajtimtarit me mjet të qëndrueshëm dhe informim për të drejtën e tij për zgjidhjen e kontratës pa penalitet në rast se nuk pranon kushtet e reja. Ky njoftim, sipas pikës 3 të nenit 99 të ligjit nr. 9918/2008, duhet të kryhet në mënyrë të diferencuar nga njoftimi për

ndryshimet e tjera të termave dhe kushteve të përgjithshme të kontratës, dhe ky njoftim i dedikuar për klauzolën e IÇK duhet:

- të jetë individual dhe me mjet të qëndrueshëm;
- të specifikojë formulën e indeksimit dhe kohën se kur do të aplikohet indeksimi;
- informim për të drejtën e pajtimtarit për zgjidhjen e kontratës pa penalitet deri në 30 ditë nga marrja e njoftimit.

One Albania dhe Vodafone Albania kanë publikuar termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit të ndryshuara duke reflektuar kërkesat dhe rekomandimet e AKEP-it. Termat dhe kushtet e përgjithshme të ndryshuara për shërbimet e rrjetit celular dhe rrjetit fiks të kategorive Konsumator dhe Biznes të One Albania kanë hyrë në fuqi më 30.1.2024 (1.3.2024 për pajtimtarët ekzistues), ndërsa të Vodafone Albania më 30.3.2024. Të dy sipërmarrësit kanë publikuar në faqet e tyre të internetit njoftime dhe sqarime të veçanta për klauzolën e IÇK.

Për sa i përket zbatimit të klauzolës së IÇK, të dy operatorët i janë referuar normës mesatare të ndryshimit të IÇK që publikohet nga INSTAT në muajin janar për vitin e mëparshëm (për vitin 2023, norma mesatare e IÇK e publikuar nga INSTAT ishte 4.8%), por Vodafone Albania nuk e ka aplikuar klauzolën në vitin 2024, ndërsa One Albania e aplikoi më datë 1.6.2024 vetëm për pajtimtarët e kategorisë Biznes.

One Albania e ka informuar AKEP-in se klauzola e IÇK u zbatua për 15,126 pajtimtarë individualë të kategorisë biznes dhe 3,265 subjekte biznesi të regjistruar me NIPT, zotërues të 195,282 numrave celularë, prej të cilëve 78,308 numra celularë Biznes + 116,974 karta M2M (karta për transmetim të dhënash Makinë me Makinë).

Procesi i publikimit të termave dhe kushteve të reja kontraktore dhe përfshirja e klauzolës së IÇK më 30.1.2024 nga One Albania është shoqëruar me dërgimin e njoftimeve individuale me 2 SMS informuese të veçanta për të gjithë pajtimtarët ekzistues (1 SMS për përditësimin e termave dhe kushteve dhe 1 SMS për klauzolën e IÇK), duke informuar pajtimtarët për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata pa penalitet brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Gjithashtu, për pajtimtarët e kategorisë biznes për të cilët u aplikua klauzola e IÇK, sipërmarrësi ka dërguar edhe njoftim të veçantë me SMS dhe/ose *email* për rritjen e tarifës mujore me 4.8%, që përmbante dhe një link në faqen e internetit të One Albania për përlogaritjen e tarifës së re pas indeksimit me IÇK/rritjes me 4.8%.

Klauzola e IÇK në vendet e BE

Dy sipërmarrësit në argumentet e përcjella në AKEP kanë dhënë shembuj të aplikimit të kësaj klauzole në një sërë vendesh të BE-së, përfshirë operatorë të tjerë pjesë e grupeve të kompanive pronare të dy sipërmarrësve, si dhe kanë referuar vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED) të datës 26.12.2015, në kazusin C-326/14, *Verein für Konsumenteninformation* (Consumer Information Association) v *AI Telekom Austria AG*, nëpërmjet të cilit GJED (CJEU-Fourth chamber) ka dhënë interpretimin se *në kuptim të Nenit 20(2) të Direktivës 2002/22/EC, një ndryshim në tarifa, që vjen si rezultat i një klauzole të axhustimit të çmimit të përfshirë në termat dhe kushtet standarde të kontratës, e cila parashikon që ky ndryshim është i bazuar në ndryshimet që pëson indeksi i çmimeve të konsumit të hartuar nga një institucion publik, nuk përbën modifikim të kushteve kontraktuale në kuptim të këtij parashikimi, që i jep të drejtën pajtimtarit të ndërpresë kontratën pa penalitet.*

Klauzola e IÇK është përfshirë në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit dhe nga operatorë në vende të tjera, sidomos vitet e fundit pas situatës inflacioniste në shumë vende të BE-së, dhe aplikimi i saj ka qenë objekt diskutimi dhe interpretimi dhe në vende/rregullatorë të tjerë.

Nga informacioni që ka marrë AKEP rezulton se e drejta për indeksim me normën e inflacionit nuk është e ndaluar apo lejuar në mënyrë eksplicite në legjislacionin specifik sektorial apo të përgjithshëm, përveçse në Angli ku autoriteti rregullator (OFCOM) ka vendosur rregulla dhe ka dhënë udhëzime për rastet *kur* dhe *si* operatorët mund të përfshijnë indeksimin në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës, dhe në Itali ku autoriteti rregullator (AGCOM) ka kryer një proces konsultimi në vitin 2023 në lidhje me rishikimin e rregullores ekzistuese për kontratat e pajtimit pas transpozimit të EECC, duke propozuar rregulla edhe për klauzolën e IÇK. OFCOM ka kryer një proces Këshillimi Publik në lidhje me këtë çështje dhe ka miratuar gjatë vitit 2024 ndryshime në kuadrin rregullator, të cilat ndalojnë aplikimin e rritjes së tarifave të shprehura në përqindje (indeksimi me CPI/IÇK), ku rritjet gjatë kohëzgjatjes së kontratës duhet të shprehen në terma monetare (*pound* dhe *pence*).

BEREC në dokumentin BoR (24) 180 “Opinion i BEREC mbi tregun dhe zhvillimet teknologjike dhe mbi ndikimin e tyre në zbatimin e të drejtave të përdoruesve fundorë në EECC (neni 123)” publikuar më 5.12.2024, ka konsideruar përfshirjen dhe aplikimin nga operatorët në vendet e BE/BEREC të klauzolave kontraktore për rritje të çmimeve gjatë kohëzgjatjes së kontratës (*In-contract price increase clauses*) sipas IÇK apo IÇK plus një marzh, si zhvillim me ndikim shqetësues për të drejtat dhe përfitimet e përdoruesve fundorë, pasi në disa raste ato kanë rezultuar në rritje të ndjeshme të tarifave dhe/ose përdoruesit nuk kanë të drejtën e ndërprerjes pa penalitet të kontratës.

Opinion i dhe propozimi i BEREC për Komisionin Evropian për këtë çështje (*In-contract price increase clauses*) është përfshirë në Aneksin I të BoR (24) 180, si më poshtë:

Këto klauzola paraqesin sfida për sa i përket konkurrencës, përbalueshmërisë, lëvizshmërisë (ndërrimit të ofruesit të shërbimit) së përdoruesit fundor, transparencës dhe krahasueshmërisë së çmimeve. Përdorimi i tyre krijon rrezik që objektivat e përcaktuara në nenin 3 të EECC të mos përmbushen. Kjo çështje duhet të merret në konsideratë në kontekstin e çdo propozimi legjislativ për të ndryshuar Titullin III të Pjesës III të EECC (kapitulli i të drejtave të përdoruesve fundorë).

2. Ankesat e konsumatorëve për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare

Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9918/2008 (zëvendësuar me ligjin nr. 54/2024) si dhe të ligjit nr. 46/2015, përdoruesit fundorë (konsumatorë dhe biznese) të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare kanë të drejtë të ankohen tek ofruesi përkatës i shërbimit për çdo problematikë të hasur me ofrimin e shërbimit dhe/ose zbatimin e kushteve kontraktore, përfshirë për tarifën e aplikuar. Në rast se përdoruesit fundorë nuk marrin përgjigje dhe/ose nuk janë të kënaqur me zgjidhjen e dhënë nga ofruesi i shërbimit, ata kanë të drejtë të kërkojnë nga AKEP zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ofruesin e shërbimit të komunikimit elektronik apo postar sipas përcaktimeve përkatëse ligjore dhe nënligjore për komunikimet elektronike dhe postare. Gjithashtu, ligji nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar, ka përcaktuar AKEP si strukturën përkatëse për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare.


AKEP ka vendosur një sërë mjetesh në dispozicion të pajtimtarëve për depozitimin e ankesave në rrugë shkresore dhe elektronike me *email*, përfshirë formularë për pajtimtarët për kërkesa për zgjidhje mosmarrëveshje me operatorët të publikuara në faqen e internetit të AKEP-it si dhe një modul *online* (<https://akep.al/e-ankesa/>) i disponueshëm direkt në faqen kryesore (*homepage*) të internetit të AKEP.

Ankesat për shërbimet e komunikimeve elektronike

Në vitin 2024 në AKEP u depozituan 972 ankesa nga pajtimtarët e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, prej të cilave 413 ankesa ishin për problematikat për refuzimin e portimit të numrit nga operatori dhënës celular dhe 559 ankesa lidhur me shërbimin nga rrjete celulare dhe fikse për probleme me faturimin, vonesa për mbylljen e kontratës apo kalimin nga plane tarifore paspagesë në ato me parapagesë, cilësinë e shërbimit etj.

Numri total i ankesave të pajtimtarëve të depozituara në AKEP gjatë vitit 2024 rezultoi me rënie të ndjeshme prej 54% në krahasim me vitin 2023, me rënie më të madhe prej 70% në numrin e ankesave për refuzim të kërkesave për portim të numrit celular, ndërkohë që ankesat për problematika me shërbimin nga rrjete celulare dhe fikse u reduktuan me 26%.

Figura 17. Ecuria vjetore e numrit të ankesave të pajtimtarëve në komunikime elektronike 2020-2024




Ankesat sipas objektit dhe llojit të shërbimit celular kundrejt fikse

Objekti kryesor i ankesave në periudhën 2020-2024 kanë qenë problematikat e hasura në refuzimin e kërkesave për portimin e numrit celular nga operatori dhënës i numrit, të cilat në vitin 2020 përbënin 96% të numrit total të ankesave, ndërsa në vitet në vijim ky numër është reduktuar duke arritur në 42% në vitin 2024. Ndërkohë numri i ankesave lidhur me shërbimin nga rrjete celulare në vitin 2024 ishte 448 (46% e numrit total të ankesave) dhe 111 ankesa për shërbimin nga rrjete fikse (11% e totalit të ankesave).

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë mujore të numrit të ankesave sipas objektit kryesor dhe shërbimeve/rrjeteve celulare dhe fikse në vitin 2024, ku vihet re një rënie e konsiderueshme e

numrit total të ankesave, nga 151 ankesa në muajin janar në vetëm 40 ankesa në muajin dhjetor. Rënia më e ndjeshme vihet re në numrin e ankesave për operatorët e rrjeteve celulare, si për refuzim të kërkesave për portim dhe për shërbim nga rrjeti celular, ndërsa numri i ankesave për shërbim nga rrjete fikse ka një trend të stabilizuar në mesatarisht rreth 10 ankesa në muaj.

Figura 18. Ecuria mujore e numrit të ankesave të pajtimtarëve komunikime elektronike sipas shërbimeve Celulare kundrejt Fiks (2024)



Ankesat sipas operatorëve

Shumica e ankesave (839 apo 86% totalit të ankesave) të depozituara në AKEP në vitin 2024 ishin për sipërmarrësin One Albania, prej të cilave 488 ankesa ishin lidhur me shërbimin (389 rrjet celular dhe 99 rrjet fiks) dhe 351 ankesa për refuzim të portimit të numrit celular si operator dhënës i numrit. Ndërsa për sipërmarrësin Vodafone Albania u depozituan 123 ankesa, prej të cilave 61 ankesa ishin lidhur me shërbimin (43 rrjet celular dhe 18 rrjet fiks) dhe 62 ankesa për refuzim të portimit të numrit celular si operator dhënës.

Figura 19. Ankesat e pajtimtarëve sipas operatorëve, viti 2024





Figura e mëposhtme paraqet ecurinë tremujore të numrit të ankesave të pajtimtarëve të One Albania të depozituara në AKEP në dy vitet e fundit, ku vihet re një ulje e ndjeshme e numrit të ankesave për sipërmarrësin, nga 500-650 ankesa në T1-T3 2023 në 110 ankesa në T4 2024. Numri i ankesave të pajtimtarëve të One Albania për refuzim të kërkesës për portim arriti pikun në T2 2023 (rreth 500 ankesa) dhe për çështje të lidhura me shërbimin në T3 2024 (rreth 220 ankesa), ndërsa më pas kanë pasur trend në rënie duke arritur në 44 ankesa për refuzim kërkesë për portim numri, dhe 66 ankesa për shërbim celular dhe fiks në T4 2024.

Figura 20. Ecuria tremujore e numrit të ankesave të pajtimtarëve të One Albania (2023 -2024)



Mosmarrëveshje të trajtuara nga Komisioni i Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (KZAM)

Shumica e ankesave të administruara nga AKEP depozitohen në rrugë elektronike me *email* ose nëpërmjet modulit *online* e-ankesa, dhe nuk klasifikohen si kërkesa për zgjidhje (alternative) mosmarrëveshje, pasi ankimesit nuk e kanë ezauruar fazën e ankimit me shkrim tek ofruesi përkatës i shërbimit dhe/ose janë jashtë afatit procedural/ligjor 15/30 ditor. Megjithatë, AKEP pranon të gjitha llojet e ankesave, të cilat ia përcillen palës së ankimit dhe nëse ankimesi nuk është i kënaqur me sqarimin dhe/ose zgjidhjen e dhënë nga ofruesi i shërbimit, ankimesi mund të kërkojë trajtimin e ankesës nga AKEP-i me procedurë formale zgjidhje (alternative) të mosmarrëveshjeve. Shumica e ankesave janë zgjidhur në saj të bashkëpunimit të ofruar edhe nga vetë operatorët e ankimit, pa qenë nevoja që ankesat të kalojnë në procedurë zgjidhje (alternative) të mosmarrëveshjeve me kërkesë të ankimesit.

Në vitin 2024, Komisioni i Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (KZAM) ka trajtuar 9 ankesa/kërkesa me procedurë zgjidhje alternative mosmarrëveshje, prej të cilave 7 mosmarrëveshje për shërbime të komunikimeve elektronike dhe 2 mosmarrëveshje për shërbimin postar.

Mosmarrëveshjet ndërmjet pajtimtarëve dhe operatorëve të komunikimeve elektronike, 7 të tilla kanë pasur si objekt problematika në lidhje me tarifimin, mosmbylljen e kontratës apo kalim në plan tarifor me parapagim dhe portim numri. Për 5 mosmarrëveshje është arritur zgjidhje miqësore midis palëve në seanca dëgjimore/pajtimi apo nëpërmjet rekomandimeve të KZAM, ndërsa në 2 mosmarrëveshje, pavarësisht zgjidhjes së ofruar nga operatori apo rekomandimit të KZAM për zgjidhje në favor të pajtimtarit, pajtimtarët kanë kërkuar kompensim apo zbritje më të madhe se zgjidhja e ofruar ose dëmshpërblim monetar për dëm moral, duke ju referuar dhe Kodit Civil, të cilat janë jashtë objektit të KZAM dhe ankimuesit kanë të drejtën të kërkojnë zgjidhjen në rrugë gjyqësore.

Ankesat për shërbimin postar

Në vitin 2024 në AKEP u depozituan 3 ankesa nga përdorues të shërbimit postar, prej të cilave 2 ankesa ishin në lidhje me shërbimin postar të ofruar nga United Transport dhe me tregtinë elektronike dhe 1 ankesë ishte në lidhje me humbjen e një objekti postar ndërkombëtar nga Posta Shqiptare.

Një ankesë e lidhur me mosdorëzimin e objektit postar/mallit të porositur *online* u zgjidh miqësisht midis ofruesit të shërbimit dhe ankimuesit nëpërmjet kompensimit/rimbursimit të ankimuesit/palës marrëse të objektit postar të porositur *online*, pa kaluar në procedurë formale Zgjidhje Alternative e Mosmarrëveshjes (ZAM), ndërsa 2 ankesat e tjera u trajtuan me procedurë nga Komisioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes (KZM) e AKEP.

Një mosmarrëveshje ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar Posta Shqiptare kishte si objekt kryesor të mosmarrëveshjes vlerën e dëmshpërblimit të ofruar nga ofruesi i shërbimit për reklamimin e bërë nga ankimuesi/pala dërguese për mosdërgimin në adresë të palës marrëse të një objekti postar me destinacion ndërkombëtar. Në përfundim të shqyrtimit të provave dhe pretendimeve të palëve, KZM e AKEP-it arriti në përfundimin se vlera e dëmshpërblimit e ofruar/autorizuar nga Posta Shqiptare gjatë procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes ishte në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore si dhe me përcaktimet e rregullores përkatëse të Unionit Ndërkombëtar të Postave (UPU) të aplikueshme për vlerën e dëmshpërblimit për objektet postare ndërkombëtare të humbura dhe Postën Shqiptare si anëtare e UPU-së si ofruesi i Shërbimit Universal Postar në Shqipëri. KZM në seancë dëgjimore dhe në vendimin për mosmarrëveshjen sqaroi se nuk mund të vendosë detyrim mbi ofruesin e shërbimit postar për t'i paguar ankimuesit, dëmshpërblim mbi vlerat maksimale të dëmshpërblimit, të aplikueshme sipas përcaktimeve të ligjit nr. 46/2015 dhe akteve të UPU-së, përfshirë zhdëmtimin e plotë të vlerës së humbur (të deklaruar për qëllime doganore) në rastet kur objekti postar i reklamuar nuk është objekt postar i siguruar, apo dëmshpërblim për fitime të munguara apo dëm moral të shkaktuar palës dërguese dhe/ose palës marrëse nga humbja e një objekti postar.

Një mosmarrëveshje ndërmjet përdoruesit (palë marrëse e objektit postar/malli të porositur *online*) dhe ofruesit të shërbimit postar konsistonte në refuzimin e ankimuesit për marrjen/pranimin e objektit postar/mallit të blerë *online* për shkak të detyrimit shumë të lartë doganor, duke kërkuar nga ofruesi i shërbimit postar kthimin e objektit postar/mallit tek pala dërguese (shitësi i mallit *online* jashtë RSH), ndërsa ofruesi i shërbimit postar kërkonte

konfirmimin nga pala dërguese e objektit postar (shitësi jashtë territorit të RSH) për pranimin e kthimit të objektit postar/mallit dhe pagesën e detyrimeve dhe tarifave përkatëse. KZAM i AKEP i ka rekomanduar ankimuesit që të komunikojë me palën dërguese të objektit postar (shitësi jashtë RSH) për të konfirmuar/autorizuar ofruesin e shërbimit postar (United Parcel Service - UPS i vendit të origjinës) për pranimin e kthimit të objektit postar/mallit sipas sqarimit të ofruesit të shërbimit postar United Transport (UPS i vendit të origjinës).

3. Portabiliteti i numrit

Portabiliteti i numrit është një lehtësi apo mundësi për të gjithë përdoruesit fundorë që janë pajtimtarë të shërbimit publik telefonik të pajisur me numra nga Plani Kombëtar i Numeracionit që të ruajnë numrat e tyre, sipas kërkesës, kur ata ndërrojnë sipërmarrësin që u ofron shërbimin publik telefonik dhe shërbime të tjera të lidhura me numrin e telefonit. E drejta e portimit të numrit dhe zbatimi me efektivitet i saj konsiderohet një faktor i rëndësishëm për maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike pasi portimi i numrit (ruajtja e numrit) të telefonit lehtëson procesin e zgjedhjes dhe ndërrimit të ofruesit të shërbimit të komunikimeve elektronike për pajtimtarët si dhe njëkohësisht nxit konkurrencën efektive midis ofruesve të shërbimeve në tregun e komunikimeve elektronike.


Portabiliteti i numrit nisi të zbatohet në Shqipëri sipas përcaktimeve të neneve 87-88 të ligjit nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore përkatëse të nxjerra nga AKEP në vitin 2010, të cilat përfshinin Rregulloren nr. 13/2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 1219, datë 07.4.2010, si dhe dokumentin, “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.6.2010, nëpërmjet të cilit u kryen dhe procedurat përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave referencë të centralizuar të portabilitetit (CRDB).

Portimi i numrave për pajtimtarët e rrjeteve dhe shërbimeve publike telefonike të lëvizshme filloi në vitin 2011, ndërsa për pajtimtarët e rrjeteve dhe shërbimeve publike telefonike fikse filloi në vitin 2012. Deri në fund të vitit 2024 rezulton se janë portuar në total rreth 1.3 milionë numra celularë dhe rreth 20 mijë numra fikse.

Sasia e numrave celularë të portuar gjatë një viti në periudhën 2011-2024 ka qenë rreth 100 mijë portime në vit dhe pas arritjes së pikut në vitin 2017 (mbi 250 mijë portime), ka ardhur në rënie, përveç periudhës 2020-2021 ku sasia e numrave celularë të portuar u rrit më shumë se dy herë në krahasim me vitin 2019.

Në periudhën 2022-2024 ka vijuar tendenca në rënie e portimeve të numrave celularë dhe fikse dhe në vitin 2024 u portuan 19,452 numra celularë dhe 173 numra fikse, që përbën një reduktim me 50% të portimeve në krahasim me vitin 2023, si dhe nivelet më të ulëta historike të sasisë vjetore të numrave të portuar prej fillimit të zbatimit të portabilitetit të numrit në Shqipëri (2011/2012).

Figura 21. Ecuria e sasive të numrave të portuar gjatë 2012-2024




Problematikat në lidhje me portabilitetin

Problematikat e raportuara në ankesat e pajtimtarëve lidhen me refuzimet e kërkesave për portim të numrit nga operatori transferues, për arsye të mospërputhjes së ID së përdoruesve me parapagim në sistemet e operatorit dhënës/transferues me ID në kërkesën për portim të dërguar nga operatori marrës/përfitues dhe detyrimeve kontraktore të pajtimtarit me paspagim tek operatori transferues.

Siç është referuar në seksionin e ankesave, numri i ankesave për portimin e numrit është reduktuar ndjeshëm në vitin 2024, në krahasim me vitin 2023, ku u vu re një rritje e konsiderueshme e ankesave për refuzim/vonesa në portim të numrit celular, në krahasim me vitin 2022. Megjithatë, pavarësisht rënies së numrit të ankesave për refuzimin e kërkesave për portim, përqindja e kërkesave për portim të refuzuara nga operatori dhënës celular pas reduktimit në nivele rreth 30-35% në vitin 2019 (pas ndryshimeve në Rregulloren e portabilitetit në vitin 2018) është rritur sërish në vitin 2020 në 60% refuzime dhe vijoi të jetë mbi nivelin 50% edhe në vitin 2024.

Figura 22. Ecuria e përqindjes së kërkesave për portim të refuzuara nga operatori dhënës 2016-2024



Për sa i përket problematikave në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim të numrit nga operatori dhënës celular, AKEP gjatë vitit 2024 ka punuar për draftimin e ndryshimeve në Rregulloren nr. 43/2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, e ndryshuar, të cilat përfshijnë vendosjen e detyrimeve për operatorin dhënës (ODH) të numrit celular për komunikimin dhe informimin e pajtimtarit në lidhje me arsyen e refuzimit të kërkesës për portim, si dhe përcaktimet e reja ligjore të lidhura me portabilitetin e numrit (neni 145 i ligjit nr. 54/2024), të cilat përfshijnë disa ndryshime të rëndësishme në lidhje me të drejtën e portimit të numrit për konsumatorët.

V. MONITORIMI I PËRDORIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE DHE VEPRIMTARIA E INSPEKTIMIT TË TREGJEVE TË MBIKËQYRURA

1. Veprimtaria monitoruese e spektrit të frekuencave gjatë vitit 2024

Në referim të ligjit nr. 54, datë 30.5.2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP është përcaktuar si autoriteti kombëtar përgjegjës për monitorimin e përdorimit të spektrit të frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave.

Monitorimi i spektrit të frekuencave ka si qëllim:

- ✓ Monitorimin periodik me anë të stacioneve fikse të monitorimit të spektrit të frekuencave RFMS dhe SRMF, ofrimin e të dhënave të vlefshme për procesin e administrimit të spektrit lidhur me përdorimin aktual të kanaleve të frekuencave dhe brezave të frekuencave, verifikimin e karakteristikave teknike reale të sinjaleve të transmetuara, ofrimin e informacioneve të monitorimit për kërkesat për asistencë të veçantë të administratave të vendeve fqinje në eliminimin e interferencave të dëmshme, si dhe identifikimin e pastrimin e transmetimeve jashtë brezi.
- ✓ Monitorimin e frekuencave të radiolidhjeve fikse në pikat kryesore transmetuese të Republikës së Shqipërisë, ku janë instaluar pajisjet transmetuese të sipërmarrësve, me qëllim verifikimin e përdorimit të frekuencave të dhëna me autorizim.
- ✓ Monitorimin e cilësisë së shërbimit të telefonisë mobile me qëllim evidentimin e zonave problematike me cilësi të dobët shërbimi dhe nxitja e operatorëve për përmirësim të mëtejshëm në këto zona për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE.

Monitorimi i spektrit të frekuencave kryhet nëpërmjet stacioneve të monitorimit RFMS – Zall Herr dhe RFMS – Pinet në brezin e frekuencave 20 MHz deri në 3000 MHz, ndërsa nëpërmjet stacioneve të monitorimit SRFMS – Shkodër, SRFMS – Vlorë, SRFMS – Korçë, SRFMS – Gjirokastrë dhe SRFMS – Fier në brezin e frekuencave 20 – 8500 MHz.

Kontrolli i sistemit të monitorimit realizohet nga Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC), e cila është vendosur në zyrat në Tiranë dhe zyrat rajonale Vlorë, Korçë dhe Shkodër. Nga këto zyra është e mundur të kontrollohen në distancë të gjithë Stacionet Fikse (RFMS) dhe Stacioni përkatës i Thjeshtë Fiks i Monitorimit (SRFMS).

Monitorimi me anë të stacioneve fikse të monitorimit të spektrit bëhet sipas përcaktimeve të prioriteteve të spektrit të frekuencave mbi baza javore dhe mujore.

Pas monitorimit të spektrit të frekuencave me anë të stacioneve të pozicionuara në Pinet, Shkodër, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë dhe Fier, të dhënat janë përpunuar dhe përmbledhur në raportet e monitorimit për secilin stacion çdo 3-muaj, të cilat më pas i janë përcjellë pranë MCC.

Detyra më e rëndësishme e monitorimit me anë të stacioneve fikse është mbledhja e të dhënave mbi përdorimin e spektrit radio të frekuencave radio. Kjo mund të bëhet me matje individuale, por gjithashtu nëpërmjet regjistrimeve. Përveç trajtimit të interferencave, që përgjithësisht identifikohet si detyra më e rëndësishme e monitorimit, mbledhja e të dhënave të Okupimit të Kanaleve të Frekuencave (FCO) dhe Okupimit të Brezave të Frekuencave (FBO), që njihen dhe si regjistrime të Brezave të Frekuencave, mund të identifikohen si detyra tjetër tepër e rëndësishme e sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR.

Monitorimi i spektrit të frekuencave të radiolidhjeve fikse

Monitorimi i spektrit të frekuencave kryhet nëpërmjet stacioneve të lëvizshme të monitorimit Mobile Monitoring Station – MMS. Stacionet e monitorimit janë shumë-qëllimesh, ato janë të pajisur me të njëjtat pajisje si RFMS, si dhe me një komplet pajisjesh portative, në mënyrë që të kryejnë gjithë tipet e matjeve speciale, p.sh., tek lidhjet radio fikse (radio reletë apo radio-linjet) ose matësit e intensitetit të fushës elektromagnetike. Me anë të MMS janë kryer operacione monitorimi në të gjithë vendin.

Qëllimet kryesore të përdorimit të këtyre pajisjeve gjatë vitit 2024 kanë qenë verifikimi i përputhshmërisë ligjore dhe administrative i detyrimit të sipërmarrësve që operojnë nën regjimin e Autorizimit Individual të AKEP-it, si dhe që përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit, kryesisht për përdorimin e brezit të frekuencave të caktuara për përdorim radiolidhje fikse sipas Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave të AKEP.

Kryerja e monitorimit nga sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR në kuadër të veprimtarisë vjetore të monitorimit të spektrit të frekuencave, për monitorimin e radiolidhjeve fikse, u realizua të paktën një herë në vit, në vendndodhjet kryesore ku janë instaluar pajisjet transmetuese të sipërmarrësve.

Figura 23. Kulla transmetimi të operatorëve të telefonisë së lëvizshme



Monitorimi në secilën pikë transmetimi është realizuar nga grupi i monitorimit, në përbërjen e të cilit janë pjesëtarë nga sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyra e Rajonale të Monitorimit të SFR. Pasi janë mbledhur të dhënat nga matjet në terren për secilin stacion transmetimi të monitoruar, ato janë përpunuar në raporte monitorimi ku janë detajuar parametrat teknike të transmetimeve siç janë frekuenca qendrore, gjerësia e kanalit, drejtimi etj.

Gjatë vitit 2024, në përputhje me planin për monitorimin periodik të spektrit të frekuencave, janë kryer 24 procese monitorimi për radiolidhjet fikse.

Monitorim i cilësisë së shërbimit QoS për telefoninë e lëvizshme viti 2024

AKEP, si organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, realizon në mënyrë të vazhdueshme monitorimet e treguesve të cilësisë së shërbimit QoS (*Quality of service*) të telefonisë së lëvizshme në të gjitha zonat e Republikës së Shqipërisë.

Kryerja e monitorimit të frekuencave për cilësinë e shërbimit QoS për telefoninë e lëvizshme në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet me qëllim konstatimin e të dhënave reale të marra nga terreni mbi parametrat teknike të cilat i ofrohen përdoruesit fundor, rritjes së cilësisë së shërbimit të telefonisë mobile, evidentimin e zonave problematike me cilësi të dobët shërbimi dhe nxitja e operatorëve për përmirësim të mëtejshëm në këto zona për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE.


Mbulimi me shërbime të telefonisë së lëvizshme i akseve rrugore dhe zonave turistike

- Për vitin 2024, operatori “One Albania” sh.a., ka ndërtuar 13 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.
- Për vitin 2025, operatori “One Albania” sh.a., ka planifikuar ndërtimin e 9 stacioneve (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.
- Për vitin 2024, operatori “Vodafone Albania” sh.a., ka ndërtuar 12 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.
- Për vitin 2025, operatori “Vodafone Albania” sh.a., është duke përgatitur buxhetet përkatëse për ndërtimin e stacioneve për përmirësimin e shërbimit në akset rrugore dhe zonat turistike.

Për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nevojitet ndërtimi i siteve (ministacioneve) të reja nga operatorët. Ndërtimi i këtyre siteve nga operatorët po has vështirësi në marrjen e lejeve mjedisore, refuzimin e banorëve të godinave ku janë përcaktuar ndërtimi i siteve, si dhe mosrinovimi i qerave të siteve (ministacioneve) aktuale nga institucionet shtetërore. Kërkesat për lejet për stacionet e reja si dhe problematikat e mësipërme janë paraqitur nga operatorët pranë MIE.

Gjatë vitit 2024, AKEP ka vijuar të monitorojë ecurinë e mbulimit me shërbim celular të akseve kryesore rrugore të vendit duke kërkuar nga të dy operatorët implementimin e stacioneve të reja të dedikuara. Situata e këtij mbulimi jepet në figurën më poshtë.


Figura 23. Shërbimet zanore dhe transmetimit të të dhënave për akset kryesore rrugore



Një rëndësi e veçantë i është kushtuar monitorimit të zonave turistike dhe rrugëve të reja të hapura për qarkullim gjatë vitit 2024, si:

- Zonave turistike Thethi, Vermoshi, Lëpusha, Valbona, Sotirë (bashkia Gramsh), Dardha, Voskopoja, në të cilat janë përmirësuar shërbimet e telefonisë së lëvizshme. Problematike ngelet zona turistike e Lëpushës e pambuluar me shërbim nga operatori “Vodafone Albania” sh.a., zona turistike e Lurës për të cilën nevojiten përmirësime nga të dy operatorët si dhe e akteve rrugore drejt zonave turistike për të cilat është kërkuar marrja e masave për përmirësime.

Figura 24. Shërbimet zanore dhe transmetimit të të dhënave për zonën turistike Valbonë dhe aksi rrugor drejt saj



- By Pass i Vlorës, tuneli Llogorasë për të cilin pas kërkesës së AKEP është rritur ndjeshëm përqindja e mbulimit me shërbim. Në tunelin e Llogorasë ofrimi i shërbimit të telefonisë së lëvizshme është brenda parametrave optimal.
- Rruga Kardhiq - Delvin dhe tuneli i Skërficës i përfshirë në këtë aks, Rruga e Arbrit, aksi rrugor Vlorë - Kuç - Gusmar - Tepelenë, si dhe aksi Ura Leskos – Qeparo, për të cilat operatorët kanë parashikuar ndërtimin e stacioneve të reja për përmirësimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme.

Për matjet e kryera janë përpiluar raportet përkatëse dhe u janë dërguar operatorëve për t'u shprehur mbi konkluzionet dhe përfundimet e këtyre raporteve, për marrjen e masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë KPI (*Key Performance Indicator*), si dhe mbulimin dhe përmirësimin me shërbime *broadband*.

Mbulimi me shërbime të telefonisë së lëvizshme në plazhe

- Për vitin 2024, operatori “One Albania” sh.a., ka ndërtuar 10 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në plazhe.
- Për vitin 2025, operatori “One Albania” sh.a., ka planifikuar ndërtimin e 6 stacioneve (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në plazhe.
- Për vitin 2024, operatori “Vodafone Albania” sh.a., ka ndërtuar 11 stacione (macro dhe micro) për përmirësimin e shërbimit në plazhe.
- Për vitin 2025, operatori “Vodafone Albania” sh.a., është duke përgatitur buxhetet përkatëse.

Në zonat ku mbulimi me sinjal nuk i përmbush parametrat KPI, operatorët pas ndërhyrjes së strukturave të AKEP-it kanë parë mundësinë e optimizimit të antenave ekzistuese që mbulojnë zonën si edhe vendosjen e stacioneve provizorë, deri në ndërtimin e stacioneve të reja të dedikuara për mbulimin e zonave gjeografikisht të izoluara, për të cilat pritet zbardhja e lejeve nga institucionet përkatëse.

Në kuadër të masave për përmirësimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në bashkitë e vendit, akseve rrugore, zonave bregdetare si dhe zonave turistike, AKEP vijon komunikimin dhe monitorimin e operatorëve, me qëllim përmirësimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme për përmbushjen e parametrave KPI, sipas përcaktimeve të rregullores nr.16, datë 16.4.2010, për “*Treguesit e cilësisë së shërbimit*” dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

AKEP ka komunikuar në mënyrë sistematike me organet shtetërore përkatëse për t'i dhënë përparësi lejeve të ndërtimit për përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave të tyre, ku marrja e një leje ndërtimi dhe zbardhja e tyre mos të jetë një proces i gjatë dhe i mundimshëm, kjo për të patur një mbulim cilësor i cili rrjedhimisht çon edhe në cilësi shërbimi me të lartë për pajtimtarin.

Për një pjesë të spektrit të frekuencave në brezat 900 dhe 1800 MHz, të dy operatorëve celularë u përfundonte afati i vlefshmërisë në mesin e vitit 2024.

Bazuar në VKM nr. 496, datë 22.7.2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”, i ndryshuar, AKEP dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zhvilluan të gjitha procedurat e përcaktuara në këtë VKM për rinovimin e autorizimeve individuale që u përfundonte afati i vlefshmërisë.

Në përfundim të procesit të negocimit mes Komisionit *ad-hoc* të Negocimit të ngritur nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe dy operatorëve celularë, është nënshkruar Akti i dakordësisë, i cili ka përcaktuar çmimin e rinovimit të secilit autorizim individual dhe disa kushte për sigurimin e mbulimit dhe cilësinë e shërbimit. Këto kushte janë përfshirë nga AKEP në autorizimet e reja individuale të rinovuara me afat 15 vjet.

Kushtet për sigurimin e mbulimit dhe cilësinë e shërbimit:

- ✓ Operatorët celularë do të sigurojnë përfundimin e mbulimit me shërbim të popullsisë deri në 99% të zonave të banuara për çdo qark, përkundrejt minimumit prej 95% që përcaktohej në autorizimin e mëparshëm.
- ✓ Operatorët celularë të sigurojnë që mbulimi me shërbim në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë minimalisht 95%, e ku posaçërisht:
 - Për tërësinë e gjatësisë së akseve rrugore kombëtare të kategorive A (autostradat) dhe B (rrugët interurbane kryesore) sipas legjislacionit në fuqi, tunelet, zonave të përfshira në projekte zhvillimore dhe me rëndësi të veçantë, mbulimi duhet të jetë mbi 99%, ndërsa për akset rrugore të kategorive C e në vijim, mbulimi duhet të jetë mbi 96%.
 - Për zonat turistike (brenda përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura), mbulimi duhet të jetë deri në 99%.
- ✓ Operatorët celularë, brenda muajit shkurt të çdo viti, përgjatë 5 vjeçarit të parë nga lëshimi i Autorizimit Individual, depozitojnë pranë AKEP-it një raport të detajuar të ecurisë së realizimit të kushteve të mësipërme të mbulimit dhe të cilësisë së shërbimit, në veçanti për zonat aktualisht të pambuluara.

AKEP-i, përveç monitorimeve periodike vjetore të frekuencave, sipas përcaktimeve të mësipërme, do të shqyrtojë dhe verifikojë të dhënat që do të paraqiten çdo muaj shkurt, në raportin e operatorëve celularë për mbulimin dhe cilësinë e shërbimit.

2. Kushtet e reja të mbulimit të cilësisë së shërbimeve në kuadrin e rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e brezave 900 dhe 1800 MHz

Në kuadrin e rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e brezave 900 MHz dhe 1800 MHz, AKEP ka vendosur kushte të reja që synojnë përmirësimin e mbulimit dhe cilësisë së shërbimeve të komunikimeve elektronike. Këto kushte janë pjesë e një strategjie më të gjerë për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të rrjeteve celulare në përputhje me standardet evropiane.

Qëllimi i kushteve të reja lidhet ngushtësisht me *sigurimin e shërbimeve* të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë në të gjithë territorin kombëtar, *rritjen e aksesit* në rrjetet celulare në zonat e thella,

rurale apo me interes strategjik (përfshirë rrugët nacionale) si *dhe rritjen e konkurrencës* dhe trajtimin të barabartë të operatorëve në përdorimin e spektrit.

Kërkesat e mbulimit gjeografik

Operatorët që përfitojnë autorizim të brezave 900/1800 MHz janë të detyruar të:

- Sigurojnë mbulim të shërbimit celular në të gjithë territorin e banuar deri në një përqindje të caktuar (zakonisht $\geq 95\%$);
- Të mbulojnë autostradat dhe rrugët kryesore me shërbim cilësor;
- Të investojnë për zgjerimin e rrjetit në zona të papërfshira më parë, duke pasur parasysh edhe interesin publik.

Kërkesat për cilësinë e shërbimit

Vendosja e parametrave teknikë të detyrueshëm si:

- Shpejtësia minimale e aksesit në internet për përdoruesit fundorë;
- Vonesa mesatare e komunikimit (latency);
- Cilësia e zërit (MOS – Mean Opinion Score);
- Shkalla e ndërprerjeve dhe rikuperimi i shërbimit.

Raportimi dhe transparencja

Operatorët janë të detyruar të dorëzojnë raporte periodike teknike për mbulimin dhe performancën. AKEP ka të drejtë të monitorojë në terren dhe të vendosë masa ndëshkuese në rast mosrespektimi të kushteve. Këto të dhëna janë pjesërisht të publikueshme për të siguruar transparencë ndaj publikut dhe institucioneve shtetërore.

Ndikimi i kushteve të reja lidhet kryesisht me rritjen e ndjeshme të mbulimit celular, veçanërisht në zonat me interes të lartë publik, në përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së internetit mobil, duke përfshirë shërbime më të mira video, zë dhe të dhëna, investime të reja teknologjike nga operatorët si dhe përshtatje me kuadrin rregullator evropian, përfshirë direktivat e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC).


3. Adresimi i problematikave të interferencave nga vendet fqinje

Duke marrë në konsideratë shqetësimin e përdoruesve të telefonisë së lëvizshme mbi prezencën e valëve të telefonisë së operatorëve të Greqisë, gjatë muajit korrik të vitit 2024 janë realizuar monitorime, pasi në këtë periudhë edhe numri i përdoruesve është shumë i lartë.

Bazuar në monitorimet e realizuara të nivelit të sinjalit të teknologjive GSM, UMTS, LTE të operatorëve të telefonisë së lëvizshme të Republikës së Greqisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, krahasuar me monitorimin e vitit 2021, edhe pse konstatohet rënie të nivelit të sinjalit GSM, UMTS këto nivele sinjali janë të konsiderueshme.

Ashtu si dhe për monitorimet e vitit 2021, AKEP i ka dërguar shkresë dhe raportin përkatës Rregullatorit të Republikës Greke. Theksojmë se midis AKEP dhe EETT (Rregullatorit të Republikës së Greqisë) nuk ka marrëveshje bashkëpunimi.

Figura 25. Pamje të aksit rrugor të realizimit të monitorimit ndërkufitar



4. Veprimtaria e Inspektimit

Me qëllim ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor, veçanërisht lidhur me zbatimin e kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm dhënë subjekteve ofrues të shërbimeve publike, AKEP kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve postare.

Në Planin Vjetor të Inspektimit për subjektet e komunikimeve elektronike ishin planifikuar të inspektoheshin 63 (gjashtëdhjetë e tre) sipërmarrës të komunikimeve elektronike si dhe 8 (tetë) (tetë) regjistrarët e domaineve që operojnë në treg. Aktualisht rezulton se gjatë vitit 2024 u përfundua procedura inspektuese për 63 sipërmarrësit e planifikuar si dhe për 8 (tetë) regjistrarët e planifikuar.

Në planin vjetor të inspektimit për vitin 2024 ishin programuar të inspektohen të gjithë subjektet që ofrojnë shërbime postare të regjistruar në Regjistrin e Shërbimeve Postare, pra 25 (njëzet e pesë) subjekte dhe në përfundim të vitit 2024 u arrit të realizohej inspektimi i të gjithë subjekteve.

Inspektime të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike

Gjatë vitit 2024, në përfundim të inspektimeve të programuara krahas rekomandimeve të lëna apo edhe masave administrative kryesore ndaj subjekteve tek të cilat u konstatuan shkelje të kërkesave ligjore, u vendosën edhe masa administrative, gjithsej 21 (njëzet e një) masa administrative “gjobë”.

Krahas inspektimeve të programuara në terren, struktura përgjegjëse inspektuese e AKEP-it realizoi inspektime në distancë, duke verifikuar në bashkëpunim me strukturat e tjerë të AKEP-it të gjithë subjektet që operojnë në treg. Me përfundimin e procedurës inspektuese në distancë, ndaj 14 (katërbëdhjetë) sipërmarrësve të komunikimeve elektronike u vendosën masat administrative “Gjobë” si dhe dënime plotësuese në formë rekomandimi.

Për subjektet (PMR, anije detare, persona fizikë etj.) të cilët nuk kanë kryer pagesat në institucionin e AKEP-it (përdorim frekuencash, numeracion, lidhje fikse) sipas afateve të përcaktuara në ligj, për 5 (pesë) subjekte është vendosur masa administrative “gjobë”.

Gjatë vitit 2024, institucioni i AKEP-it ka vijuar bashkëpunimin me AMA-n dhe janë realizuar inspektime të përbashkëta tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, aktiviteti i të cilëve është objekt inspektimi nga institucioni i AKEP dhe AMA.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, AKEP-i ndërmori një fushatë për të luftuar piraterinë *online* dhe për të bllokuar faqet e internetit që ofrojnë përmbajtje të paligjshme. Kjo nismë ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe përmirësimin e sigurisë kibernetike në vend.

Bazuar në Autorizimin e inspektimit nr. 1929 prot., datë 19.9.2024, strukturat e AKEP inspektuan gjatë muajve tetor - nëntor të vitit 2024, rreth 70 sipërmarrës të komunikimeve elektronike aktivë në Regjistrin e Përgjithshëm të Sipërmarrësve me shtrirje gjeografike në bashkitë Tiranë, Durrës, Shkodër, Përrenjas, Librazhd, Pogradec, Maliq, Korçë, Peqin, Rrogozhinë, Lushnje, Fier dhe Durrës.

Në përfundim, rezultatet e inspektimit përfshijnë:

- 13 masa administrative (gjobë) të ndërmarra kundër subjekteve që shkelin legjislacionin në fuqi për të drejtat e autorit dhe ofrojnë përmbajtje të paligjshme.
- Bllokimin e menjëhershëm të faqeve të paligjshme që transmetojnë materiale të mbrojtura nga të drejtat e autorit, përfshirë filma, seriale, muzikë dhe transmetime sportive.
- Rritjen e ndërgjegjësimit publik, duke njoftuar qytetarët dhe kompanitë mbi pasojat ligjore të konsumimit ose shpërndarjes së përmbajtjes pa të drejtë transmetimi.
- Përditësimin dhe publikimin e listës së domaineve të cilët duhet të jenë të bllokuar nga sipërmarrësit.

Inspektime të sipërmarrësve Ofrues të Shërbimeve Postare

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 25 inspektime të programuara tek ofruesit e shërbimeve postare, duke realizuar në këtë mënyrë 100% të planit vjetor.

Bazuar në Rregulloren nr. 45, datë 27.10.2016, “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve Postare” objektivi është që çdo ofrues i shërbimit postar i regjistruar në data bazë të inspektohet minimalisht jo më pak se 1 herë në vit.

Gjatë inspektimeve të programuara u konstatua se:

- 2 (dy) ofrues të shërbimeve postare janë çregjistruar nga Regjistri i Autorizimit të Përgjithshëm;
- 10 (dhjetë) ofrues të shërbimeve postare kanë zbatuar pjesërisht kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm, ndaj tyre janë vendosur dënime plotësuese në formën e rekomandimeve me afate kohore respektive për plotësimin e tyre sipas ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”;

- 1 (një) ofrues i shërbimeve postare ka rezultuar përgjegjës për moskorrigjim të parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 46/2015 dhe është ndëshkuar me masë administrative “Gjobë”.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 u realizua edhe një inspektim rastësor si dhe inspektimi në distancë i të gjithë ofruesve të shërbimeve postare.

Gjatë procedurës inspektuese në distancë u identifikua plotësimi i detyrimeve rregullatore tek të gjithë ofruesit e shërbimeve postare si dhe në përfundim rezultoi se pothuajse të gjithë subjektet e inspektuara përmbushnin detyrimet rregullatore të AKEP.

Inspektim tek Ofruesi i Shërbimit Universal Postar

Bazuar në Rregulloren nr. 45, datë 27.10.2016, u krye edhe inspektimi i ofruesit të shërbimit Universal Postar, “Posta Shqiptare” sh.a., me objekt verifikimin e zbatimit të kushteve të autorizimit individual, si dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm.

Në përfundim të procedurave inspektuese është vlerësuar vullneti dhe hapat konkretë të ndërmarra nga ofruesi i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” sh.a., në plotësimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme dhe rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Gjithsesi, është konstatuar se për plotësimin e kërkesave të nenit 31 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe rregullores nr. 41, datë 3.3.2016, “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të Shërbimit Universal Postar”, nga ky subjekt kërkohet angazhim i mëtijshëm, rritje e investimeve në fushën teknologjike deri në përmbushjen plotësisht të këtij rekomandimi.

Lidhur me masat për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të Shërbimit Universal Postar, “Posta Shqiptare” sh.a., procesi është në vijim.

Inspektimi në terren dhe distancë me objekt luftën kundër informalitetit

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit të AKEP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, strukturat inspektuese të AKEP-it gjatë muajit shkurt 2024 realizuan inspektim në terren dhe distancë për disa subjekte, të cilët rezultojnë të kryenin shërbim postar pa marrë autorizim në AKEP dhe të paregjistruar në regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Postare. Janë monitoruar reklamat e ndryshme kryesisht në rrjetet sociale dhe është kryer inspektim në subjektet ofrues të shërbimit postar.


Në përfundim të kësaj procedure rezultoi se 3 (tre) nga faqet u mbyllën, pasi pretendonin se nuk ofronin shërbim postar dhe ishin hapur për testim tregu dhe 6 (gjashtë) raste janë referuar tek organi i prokurorisë.

Këto fushata evidentuese do të vijojnë të kryhen në mënyrë periodike, por edhe rast pas rasti, bazuar në ankesat që do të paraqiten.

Edhe gjatë inspektimeve të programuara, vëmendje e veçantë i është kushtuar verifikimit të zbatimit të kushteve të autorizimit të përgjithshëm, duke u siguruar që të mos ketë shkelje si në zonën e ofrimit të shërbimeve, edhe në llojet e shërbimeve të ofruara. Njëkohësisht janë kryer

verifikime faktike në sistemet e subjekteve mbi të dhënat e regjistruara përkundrejt vlerave të deklaruara në raportimet periodike për t'u siguruar mbi saktësinë e tyre.

Në fokus të veprimtarisë së AKEP-it do të vijojë thellimi i luftës kundër informalitetit në bashkëpunim edhe me institucione të tjera ligjzbatuese, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në përmbushjen e rregullave dhe standardeve ligjore të vendosura.



VI. SFIDAT E QËNDRUESHMËRISË SË SIGURISË DHE INTEGRITETIT TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE NË SEKTORËT E TELEFONISË SË LËVIZSHME DHE FIKS/BROADBAND

Një kuadër ligjor kompleks dhe evolutiv në fushën e sigurisë kibernetike dhe atë të rrjeteve të komunikimeve elektronike

Në mars 2024, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 25/2024, “Për Sigurinë Kibernetike”, i përafuar pjesërisht me direktivën (BE) nr. 2022/2555, të Parlamentit dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, “Mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian” (Direktiva NIS 2).

Shqipëria ishte një ndër 5 vendet e para evropiane, përpara shumicës së anëtarëve të BE-së, që miratoi Direktivën NIS 2. Krahas reformave dhe masave të tjera administrative, teknologjike, financiare dhe në burime njerëzore, Shqipëria shënoi një përparim domethënës në Indeksin Global të Sigurisë Kibernetike të ITU-së për vitin 2024, duke u klasifikuar në nivelin e dytë të vendeve në avancim, midis 5 kategorive. Neni 11 i ligjit nr. 25/2024 e rendit AKEP-in si një ndër subjektet e tjera përgjegjëse, krahas AKSK-së, për sigurinë kibernetike.

Roli dhe përgjegjësitë e AKEP-it për sigurinë e rrjeteve dhe në fushën kibernetike mund të perceptohen dhe trajtohen në së paku 4-5 pikëpamje.

Së pari, përgjegjësia e AKEP-it për sigurinë kibernetike lidhet me sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit që vetë AKEP-i operon.

Përmes VKM nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, AKEP-i u konsiderua për herë të parë si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit (vendimi i mëparshëm nr. 222, datë 26.4.2018, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit” nuk përfshinte ndonjë sistem të operuar nga AKEP si kritik apo të rëndësishëm).

Në sektorin e infrastrukturës digjitale u identifikuan 4 sisteme kritike (Sistemi i Menaxhimit Cctld.AI, Sistemi i Bazës së të Dhënave të Centralizuar të Probabilitetit të Numrit (Crdb), Sistemi i menaxhimit të Aplikimeve dhe Raportimeve Online (RevZone) dhe Sistemi i menaxhimit/monitorimit të Frekuencave) dhe 1 sistem i rëndësishëm (Regjistri Elektronik i Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (Atlas)).

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, me anë të VKM nr. 761, datë 12.12.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 553, datë 15.7.2020”, Këshilli i Ministrave ka zgjeruar në mënyrë domethënëse gamën e sistemeve kritike dhe të rëndësishme në sektorin e infrastrukturës digjitale. Megjithatë, sa i përket AKEP-it, i vetmi ndryshim është që Sistemi i Përqendruar i Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike është riklasifikuar si sistem kritik, nga sistem i rëndësishëm që ishte deri më përpara. Si operator i këtyre infrastrukturave kritike, AKEP-it i lindin në bazë të një ligjit një sërë detyrash dhe përgjegjësish.

Së dyti, përgjegjësitë e AKEP-it në këtë fushë kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike. Sipas nenit 54, par. 3, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në RSH”, “*Ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun njoftojnë pa vonesë AKEP-in dhe autoritetin përgjegjës për sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë për incidentin e sigurisë kibernetike, që ka ndikuar në funksionimin e rrjeteve, sistemeve ose shërbimeve.*” AKEP-i gjithashtu ka detyrimin të njoftojë AKSK-në për incidentet e sigurisë kibernetike të konstatuara në sektorin e komunikimeve elektronike.

Neni 15, par. 5, i ligjit nr. 25/2024 parasheh se “*mënyra e ngritjes së CSIRT-eve sektoriale përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave*”. Këto VKM pritet të miratohen brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 25/2024. Nëse kuadri i ri nënligjor do ta ngarkojë AKEP-in me detyra të mëtejshme në fushën e sigurisë kibernetike, është një çështje në trajtim e sipër. Krahas aspekteve ligjore dhe të bashkërendimit institucional, pikë kyçe për t’u zgjidhur është eventualisht mënyra dhe niveli i financimit të këtyre misioneve të reja, që dalin jashtë kuadrit të përgjegjësiave rregullatore në fushën e telekomunikacioneve dhe shërbimeve postare.


Së treti, në fushën e sigurisë së rrjeteve, AKEP-i mbikëqyr zbatimin e nenit 54 të këtij ligji dhe me rregullore detajon masat teknike dhe organizative të sigurisë, sipas pikës 1, të nenit 54, për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun. AKEP-i bashkëpunon me autoritetin përgjegjës për sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë për miratimin e udhëzimeve detyruese, përfshirë masat e nevojshme për korrigjimin e një incidenti sigurie ose parandalimin e tij nga ndonjë rrezik edhe nëse implementimi është në limitet e kohës tek ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të komunikimit elektronik, të disponueshme publikisht.

Është për t’u shënuar se, në zbatim të ligjit nr. 25/2024, ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun (pjesë e infrastrukturave digjitale) janë përfshirë në sektorët me kritikalitet të lartë. Pandemia e COVID-19 demonstroi se konektiviteti është thelbësor që individët të punojnë, të mësojnë, të tregtojnë dhe të komunikojnë. Ndërprerja e telekomunikacionit ka një efekt përhapës në sektorë të tjerë kritikë, të cilët varen shumë nga disponueshmëria e telekomunikacionit, si qasja në shërbimet e urgjencës dhe sistemet e paralajmërimit publik, pagesat digjitale, furnizimi me energji dhe transporti publik, shërbimet e shitjes me pakicë etj.

Së katërti, siguria është e lidhur me garancitë dhe sigurinë e furnizuesve dhe ofruesve të rrjetit në kuptim të nenit 55, të ligjit nr. 54/2024. Kjo dispozitë përbën një zberthim dhe ankorim ligjor të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për sigurinë 4G dhe 5G, nënshkruar në Bruksel më 13 qershor 2021 dhe ratifikuar me VKM nr. 398, datë 30 qershor 2021.

Një nga manifestimet më elokvente të këtij kuadri normativ ishte përfshirja në autorizimet individuale të akorduara sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, ndërmjet detyrimeve dhe kushteve të tjera, i kësaj klauzole:

“Sipërmarrësi duhet të zbatojë masa teknike dhe organizative, për të realizuar rrjete të sigurta e të besueshme, në të gjithë komponentët e tyre, bazuar në kërkesa dhe standarde në të cilat është angazhuar Republika e Shqipërisë”.



VII. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL DHE RAPORTIME NDËRKOMBËTARE

1. Bashkëpunim në nivel kombëtar

AKEP, rast pas rasti mbi çdo praktikë shkresore të adresuar për këtë qëllim ka bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës (në vijim, AK) në vijim të praktikave të mëparshme, si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për këtë qëllim. AKEP ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet në tregun e telefonisë celulare, veçanërisht njoftimet e planeve tarifore të ofruara në tregun e pakicës dhe ka informuar Autoritetin e Konkurrencës mbi çmimet dhe përmbajtjen e këtyre planeve. Një praktikë e tillë do të vijojë të ndiqet edhe në kuadër të ndryshimeve të reja rregullatore, ku tashmë, me miratimin e ligjit të ri të komunikimeve elektronike nr. 54/2024, AKEP mund të ndërhyjë edhe në rregullimin e tregut të pakicës.

AKEP ka një rol të rëndësishëm në garantimin e sigurisë kibernetike të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, për arsye të mbikëqyrjes sistematike që ushtron mbi implementimin dhe respektimin e standardeve të sigurisë nga sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Në këtë kuadër, bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) ka qenë i ngushtë si në aspektin parandalues, ashtu edhe në aspektin e mitigimit të incidenteve kibernetike. Në shumë raste ky bashkëpunim është shtrirë edhe te sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare. Komunikimi ndërmjet dy autoriteteve ka qenë dhe vazhdon të jetë i përditshëm, bazuar në shkëmbime informacioni, por edhe në asistencë të ndërsjellë teknike. AKEP-i ka vijuar të ketë komunikim me të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, për të evidentuar problematikat e mundshme dhe për t'i paraprirë incidenteve të mundshme kibernetike në sektorin e komunikimeve elektronike. Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur asnjë incident kibernetik të raportuar nga ana e sipërmarrësve.

AKEP e ka mbështetur AKSK-në në lidhje me bllokimin nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të Domain-eve dhe IP-ve me përmbajtje të dëmshme. Dihet fakti se në shumicën e rasteve, ndërhyrja e AKEP ka qenë vendimtare në mitigimin e sulmeve kibernetike si në infrastruktura publike, ashtu edhe në infrastruktura private që garantojnë shërbime publike për qytetarët. Gjatë vitit 2024, rastet më të shpeshta të cilat vlen të përmenden kanë qenë tentativat “*phishing*” me qëllim marrjen e të dhënave personale të përdoruesve apo mashtrimin financiar. Specifikisht, tentativat e vazhdueshme nëpërmjet faqeve mashtruese sikur të jenë Posta Shqiptare, apo banka të nivelit të dytë.

2. Procesi i integritimit dhe raportimit në BE

AKEP i kushton një rëndësi të veçantë procesit të integritimit në Bashkimin Evropian, dhe nëpërmjet strukturave të tij është i angazhuar në një sërë kapitujsh që lidhen me komunikimet elektronike dhe ofrimin e shërbimeve postare. Më konkretisht, ekspertët e AKEP kanë raportuar dhe kanë marrë pjesë në takimet dhe trajnimet e organizuara për:

Kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”, i cili udhëhiqet dhe bashkëdrejtohet nga Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë, dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit; Kapitullin 1, “Lëvizja e lirë e mallrave”, Kapitullin 3, “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”, që kryesohen dhe udhëhiqen nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; Kapitullin 8, “Politika e Konkurrencës”, i cili udhëhiqet nga Autoriteti i Konkurrencës” si dhe kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe shëndetit publik”.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

AKEP ka vijuar angazhimin dhe pjesëmarrjen në grupet e punës për zbatimin e marrëveshjeve të *roaming* në vendet e BP dhe BE. Reduktimi i tarifave për ofrimin e shërbimeve të komunikimit mobile për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në vendet e rajonit dhe më gjerë në BE, ka qenë në fokus të qeverisë shqiptare gjatë këtyre viteve. Në kuadër të këtij procesi, në dhjetor 2024 u zhvillua në Zagreb, Kroaci, takimi i përbashkët i Grupit Koordinator Këshillimor dhe Grupeve të punës për politikën e *roaming*-ut, *broadband* dhe 5G, takim në të cilin u mblodhën së bashku përfaqësues të Komisionit Evropian, BEREC, RCC, ministrive të linjës për ICT, Autoriteteve Rregullatore të 6 (gjashtë) vendeve të BP dhe operatorëve të shërbimeve mobile.

Gjatë vitit 2024, AKEP ka marrë pjesë aktive në aktivitetet dhe takimet e punës të organizuara nga CEFTA, në funksion të harmonizimit të legjislacionit të vendeve të CEFTA me legjislacionin e BE-së në fushën e shërbimit të dorëzimit të pakove postare ndërkufitare me qëllim promovimin e bashkëpunimit rajonal për nxitjen e tregtisë elektronike nëpërmjet lehtësimit të barrierave për ofrimin e shërbimeve postare ndërkufitare, si edhe rritjen e transparencës mbi tarifën që aplikojnë ofruesit e shërbimeve postare ndërkufitare.

AKEP gjatë periudhës raportuese ka bashkëpunuar me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU). Falë këtij bashkëpunimi, AKEP ka përfituar dy dokumente që i shërbejnë përmbushjes së misioneve rregullatore: Specifikime teknike për Sistemin e Përqendruar të Informacionit (SPI) – ATLAS dhe për Upgrade të Sistemit të Monitorimit të Frekuencave.

3.1 Sistemi i Përqendruar i Informacionit (SPI) – ATLAS

ATLAS është një sistem gjeo të dhënash, për të gjithë komponentët e rrjeteve të komunikimeve elektronike, i cili popullohet me të dhënat e vetdeklaruar nga sipërmarrësit çdo 90 ditë, si rrjedhim i detyrimeve të Rregullores 26, “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në republikën e Shqipërisë”.

Nga bashkëpunimi me ekspertët e ITU-së është arritur në konceptimin e modelit të ardhshëm të ATLAS-it, i cili synon të adresojë të gjitha problematikat aktuale. Pritet gjithashtu që ky version të ofrojë më shumë funksionalitete, të cilat do të japin mundësinë që ATLAS-i të kthehet në një sistem të kompletuar gjeodatash të sakta dhe të jetë i aftë të gjenerojë raporte e statistika të dobishme në kohë reale.

Problematikat që adresohen:

- Menaxhim më i thjeshtë i sistemit;
- Gjenerim i automatizuar i raporteve për statusin e përditësimeve të rrjetit;
- Krijim i një datamodel-i të ri, i cili garanton me saktësi vlefshmërinë e të dhënave;

- Mundësimi e ofrimit të të dhënave që nga Backbone, deri te linjat e abonentëve brenda banesave (*last mile*);
- Ofrim i të dhënave për rrjetet e ofruara me qira;
- Ofrim i të dhënave për cilësinë e shërbimit;
- Ofrim i të dhënave për zonat e mbulimit.

Referuar dokumentit final të përpiluar nga ekspertët e ITU-s është kryer edhe një studim për kostot financiare të projektit duke patur parasysh të gjithë komponentët e infrastrukturës së re, si pjesa e harduerike e serverave, zhvillimin e aplikacionit, garantimin e kushteve teknike për sigurinë kibernetike.

3.2 Sistemi i Monitorimit të Frekuencave

Raporti i përgatitur nga eksperti i ITU-s paraqet gjetjet e një analize të thelluar të rrjetit aktual të monitorimit të AKEP-it. Analiza ka identifikuar përmirësimet më të përshtatshme për të mundësuar përmbushjen nga AKEP të misionit për menaxhimin e spektrit.

Dokumenti përbëhet nga katër pjesë.

- Pjesa I fokusohet në gjendjen aktuale të sistemit të monitorimit të spektrit dhe në hartimin e rrjetit të monitorimit;
- Pjesa II ofron seksionin teknik për dokumentin e tenderit, duke përfshirë specifikimet e detajuara për sistemin e propozuar të monitorimit;
- Pjesa III përshkruan specifikimet e shërbimit dhe
- Pjesa IV mbulon trajnimin e nevojshëm.

Realizimi i këtyre investimeve mjaft të rëndësishme është i kushtëzuar nga siguri i mjeteve financiare të nevojshme, të cilat nuk është e mundur të mobilizohen në kuadrin aktual të të ardhurave dhe shpenzimeve të AKEP-it.

Raportim të dhënash

Në kuadër të angazhimeve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, AKEP ka përcjellë informacionet respektivisht:

Pranë strukturave të ITU plotësim i të dhënave të treguesve vjetorë të tregut lidhur me numrin e përdoruesve dhe ecurisë së volumeve dhe shërbimeve që ofruarit e komunikimeve elektronike ofrojnë në Shqipëri. Gjithashtu, është përcjellë informacion mbi planet tarifore të ofruara nga sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike për shportat përfaqësuese të cilat mundësojnë ofrim shërbimi të përbalueshëm për konsumatorët fundorë (ICT price basket).

Pranë strukturave të BEREC dhe RCC është përcjellë informacion statistikor lidhur me ecurinë e shërbimeve *roaming* në rajon dhe zgjerimin e këtij procesi edhe midis rajonit dhe vendeve të BE-së, në funksion të arritjes së objektivit për reduktimin deri në heqjen e plotë të tarifave të shërbimit të *roaming* me këto vende.

Raportime të tjera pranë institucioneve kombëtare MIE, INSTAT, MFE, etj.

VIII. MIRADMINISTRIMI FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

1. Të ardhurat sipas burimeve të financimit në vitin 2024

AKEP, si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të veta. Gjatë vitit raportues, përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit, si dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit të këtyre burimeve, ka qenë një ndër objektivat e realizuara gjatë vitit 2024 .

Bazuar në dispozitat ligjore, pagesat që kryhen nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, janë si më poshtë:

- Pagesa për caktim dhe përdorim të frekuencave;
- Pagesa për numeracion;
- Pagesa për mbikëqyrje tregu;
- Pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit;
- Pagesa për domain;
- Komisioni i përfituar si agjent tatimor.

AKEP, në zbatim të VKM nr. 750, datë 1.12.2023, “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare për vitin 2024”, administroi dhe menaxhoi fondet publike për vitin 2024 në një fond shpenzimesh prej 391.5 milionë lekë. Gjatë vitit 2024 janë realizuar të ardhurat nga pagesat e kryera prej sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare:

Pagesat dhe komisioni i përfituar si agjent tatimor për AKEP-in gjatë vitit 2024 paraqiten si më poshtë:

PAGESAT PËR AKEP

Emërtimi	Njësia	Buxheti për Vitin 2024*	Realizimi 2024	%e realizimit
Pagesa nga mbikqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	lekë	178,000,000	177,961,216	100%
Pagesat për caktim dhe përdorimin të frekuencave	lekë	111,800,000	108,605,787	97%
Pagesa për Numeracion	lekë	26,500,000	25,482,165	96%
Pagese per koston e shërbimit te portabilitetit te numrit	lekë	31,600,000	31,599,999	100%
Pagesa nga mbikqyrja e tregut të shërbimit postar	lekë	12,000,000	12,028,335	100%
Pagesa për Domain	lekë	9,500,000	11,445,333	120%
Pagesa dhe të ardhura të tjera	lekë	100,000	160,614	161%
Komision nga agjenti tatimor	lekë	23,500,000	24,229,562	103%
TOTALI	lekë	393,000,000	391,513,011	100%

Në total janë faturuar rreth 391.50 milionë lekë, ose rreth 99.60% e buxhetit dhe janë arkëtuar rreth 390.70 milionë lekë, ose rreth 99.8% e faturimit.

Krahasuar me një vit më parë, janë faturuar rreth 6% më shumë dhe arkëtuar rreth 7% më shumë fonde. Përgjatë vitit 2024 nuk ka patur rishikime buxhetore.

Dinamika e pagesave për AKEP në harkun kohor 2016-2024 jepet në tabelën më poshtë, ku vihet re se vlera e pagesave për vitin 2024 është rritur me 21.4 milionë lekë më shumë se një vit më parë.

Pagesat për AKEP ndër vite

VITE	në milion lekë								
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Programi I pagesave per AKEP	318.57	363.02	388.68	378.36	384.76	392	384.7	381.5	393
Realizimi I pagesave per AKEP	335.16	357.58	360.7	377.81	380.81	381	374.6	370.1	391.5
% e realizimit tepagesave per AKEP ndaj programit per AKEP	105%	99%	93%	100%	99%	97%	97%	97%	100%

Gjatë vitit 2024, AKEP ka llogaritur dhe dërguar faturat fiskale për vjeljen e detyrimeve të pagesave për AKEP për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe gjatë gjithë vitit ka ndjekur shlyerjen e detyrimeve nën një monitorim të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse të AKEP. Kështu, në përfundim të vitit 2024, nga 1,338 faturime në vlerën e 391.50 milionë lekë, rezultuan të pashlyera detyrimet e 9 subjekteve sipërmarrëse në masën 0.2% të totalit të faturimeve, ku 6 prej tyre likuiduan përgjatë muajit janar të vitit 2025. Aktualisht nga viti 2024 rezultojnë të palikuiduar vetëm 3 sipërmarrës debitorë në vlerë 131 mijë lekë.

Gjatë vitit raportues, AKEP ka vendosur 42 gjoba në vlerë rreth 2 milionë lekë, nga të cilat janë paguar 33 gjoba në vlerë rreth 1.5 milionë lekë, si dhe janë arkëtuar gjoba të viteve të mëparshme në vlerë 10.6 milionë lekë, të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit.

2. Zbatimi i buxhetit të institucionit

Realizimi i fondit të shpenzimeve për vitin 2024

AKEP, në zbatim të VKM nr. 750, datë 1.12.2023, administroi dhe menaxhoi fondet publike për vitin 2024, në një fond shpenzimesh prej 391.5 milionë lekë sipas zërave të mëposhtëm:

Paga dhe shtesa të tjera	151.709.114 lekë
Kontributet e sig. shoqërore e shëndetësore	18,889,516 lekë
Materiale	6,942,338 lekë
Shërbime	162,493,007 lekë
Investime	47,846,190 lekë
Total	387,880,165 lekë

Gjatë vitit 2024 janë realizuar në total rreth 99% e fondit të shpenzimeve administrative të AKEP, ose rreth 387.9 milionë lekë. Realizimi i fondit të shpenzimeve për vitin 2024 ka pësuar

një rritje me 18.7 milionë lekë në krahasim me vitin 2023, ku fondi i shpenzimeve ishte realizuar në 369.2 milionë lekë.

Realizimi i shpenzimeve

Totali i shpenzimeve të AKEP-it për vitin 2024 në terma nominale është 389.9 milionë lekë nga rreth 393 milionë lekë të parashikuara dhe miratuara ose e shprehur në përqindje rreth 98.7% e programit. Po t'i referohemi realizimit të një viti më parë në 369.1 milionë lekë mund të shprehemi së shpenzimet janë realizuar në rreth 20.8 milionë lekë më shumë. Diferenca midis faktit dhe programit për vitin 2024, vjen si rrjedhojë e mosrealizimit të shpenzimeve të planifikuara për zërin “sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” si dhe nga mosrealizimi i disa zërave të shpenzimeve për materiale.

Struktura e shpenzimeve sipas zërave kryesorë të miratuar për periudhën 2020-2024 ka pasur trendin që paraqitet në figurën më poshtë:



Shpenzimet për pagat

Gjatë vitit 2024, shpenzimet për pagat dhe shtesa janë realizuar në masën 98% të programit. Në këtë nivel kanë ndikuar vakancat në strukturën e miratuar në program, lëvizjet e stafit si dhe zbatimi i Vendimeve të Këshillit të Ministrave për kufizimin e shpenzimeve për shpërblimet e performancës për administratën.

Nga të gjitha këto ndryshime, zëri i fondit të shpenzimeve për pagat ka ndryshuar dhe është realizuar si më poshtë:

SHPENZIME PER PAGA, SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE

Emërtimi	Njësia	Buxheti për Vitin 2024*	Realizimi 2024	% realizimit
Paga dhe shtesa të tjera	lekë	137,961,913	137,609,114	100%
Sigurime shoqërore e shëndetësore	lekë	21,502,147	18,889,516	88%
Shperblime nga komision si agjent tatimor	lekë	14,100,000	14,100,000	100%
TOTALI	lekë	173,564,060	170,598,630	98%

Shpenzime për materialet

Gjatë vitit 2024, shpenzimet për materiale janë realizuar me 6.94 milionë lekë, ose në masën 77.1 % të programit. Nga materialet nuk u arritën të përdoren rreth 2 milionë lekë, si rezultat i kursimit të realizuar në procesin e prokurimit, si dhe kontraktimit me vonesë të kontratës së kancelarive dhe bojë printeri dhe fotokopje.

SHPENZIME MATERIALE

Emërtimi	Njësia	Buxheti për Vitin 2024*	Realizimi 2024	% realizimit
Kancelari	lekë	900,000	734,604	82%
Karburante	lekë	2,800,000	2,361,850	84%
Pjesë këmbimi për automjete	lekë	1,000,000	1,000,000	100%
Goma dhe bateri	lekë	530,000	528,380	100%
Bojë printeri dhe fotokopje	lekë	1,500,000	193,950	13%
Materiale pastrimi	lekë	560,000	559,314	100%
Materiale te tjera	lekë	1,710,000	1,564,240	91%
TOTALI	lekë	9,000,000	6,942,338	77%

Shpenzime për shërbime

Zëri i shpenzimeve për shërbime u realizua në shumën 162.5 milionë lekë, ose në masën 99.9% të programit. Gjatë vitit 2024 janë kryer disa rishpërndarje bazuar në limitet që përcaktojnë aktet ligjore, duke pasur parasysh nevojën për rritjen e sigurisë kibernetike në AKEP. Më poshtë paraqitet një pamje më e detajuar për zërin shpenzime për shërbime.

SHPENZIME PËR SHËRBIME

Emërtimi	Njësia	Buxheti për Vitin 2024*	Realizimi 2024	%e realizimit
Shërbime Bazë	lekë	5,735,000	5,716,968	99.7%
Auto - Transporti	lekë	2,950,000	2,899,230	98.3%
Udhëtim e Dieta dhe kualifikim stafi	lekë	5,950,000	5,945,559	99.9%
Shpenzime per mirëmbajtjen e infrastruktures dhe te platformave teknologjike	lekë	102,231,500	102,216,238	100.0%
Publikime dhe Njoftime	lekë	191,000	190,169	99.6%
Social Kulturore - Pritje përcjellje	lekë	606,873	602,175	99.2%
Kuotizacione në org. ndërkomb.	lekë	1,557,620	1,552,829	99.7%
Shpenzime të tjera	lekë	19,524,960	19,533,208	100.0%
Shpenzime qeraje për ambiente pune per administraten dhe per stacionet e monitorimit	lekë	23,842,797	23,836,631	100.0%
TOTALI	lekë	162,589,750	162,493,007	99.9%

Investimet**SHPENZIME PËR INVESTIME**

Emërtimi	Njësia	Buxheti për Vitin 2024*	Realizimi 2024	%e realizimit
Rinovim i struktures Name server dhe sistemi menaxhimit te tyre	lekë	13,618,190.00	13,618,190.00	100.0%
Secutiry information and event management (SIEM)	lekë	11,820,000.00	11,820,000.00	100.0%
Zhvillim i sistemit kombetar te monitorimit te frekuecave nje sistem kompakt monit dhe sistem informativ per perp e te dhenave te monitoritmit	lekë	22,408,000.00	22,408,000.00	100.0%
TOTAL	lekë	47,846,190.00	47,846,190.00	100.0%

Duke u bazuar në fondin e miratuar për t'u investuar, zëri i investimeve u realizua në masën 100%.

Lidhur me zërin e investimeve sqarojmë se:

- Janë kryer të gjitha investimet e programuara për vitin 2024;
- Janë kryer me sukses të gjitha procedurat e prokurimit, duke u lidhur kontrata me operatorët ekonomik fitues;
- Ka pasur miradministrim dhe transparencë në menaxhimin e fondeve, duke kryer rishpërndarje brenda limiteve ligjore.

Gjatë vitit 2024, ka vijuar të zhvillohet infrastruktura e teknologjisë së informacionit si dhe përmirësime të aplikacioneve ekzistuese. AKEP ka aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit, mbështetur edhe në detyrat e caktuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe aktet nënligjore të dala.

Teprica e të ardhurave

Teprica e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në fund të vitit 2024 rezultojnë në shumën 4,461,705 lekë, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve dhe mosrealizimit/kursimit të disa zërave të miratuar në fondin e shpenzimeve të AKEP, si dhe pagesat e kryera në AKEP nga debitorët e viteve të kaluara.

Rezultati i vitit 2024, i rregulluar me veprimet rregulluese të fundvitit (teprica e akumuluar), do të mbahet në llogaritë e AKEP-it sipas dispozitave që përcakton ligji nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 17, pika 4.

3. Taksa e radiokomunikacionit

Për vitin 2024 janë arkëtuar për Buxhetin e Shtetit nga tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit rreth 484.6 milionë lekë. Nga vlera e arkëtuar, 5% është mbajtur në burim nga AKEP, sipas udhëzimit nr. 27, datë 16.12.2014 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për vitin 2024 janë derdhur në llogarinë e tatimeve rreth 460.3 milionë lekë.

Përfundimi me sukses i garës për dhënie në përdorim të brezit 3500 MHz dhe rinovimi i AI për brezin 900-1800MHz, sollën arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës prej 14,9 milionë Euro, si dhe arkëtimin e rreth 10.9 milionë lekë tarifë komunikacioni të derdhur më shumë se planifikimi për vitin 2024. Pagesat e këstit të dytë për t'u arkëtuar në Buxhetin e Shtetit në shumën e 6.8 milionë Euro do të kryhen gjatë vitit 2025, përkatësisht shuma prej 1.4 milionë deri më 30.3.2025, si dhe 5.4 milionë deri më 25.5.2025.

Pagesa për buxhetin e shtetit	900-1800 Mhz	3500 Mhz	Te Ardhura shtese nga faturimi për 2 muaj 2024 brezi 3500 MHz			
			Tarifa	AKEP Agjenti	AKEP	Totali AKEP
One Albania	€ 1,434,212.00	€ 2,718,000.00	5,080,120.00	254,006.00	1,200,000.00	1,454,006.00
Vodafone Albania	€ 8,031,589.00	€ 2,718,000.00	6,350,400.00	317,520.00	1,200,000.00	1,517,520.00
Totali sipas brezave	€ 9,465,801.00	€ 5,436,000.00	11,430,520.00	571,526.00	2,400,000.00	2,971,526.00
Totali l arketuar ne Buxhet		€ 14,901,801.00	10,858,994.00			


Të ardhurat e përfituara si agjent tatimor nga komisionet në masën 5% të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit janë në vlerën rreth 24.2 milionë lekë ose rreth 103% e planit për vitin 2024. Të ardhurat e përfituara nga komisionet si agjent tatimor janë përdorur për shpërblimin e punonjësve në vlerën 14.1 milionë lekë, 10.1 milionë lekë është përdorur për të financuar investimet, pothuajse në të njëjtat nivele si vitet e kaluara.

4. Menaxhimi i burimeve njerëzore

AKEP organizohet dhe funksionon sipas strukturës organizative miratuar me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 56/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”. Struktura organizative dhe organika e AKEP përbëhet në total nga 85 punonjës.

AKEP është i strukturuar në Këshillin Drejtues, i cili përbëhet nga pesë anëtarë dhe funksionon si organ vendimmarrës, si edhe 8 Drejtori të cilat kanë në përbërje 14 Sektorë përkatës.

Deri më 20 dhjetor 2024, punonjësit e AKEP-it janë trajtuar sipas ligjit “Për Nëpunësin Civil” dhe Kodit të Punës. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 54/2024, regjimi juridik i marrëdhënieve të punës ka ndryshuar dhe të gjithë punonjësit janë trajtuar sipas dispozitave të Kodit të Punës.



IX. DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT TË PUNËS PËR VITIN 2025

Drejtimet kryesore të programit të punës të AKEP-it për vitin 2025, në kuadër të objektivave rregullatore:

1. Plotësimi i kuadrit nënligjor përmes miratimit të rregulloreve të reja dhe përditësimit të rregulloreve ekzistuese në funksion të vënies në zbatim të kuadrit të ri ligjor për komunikimet elektronike;
2. Realizimi i analizës së tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal;
3. Miratimi i strukturës organizative, organikës dhe nivelit të trajtimit financiar të punonjësve të AKEP-it;
4. Përfundimi i procedurës për rishikimin e kuadrit rregullator të administrimit të domainit.al, si edhe garantimi i qëndrueshmërisë teknologjike dhe financiare të operimit të regjistrimit të ccTLD-së;
5. Promovimi i investimeve në rrjetet e shpejtësisë së lartë, përfshirë 5G, dhe konkurrencës efektive në treg;
6. Garantimi i integritetit dhe pacenueshmërisë së rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe infrastrukturave kritike;
7. Menaxhimi eficient i burimeve të fundme, frekuencave, numrave, serive numerike, emrat e domain;
8. Promovimi i përfitimeve të konsumatorëve dhe sigurimi i shërbimit universal të komunikimeve elektronike sipas përcaktimeve të ligjit të ri dhe përvojave në vendet e BE-së.

ANEKS 1:ÇËSHTJET GJYQËSORE KU ËSHTË PALË AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AKEP, në mungesë të shlyerjes vullnetare të detyrimeve financiare nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, ka investuar organet gjyqësore duke kërkuar prej debitorëve të shlyejnë detyrimet financiare ndaj AKEP. Po ashtu, AKEP i është drejtuar gjykatave kompetente edhe në cilësinë e palës kërkuese, sikurse është edhe rasti i paraqitjes së kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit.

AKEP gjatë vitit 2024, është përfshirë në 50 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, nga të cilat 31 kanë përfunduar dhe 19 vijojnë edhe përgjatë vitit 2025. Ndërsa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, AKEP është përfshirë në 4 procese gjyqësore, nga të cilat 3 vijojnë të jenë në proces.

Nga 31 proceset gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, të mbyllura gjatë vitit 2024 rezultojnë:

- a) 27 procese gjyqësore, AKEP në cilësinë e palës paditëse:
 - Fituar 11;
 - Humbur 6 (1 + 5 Mospranim - Ankimuar – priten për gjykim në Gjykatën e Apelit);
 - Pushuar 10;

- b) 4 procese gjyqësore, AKEP në cilësinë e palës së paditur:
 - Fituar 1;
 - Humbur 2 (Ankimuar – priten për gjykim në Gjykatën e Apelit);
 - Pushuar 1;

Nga 4 proceset gjyqësore në Gjykatën e shkallës së Parë, Juridiksioni i Përgjithshëm, 1 është fituar dhe 3 vijojnë të jenë në proces.

Përveç proceseve gjyqësore në gjykim në shkallë të parë, AKEP ka vijuar me ndjekjen e proceseve gjyqësore të cilat janë në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, çështje këto të mbartura nga vitet paraardhëse.

Në 8 çështje të humbura AKEP ka vijuar me ankimet përkatëse dhe priten për gjykim në *Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë*

ÇËSHITJE GJYQËSORE NË GJYKIM NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANE

Nr.	Paditës/I paditur	Objekti	Fituar/Humbur
1	Paditës: AKEP I paditur: Siguria sh.p.k.,	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
2	Paditës: AKEP I paditur: Gerard A sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur
3	Paditës: AKEP I paditur: Media World sh.p.k	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
4	Paditës: AKEP I paditur: Rearmour sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
5	Paditës: AKEP I paditur: Eral sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
6	Paditës: AKEP I paditur: Muça sh.r.s.f.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
7	Paditës: AKEP I paditur: Res - 03 sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushuar
8	Paditës: AKEP I paditur: Teeb Center sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
9	Paditës: AKEP I paditur: Egis-Tel sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
10	Paditës: AKEP I paditur: Jaguar sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur
11	Paditës: AKEP I paditur: Kevitan sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
12	Paditës: AKEP Paditur: Shkelzeni Agjenci sh.p.k., (2019)	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
13	Paditës: AKEP Paditur: Veneto Banka sh.a.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushuar
14	Paditës: AKEP Paditur: Grand Security sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
15	Paditës: AKEP Paditur: Merita Xhika p.f.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
16	Paditës: AKEP Paditur: Marku N sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushuar
17	Paditës: AKEP Paditur: Mark Kle Security sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
18	Paditës: AKEP Paditur: Vojvoda sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces

19	Paditës: AKEP Paditur: Nereida sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushuar
20	Paditës: AKEP Paditur: Fortesa Security sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
21	Paditës: AKEP Paditur: Eneo Security sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushuar
22	Paditës: AKEP Paditur: Plus Intermedia sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
23	Paditës: AKEP Paditur: Santi sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
24	Paditës: AKEP Paditur: Steffi sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushim
25	Paditës: AKEP Paditur: Enkleona Kondi p.f.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushim
26	Paditës: AKEP Paditur: Iral sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushim
27	Paditës: AKEP Paditur: Sajet Security sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
28	Paditës: AKEP Paditur: SA Me Security sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
29	Paditës: AKEP Paditur: MK 2015 Vision Security sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
30	Paditës: AKEP Paditur: Tirana Tel sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
31	Paditës: AKEP Paditur: LFS Albania sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushim
32	Paditës: AKEP Paditur: Jurisprudenca sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
33	Paditës: AKEP Paditur: Leksi Security sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
34	Paditës: AKEP Paditur: Sajmiri AL sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar
35	Paditës: AKEP Paditur: Sun Petroleum sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
36	Paditës: AKEP Paditur: Albania Studio sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces

37	Paditës: AKEP Paditur: Xheni AD sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
38	Paditës: AKEP Paditur: Pelikani Mondial sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Pushim
39	Paditës: AKEP Paditur: Balili & Co sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
40	Paditës: AKEP Paditur: Badriklo sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur
41	Paditës: AKEP Paditur: Goga sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur
42	Paditës: AKEP Paditur: Shkëlzeni Agjenci sh.p.k., (2022)	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur
43	Paditës: AKEP Paditur: Leksi Security 1	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur
44	Paditës: Jetmir Nikolli Paditur: AKEP	Pavlefshmëri e pjeshme Titulli Ekzekutiv	Fituar
45	Paditës: Jetmir Nikolli Paditur: AKEP	Kundërshtim veprimesh përmbartimore	Humbur
46	Paditës: Proton sh.p.k. Paditur: AKEP	Anulim fature	Në proces
47	Paditës: Safecomm sh.p.k Paditur: AKEP	Anulim fature	Humbur
48	Paditës: Afërdita Gjongecaj Paditur: AKEP	Detyrim shtesë page	Në proces
49	Paditës: AKEP Paditur: Shefqet Meda	Pavlefshmëri e pjeshme titulli ekzekutiv	Në proces
50	Paditës: Bayer AG Paditur: AKEP	Rikthim domain	Pushuar

**ÇËSHTJE GJYQËSORE NË GJYKIM NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË
JURIDIKSIONI I PËRGJTHSHMË TIRANË**

Nr.	Paditës/I paditur	Objekti	Fituar/Humbur
1	Paditës: One Albania I paditur: Everest sh.p.k. Person i tretë: AKEP	Shpërblim dëmi kontraktor	Në proces
2	Paditës: One Albania sh.a., I paditur:Vodafone Albania sh.a. Person i tretë: AKEP	Shpërblim dëmi	Në proces
3	Paditës: Hertz.al I paditur: Besnik Merkaj Person i tretë: AKEP	Ndalim përdorim domain	Fituar
4	Paditës: AKEP I Paditur: Donald Shtrepi	Begatim pa shkak	Në proces